

Dhjetë vjet nga miratimi i
Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit

Falënderim

Monografia është prodhuar për dhjetë vjetorin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian.

Ky publikim është hartuar për rishikim nga ana e Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara. Është përgatitur nga Dragan Tilev, Këshilltar Shtetëror, Sekretariatit për Çështje Evropiane (SÇE) dhe Ministër Këshilltar në Misionin e Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian; Selvet Baruti, Këshilltar i Shtetit, SÇE; Ana Angelovska, Ushtrues i Detyrës Shef i Sektorit të Integritit, SÇE; Mbaresa Shaqiri, bashkëpunëto e re, Kabineti i Zëvendës Kryeministrit për Çështje Evropiane, SÇE; Biljana Butlevska, Ndihmës Udhëheqës i Sektorit për Integrim, SÇE; Sektorit për Integrim dhe tërë SÇE; Robert Scott Heaslet, Zëvendës Drejtor, Instituti Nacional Demokratik (NDI); dhe, Aleksandra Cvetkovska, Menaxher i lartë i Programit, NDI. Pikëpamjet e autorëve të shprehura në këtë publikim nuk reflektojnë medoemos pikëpamjet e Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



Botues: Sekretariati për Çështje Evropiane (SÇE)

Redaktor kryesor: mr. Dragan Tilev

Këshilli redaktues: SelvetBaruti, SÇE; mr. Ana Angelovska, SÇE; Biljana Butlevska, SÇE; Mbaresha Shaqiri, SÇE; mr. Robert Scott Heaslet, NDI; dhe, Aleksandra Cvetkovska, NDI.

Përmbajtje

I.	Parathënie	5
II.	Hyrje: Çfarë është MSA? Qëllimet, rezyme dhe implementimi i Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim (MSA)	7
III.	Përgjigjet e pyetësorit	22
a.	Pikëpamjet e pushtetit ekzekutiv në Republikën e Maqedonisë	23
b.	Pikëpamjet e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë	47
c.	Pikëpamjet e organizatave qytetare	55
d.	Pikëpamjet e Komisionit Evropian	57
IV.	Analizë e implementimit të MSA	59
V.	Perspektivat dhe sfidat	68
VI.	Refleksione përmbyllëse dhe rekomandime	75

Parathënie

Meqenëse Maqedonia është vend me status kandidati, anëtarësimi në Bashkimin Evropian (BE) ngel prioritet strategjik ekonomik dhe i sigurisë për qytetarët e vendit, andaj ne me padurim presim ta fillojmë procesin e negociimit së bashku me Turqinë, Malin e Zi dhe Serbinë, ashtu siç pesë herë kemi marrë rekomandim nga Komisioni Evropian. Ekonomia, biznesi dhe qytetarët e Maqedonisë do të përfitojnë nga anëtarësimi në BE përmes avancimit të standardeve të jetës, përmirësimit të sigurisë së mallrave për konsumatorët dhe promovimit të vlerave demokratike dhe të drejtave fundamentale.

Këtë vit shënohet dhjetëvjetori i hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) me Bashkimin Evropian. MSA-ja është paraparë plotësisht të implementohet brenda dhjetë viteve derisa Maqedonia të arrijë status të plotë të asociimit. Prandaj me plot energji presim të kalojmë në fazën e dytë të implementimit të saj, me çka do të del në pah progresi i mjaftueshëm, të cilin e ka bërë vendi im në përmbushjen e përkushtimeve politike, ekonomike, administrative dhe rajonale.

Monografia do t'i informojë palët përkatëse për kohëzgjatjen e Marrëveshjes, duke përfshirë edhe negociatat, organizimin e institucioneve të shtetit për implementim të marrëveshjes, sfidat kryesore, rezultatet e arritura dhe hapat praktike të nevojshme për të siguruar implementimin e plotë të Marrëveshjes.

Dëshiroj t'i falënderoj të gjitha ata, që kanë kontribuar në monografinë, përfshirë edhe zyrtarët dhe nëpunësit e tanishëm dhe të mëparshëm, personelin e Sekretariatit për Çështje Evropiane dhe Agjencinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) për mbështetjen financiare dhe teknike përmes Institutit Nacional Demokratik për Çështje Ndërkombëtar.

Maqedonia aspiron të bëhet “e bashkuar në diversitetin” e bllokut të 28 shteteve. Duke i evokuar vlerat evropiane të paqes, mundësisë dhe stabilitetit, duhet bashkërisht t'i tejkalojmë pengesat e shtetit tim në rrugën e anëtarësimit të plotë në Bashkimin Evropian dhe NATO, përmes gjetjes së zgjidhjeve, të cilat na unifikojnë e nuk na ndajnë; me çka inkurajohet pjesëmarrja e jo ndarja; gjegjësisht promovohet inkluzioni në vend të përjashtimit.

Dr. Fatmir Besimi,

Zëvendëskryeministër për Çështje Evropiane
Qeveria e Republikës së Maqedonisë

Hyrje: Çfarë është MSA? Qëllimet, rezyme dhe implementimi i Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim

Dhjetë vite implementim (2001/2004-2011/2014)

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Maqedonisë (MSA) është nënshkruar më **09 prill të vitit 2001** në Luksemburg dhe ka hyrë në fuqi më **01 prill të vitit 2004**, pas një procesi trevjeçar të ratifikimit nga të gjitha vendet anëtare të BE-së dhe pas dhënies së pëlqimit nga Parlamenti Evropian. **Më 01 prill të vitit 2014, janë përmbytur dhjetë vite nga implementimi i saj.** Në të njëjtën kohë, kur është nënshkruar MSA-ja, pra më 01 prill të vitit 2001 është nënshkruar edhe **Marrëveshja e Përkohshme mbi Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar** ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Maqedonisë dhe e njëjta ka hyrë në fuqi më **1 qershor të vitit 2001**. Pasi hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Marrëveshja e Përkohshme u bë pjesë përbërëse e MSA-së dhe vazhdoi procesin e implementimit. **Më 01 qershor të vitit 2011 u bënë dhjetë vite nga implementimi i Marrëveshjes së Përkohshme.**

Përmbytja dhe qëllimet e MSA-së patjetër duhet të vlerësohet në prizmin e **periudhës historike dhe politike**, e cila i ka paraprirë Marrëveshjes (1989-2000), periudha e negocimit dhe nënshkrimit (2000-2001) dhe periudha e implementimit (2001-2014).

Konteksti historik dhe politik

Pas rënies së **Murit të Berlinit (1989)** dhe pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, filloi procesi i zgjerimit, gjegjësisht demokratizimit dhe ngritjes së ekonomive me orientim tregtar edhe drejt **Evropës Qendrore dhe Lindore**. Në dekadën e fundit të shekullit XX shtetet e kësaj pjese të Evropës fuqishëm hapëronin në procesin e konsolidimit politik dhe demokratik, gjegjësisht integritet ekonomik në sistemin e BE-së (Komunitetin Evropian, gjegjësisht Bashkimin Evropian), përmes gjeneratës së re të ashtuquajturave **Marrëveshje Evropiane** (marrëveshje asociative, marrëveshje për mbështetje të reformave evropiane), si dhe përmes instrumentit të ri financiar për mbështetje të reformave evropiane, **FARË (PHARE)**. Përpos bashkimit të Gjermanisë (**Gjermania Lindore**), në vitin 1995 **Suedia, Finlanda dhe Austria** u bënë anëtare të plotfuqishme të KE-së (BE-së).

Komuniteti Evropian (në tekstin në vijim Bashkimi Evropian ose BE) gradualisht zhvilloi **kornizë juridike dhe politike për pranim të shteteve të reja** përfshirë edhe definimin e kriterëve, të cilat duhet të përmbyshen para se të pranohet shteti si anëtar i plotfuqishëm. Në vitin **1993** u vunë themelet e **Kriterëve të Kopenhagës** për anëtarësim, të cilat u plotësuan në **Madrid në vitin 1995**, si kriteret politike dhe ekonomike, të cilat detyrojnë pranim dhe respektim të plotë të së drejtës evropiane (European Acquis) si dhe themelimin dhe ndërtim të institucioneve kompetente me kapacitet për implementim të së drejtës evropiane në nivel nacional.

Në të njëjtën periudhë, pas **shpërbërjes së RSF të Jugosllavisë (1991)**, derisa i tërë rajoni përballë me konflikte të përgjakshme dhe shkatërruese (1991-1995), dhe në rend të parë ishin vënë çështje të pazgjidhura nacionale dhe nacionaliste ndërmjet shteteve të ish Jugosllavisë, i tërë rajoni gjendje jashtë procesit unik historik të **zgjerimit**. Prioritetet e vendeve të atëhershme anëtare të BE-së, bashkësisë ndërkombëtare dhe shteteve të porsaformuara, ishin të fokusuar në qetësimin e konflikteve, riparimin e dëmeve, çështjen e sigurisë, gjegjësisht ndihmën financiare dhe humanitare.

Republika e Maqedonisë nga momenti i shpalljes së **pavarësisë (1991)**, edhe pse ia doli ta shmang konfliktin ushtarak jugosllav dhe në **janar të vitit 1992** morri mendim pozitiv nga **Komisioni i Arbitrazhit** (të drejtuar nga R. Baden-

teri), menjëherë u ballafaqua me një sërë sfidash dhe obstrukcione për pranimin nga disa vende anëtare të BE-së (për shkak të kontestit me emrin tonë kushtetues) si dhe për anëtarësimin tonë në OKB. Megjithatë, Republika e Maqedonisë në **prill të vitit 1993 u pranua në OKB si vendi i 181-të**, por ajo u pranua me referencën e përkohshme, e jo me emrin e vetë kushtetues. Për fat të keq, deri më sot ky kontest ka ngel një problem i patejkalueshëm dhe në momente të caktuara e ka ngadalësuar integrimin, ndërsa sot e bllokoi përparimin e shtetit drejt aderimit në BE (dhe anëtarësimin në NATO). Me ndërmjetësim të bashkësisë ndërkombëtare, në **shtator të vitit 1995**, Republika e Maqedonisë dhe Republika e Greqisë arritën marrëveshje të ndërsjellë (**Marrëveshje të përkohshme**), me çka u krijuan marrëdhënie diplomatike dhe u hap perspektivë e re për integrimin tonë në BE.

Bashkimi Evropian në segmentin e zgjerimit, i ballafaquar me sfidat historike gjeopolitike, ka menaxhuar **dy procese paralele**.

Procesi i parë kishte të bëjë me **Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL)**, ku në bazë të kriterëve të Kopenhagës dhe Madridit, brenda kornizës ligjore të Marrëveshjeve asociative evropiane dhe mbështetjes financiare përmes FARE programit, këta vende janë përgatitur për negociata aderuese. BE-ja ia arriti me kohë ta konsolidojë politikën e vetë për shtetet e Evropës qendrore dhe lindore dhe ta definojë të ashtuquajturën **Agjenda 2000**, si platformë dy kahëshe për përgatitje të vendeve të përhershme të BE-së, për pranim të vendeve anëtare dhe për përgatitje të shteteve të reja për funksionim në kuadër të BE-së. **Zgjerimi historik** ngjau në vitin **2004**, me përfshirjen e **Polonisë, Hungarisë, Republikës së Çekisë, Sllovakisë, Lituanisë, Letonisë, Estonisë, Qipros, Maltës dhe Sllovenisë** (si vend i parë anëtar i BE-së, që doli nga ish Jugosllavia), gjegjësisht në vitin **2007** me përfshirjen në BE të **Bullgarisë dhe Rumanisë**.

Procesi i dytë kishte të bëjë me vendet e **Evropës Juglindore (EJ ose më vonë të emërtuar si Ballkani Perëndimor)**, ku pas lidhjes së **Marrëveshjes Paqësore të Parisit (1995)**, të konsoliduar në **Romë (1996) dhe pas fillimit të procesit Royaumont**, në drejtim të zhvillimit të stabilitetit dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore në Evropën juglindore, u tentua të përshpejtohet procesi i integritimit dhe arritjes eventuale të rrugëtimit të vendeve të Evropës qendrore dhe lindore. BE-ja për shkak të precizimit të mëtejshëm të kushteve për përparim në procesin e integritimit në BE të shteteve të EJL-së e definoi politikën e **Qasjes rajonale (1996)**, gjegjësisht bashkëpunimit rajonal, si dhe **Strategjinë për kushtëzim të BE-së (1997)** me parakushte politike dhe ekonomike për zhvillim të marrëdhënieve bilaterale të BE-së me vendet e EJL-së. Megjithatë u dëshmuua së pasojat e luftërave, të cilat u zhvilluan në territorin e Ballkanit ishin komplekse dhe të thella, ndërsa klima politike në disa vende të rajonit, nuk ishte e përshtatshme për afrim më të shpejtë drejt BE-së dhe hapërim drejt procesit të vendeve të EJL-së, me përjashtim të Republikës së Maqedonisë. Në fakt, pas normalizimit të marrëdhënieve me **Greqinë në vitin 1995** dhe krijimit të marrëdhënieve diplomatike me BE-në, në dhjetor të të njëjtit vit, Republika e Maqedonisë e zhvilloi platformën e vetë në procesin e integritimit, i cili mund të shënohet me faktin se në vitin **1996**, krijuam marrëdhënie kontraktuese me BE-në, gjegjësisht **Marrëveshjes për bashkëpunim (që ka hyrë në fuqi në vitin 1998)** dhe **Marrëveshjen për Transport**, si dhe aderuar në **Programin FARE (1996-1999)** dhe filluam **dialog të rregullt politik me BE-në**.

Kah fundi i dekadës (**1999**), me intervenimin e **NATO-s në Serbi dhe Krizën e Kosovës**, ndryshimet në Kroaci dhe rënien e regjimit të Milosheviçit në Serbi, është krijuar hapësirë për impuls të ri politik në procesin e aderimit të vendeve të Evropës Juglindore drejt BE-së. Bashkësia ndërkombëtare në përbërje më të gjerë (OKB-ja, Këshilli i Evropës, OSBE-ja, NATO), në **Keln-Gjermani në vitin 1999** e prezantuan **Pakon e stabilitetit për Evropën Juglindore**, si platformë politike, e më vonë edhe ekonomike për krijim dhe rinisje të lidhjeve të ndërprera politike dhe ekonomike ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore. Si shtojcë të veten drejt Paktit të stabilitetit, Bashkimi Evropian, duke e shfrytëzuar çastin historik pozitiv, menjëherë në të njëjtin vit 1999 e definoi kornizën juridike, institucionale dhe financiare për afrim të vendeve të Evropës Juglindore drejt BE-së, në formë të **Procesit të Stabilizim Asociimit (PSA)**. Elementet kyç të PSA-së ishin gjen-

erata e re e **Marrëveshjeve për Stabilizim dhe Asociim dhe instrumenti i ri financiar KARDS (CARDS) (2000-2006)** për mbështetje të reformave të nevojshme për përfshirje në BE. Qëllimi i PSA-së ishte dhe ngel të jetë krijimi i kornizës funksionale juridike për zhvillim të marrëdhënieve bilaterale, politike, ekonomike dhe tregtare të BE-së me vendet e Evropës së Juglindore, deri në anëtarësimin e tyre në BE. Politika e dyerve të hapura për anëtarësim në BE të vendeve të Evropës Juglindore, ishte e verifikuar me konkluzionet e Këshillit të Evropës në **Madrid dhe S.M. de Faria, në vitin 2000.**

Republika e Maqedonisë ishte partner aktiv në **Paktin e Stabilitetit**, protagonist i sinqertë në kuadër të **Qasjes rajonale** dhe me përpikëri i përmbushi të gjitha detyrimet e **BE-së (Strategjia për kushtëzim)**. Si rezultat i qasjes së këtyllë pozitive të vendit, **BE-ja vendosi që Republika e Maqedonisë të jetë shteti i parë, i cili do të hapërojë në procesin e Stabilizim Asociimit** dhe do t'i fillojë negociatat për nënshkrim të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. BE-ja do të fillojë **Raport** të posaçëm (**Fizibiliteti studimi, 1999**) për gatishmërinë e vendit për fillim të negociatave për MSA, e pastaj do t'i miratojë edhe **Direktivat për pozicionet e BE-së në negociata (2000).**

Më **05 prill të vitit 2000**, Republika e Maqedonisë, e para nga të gjitha vendet e **Procesit të Stabilizim Asociimit (PSA)**, i filloi negociatat me BE-në për MSA dhe e para i përfundoi ato, në periudhë kohore veçanërisht të shkurtër, në 3 raunde të negociatave dhe 5 takime në nivel ekspertësh. Më **24 nëntor të vitit 2000**, në margjinat e **Samitit të Zagrebit**, BE-ja dhe Republika e Maqedonisë **firmosën Marrëveshjen e Parë të Stabilizim Asociimit në rajon**. Si pjesë përbërëse të negociatave për MSA ishin edhe negociata për arazhmane tregtare dhe koncesione, të cilat rezultojnë me nënshkrimin e **Marrëveshjes së Përkohshme (për tregti dhe marrëdhënie tregtare)** më **16 shkurt të vitit 2001**. Më **09 prill të vitit 2001** në **Luksemburg**, solemnisht u nënshkrua **Marrëveshja e Stabilizim Asociimit** ndërmjet bashkimit Evropian dhe Republikës së Maqedonisë, si dhe **Marrëveshja e përkohshme mbi tregtinë dhe marrëdhëniet tregtare**. Më **12 prill**, vetëm tre ditë pas nënshkrimit të MSA-së, e njëjta u ratifikua në **Kuvendin e Republikës së Maqedonisë**. **Marrëveshja e përkohshme** hyri në fuqi më **01 korrik të vitit 2001**, ndërsa MSA kaloi në procesin e **ratifikimit** në Parlamentin e Evropës dhe parlamentet e të gjitha vendeve anëtare, me çka **hyri në fuqi me 01 prill të vitit 2004**.

Për fat të keq, nga **shkurti deri në gusht të vitit 2001**, Republika e Maqedonisë përjetoi një krizë të brendshme politike dhe të sigurisë me karakter ndëretnik. Kjo krizë u përmyll me ndërmjetësimin e SHBA-ve, BE-së dhe NATO-s përmes nënshkrimit të **Marrëveshjes kornizë të Ohrit**. Me futjen e Marrëveshjes kornizë në Kushtetutë dhe në legjislacionin nacional, u krijuan kushte për kahëzim të energjisë politike drejt perspektivave të BE-së dhe vazhdim të reformave.

Orvatjet e BE-së për zgjerim të suksesshëm edhe në Evropën Juglindore vazhduan me miratimin e konkluzioneve të **Këshillit të Evropës dhe të ashtuquajturës Agjenda e Selanikut në korrik të vitit 2003**, gjatë kryesimit të **Greqisë**. Energjia pozitive u reflektua **me dialogun e fuqizuar politik** (filluan mbledhje në nivelin më të lartë ndërmjet BE-së dhe vendeve të PSA-së) dhe definimin e bençmarkëve konkrete në formë të **Partneriteteve Evropiane** (më vonë për disa shtete u transformuan në **Partneritete aderuese**). Në të njëjtën kohë, në kuadër të **Programit KARDS**, për herë të parë për vendet e PSA-së u mundësuan instrumentet **Twinning** (Tuining) dhe **TAIEX (TAJEKS)**, dhe u mundësua edhe pjesëmarrje në punën e disa **Agjencive të Unionit**.

Republika e Maqedonisë, si akt për verifikim të **orientimit të vetë strategjik**, në pajtim me **nenin 49 të Marrëveshjes**, pas miratimit të **Deklaratës në Kuvendin e RM-së**, zyrtarisht dorëzoi **Aplikacion për anëtarësim në BE** më **22 mars të vitit 2004¹**, në **Dublin**, gjatë kryesimit të Këshillit të BE-së nga **Republika e Irlandës**. Në të njëjtin vit ndodhi zgjerimi i madh i BE-së me 10 anëtare të reja. Më **01 prill të vitit 2004**, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit zyrtarisht hyri në fuqi, ndërsa në të njëjtin vit u miratua **Strategjia Nationale e Republikës së Maqedonisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, u realizua mbledhja e parë e Komitetit për Stabilizim Asociim (03 qershor)** dhe menjëherë

1 Dorëzimi i Aplikacionit në shkurt të vitit 2004 u anulua për shkak të vdekjes tragjike të Kryetarit të atëhershëm të Republikës së Maqedonisë, Boris Trajkovski

pas saj edhe mbledhja në **Këshillin për Stabilizim dhe Asociim (14 shtator)**. Kryetari i atëhershëm i Komisionit Evropian, **Romano Prodi**, gjatë vizitës së tij të dytë zyrtare në Republikën e Maqedonisë në **tetor të vitit 2004**, e dorëzoi **Pyetësonin gjithëpërfshirës për vlerësim të gatishmërisë së shtetit** për marrjen e statusit të kandidatit për anëtarësim. Në **shkurt të vitit 2005** përgjigjet e Pyetësonit iu dorëzuan KE-së, i cili **Qëndrimin dhe vlerësimin e detajuar për shtetin** ia dorëzoi Këshillit të BE-së për të marrë vendim. Këshilli i Evropës gjatë kryesimit të **Britanisë së Madhe, më 16 dhjetor të vitit 2005, mori vendim pozitiv** dhe Republika e Maqedonisë u bë shteti me status të **kandidatit për anëtarësim**, mirëpo për fat të keq, pa datë për fillim të negociatave aderuese. Ndërkohë, u definua instrumenti i ri për mbështetje të procesit të zgjerimit, **Programi IPA (2007-2013)** me alokim të **11,5 miliard eurosh**, ndërsa Republika e Maqedonisë me sukses e ndërtoi strukturën për implementim të decentralizuar të saj.

Republika e Maqedonisë vazhdoi me pothuajse **dosjen e përpiktë për implementim** të të gjitha detyrimeve, të cilat burojnë nga MSA-ja dhe të gjitha aktet përcjellëse, duke i pranuar me korrektësi **ndryshimet e MSA-së për shkak të zgjerimit të BE-së** (me 10 vende të reja anëtare në vitin 2004, me dy vende anëtare në vitin 2007 dhe një vend anëtar në vitin 2013). Në vitin **2008**, Partneriteti Evropian u transformua në **Partneritet aderues dhe u definuan bençmarket kyçe** si kushte për përparim të mëtejshëm në proces. Republika e Maqedonisë përkundër goditjes psikologjike dhe padrejtësisë së shkaktuar në **Bukuresht në Samitin e NATO-s**, kur nuk u materializua anëtarësimi i merituar, detyrimet e veta në procesin e integritimit në BE i realizoi sistematikisht dhe në tërësi. Paralelisht rridhnin negociatat për **liberalizim të vizave**. Fundi i vitit 2009 solli sukses për Republikën e Maqedonisë, gjegjësisht në **tetor të vitit 2009** KE-ja vlerësoi se të gjitha kushtet për fillim të negociatave aderuese janë përmbushur dhe **i rekomandoi Këshillit të BE-së ta përcaktojë datën dhe të sjell vendim për fillimin e negociatave aderuese**. Për fat të keq, Këshilli u përball me obstrukcione, gjegjësisht ishte e pamundshme të arrihet konsensus, i cili është i domosdoshëm për marrje të vendimeve për fillimin e negociatave. Nga ana tjetër, më **20 nëntor të vitit 2009**, Këshilli morri **vendim për lëvizje pa viza të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë** në zonën e Shengenit të BE-së.

Republika e Maqedonisë u gjend në **situatë të pazakonshme dhe “të pavolitshme” nga sistemi i vendimarrjes** në kuadër të institucioneve të BE-së, për shkak se Komisioni Evropian rregullisht çdo vit nga viti **2009** e këndeje (**përfshirë edhe vitin 2013, për pesë herë me radhë**) vlerëson se jemi të gatshëm për fillimin e negociatave aderuese, ndërsa Këshilli i BE-së, **nuk mund të merr vendim** për fillimin e negociatave me Republikën e Maqedonisë.

Në drejtim të shfrytëzimit të të gjitha instrumenteve, të cilat janë në dispozicion në kuadër të **respektimit dhe ushtrimit të së drejtës ndërkombëtare**, Republika e Maqedonisë e prezantoi rastin e obstrukcionit të Greqisë për pranim të saj në organizata ndërkombëtare, në pajtim me Marrëveshjen e përkohshme të nënshkruar ndërmjet dy palëve, para **Gjykatës ndërkombëtare të drejtësisë (GJND)**, në Hagë. GJND-ja më **05 dhjetor të vitit 2011** solli **vendim** të qartë dhe preciz, **në favor të Republikës së Maqedonisë**. Për fat të keq, vendimi i gjyqit ende nuk është materializuar as për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë në NATO e as për fillim të negociatave për aderim në BE.

Në **mars të vitit 2012**, KE-ja bëri **edhe një tentim për lëvizje të procesit të aderimit të Republikës së Maqedonisë** përmes hapjes së **Dialogut aderues të nivelit të lartë**, me qëllime dhe prioritete të përcaktuara konkrete. Në **dhjetor** të të njëjtit vit, Komisari Fyle i propozoi Këshillit një konkluzion, me çka de fakto ofronte **hapje paralele të negociatave aderuese dhe vazhdim të negociatave me Greqinë** në lidhje me përdorimin e emrit, në kuadër të kompetencave të OKB-së. Për fat të keq, kjo orvatje u pengua në kuadër të Këshillit të BE-së dhe ngeli pa epilogun e dëshiruar, përkundër **Raportit jo të Rregullt të pranverës të KE-së për Republikën e Maqedonisë, në prill të vitit 2013, si dhe rekomandimit të pestë të KE-së për fillim të negociatave aderuese në tetor të të njëjtit vit**.

Ndërkohë në **korrik të vitit 2013, Kroacia u bë vendi i 28 anëtar i BE-së** (vendi i dytë anëtar i BE-së nga ish Jugosllavia), **Mali i Zi** i filloi negociatat aderuese në vitin 2012, ndërsa **Serbia** në janar të vitit 2013, **Shqipëria** mori statusin e

kandidatit të kushtëzuar në vitin 2012, Kosova filloi negociata për MSA në dhjetor të vitit 2013, **Bosnja dhe Hercegovina** ka statusin e kandidatit, i cili ende nuk ka hyrë në fuqi, **Turqia** vazhdon me negociatat aderuese me kohë të ngadalësuar, ndërsa **Islanda** vendosi të heq dorë nga negociatat aderuese. Në kuadër të **Buxhetit të BE për 2014-2020** është definuar edhe **Programi i ri IPA2** për mbështetje të procesit të integritimit në BE, me alokim të **11.7 miliard eurosh**.

Bashkimi Evropian pas tejkalimit të **krizës më të madhe financiare (2008-2010)** me pasoja të thella politike dhe lëvizje tektonike në politikat ekonomike, hyri me dozë të optimizmit në **zgjedhjet historike në maj të vitit 2014 për përbërjen e re të Parlamentit Evropian, Kryetarët e rinj të Komisionit Evropian dhe të Këshillit të Evropës** si dhe përbërjen e re të **Komisionit të Evropës**. Problemet e paparapara dhe në veçanti të ndërlikuara, me të cilat ballafaqohet BE-ja në kufi me Federatën Rusë, para së gjithash në Ukrainë, paraqesin edhe një sfidë dhe provim për mekanizmat e vendimmarrjes së BE-së, por edhe mundësi për **impuls të ri koheziv** për afrim të interesave, që në momente të caktuara janë divergjente mes 28 vendeve anëtarë të BE-së.

Republika e Maqedonisë nuk ka alternativë tjetër, përveç se të vazhdojë edhe më tej me përkushtim maksimal të punojë në drejtim të përmbushjes së **qëllimeve të veta strategjike, anëtarësimi në Bashkimin Evropian dhe në NATO**.

Qëllimet dhe përmbajtja e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Maqedonisë

Konteksti dhe qëllimet e MSA-së

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA), si akt kompleks dhe **i detyrueshëm i së Drejtës ndërkombëtare** në vitin 2000 (kur negociohej) dhe në vitin 2001 (kur u nënshkrua) në **planin politik** e radhiti Republikën e Maqedonisë në rendin e shteteve me perspektivë për anëtarësim në BE, ndërsa në **planin ekonomik**, me nënshkrimin e Marrëveshjes u hapën dyert e njërit ndër tregjet më të mëdha dhe më të fuqishme financiare të botës. Në momentin e nënshkrimit të MSA-së, BE-ja përbëhej nga 15 shtete anëtare (2001), ndonëse ky numër i rrit në 25 (2004), në 27 (2007), gjegjësisht në 28 në vitin 2013.

Me të drejtë konsiderohej se MSA-ja do të jetë nxitje për **përsheptim të ristrukturimit të ekonomisë** së Republikës së Maqedonisë dhe përshtatje në kushtet e reja të tregut dhe se do të realizohet mundësia për **përsheptimin e zhvillimit social dhe ekonomik** të vendit, gjegjësisht të krijimit dhe themelimit të **lidhjeve të përhershme politike dhe ekonomike** me të gjitha vendet anëtare të BE-së.

MSA-ja si **marrëveshje preferuese** me koncesione më të mëdha në favor të Republikës së Maqedonisë, po ashtu duhej të kontribuojë për stabilitetin ekonomik dhe politik të shtetit dhe rajonit (**stabilizimi**), si dhe krijimit të lidhjeve të përhershme ekonomike dhe politike ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe BE-së (**asociimi**). Qëllimet e MSA-së ishin të definuara në drejtim të:

- Afrimit të rajonit drejt **integritimit më të afërt dhe të plotë** në strukturat e Bashkimit Evropian,
- Mbështetjes së **konsolidimit të shpejtë demokratik**, sundimit të së drejtës, zhvillimit ekonomik dhe reformat strukturore, strukturat adekuate administrative dhe bashkëpunimit rajonal,
- Krijimit të **kornizës së formalizuar të dialogut politik**, në nivel bilateral dhe rajonal.
- **Promovimit të marrëdhënieve ekonomike**, tregtisë, investimeve, politikës së sipërmarrjeve, transportit dhe zhvillimit, bashkëpunimit në sferën e doganës, me perspektiva për integrim më të afërt në sistemin tregtar botëror, përfshirë edhe mundësinë për krijim të zonës së lirë tregtare, pasi të arrihet progres në reformat ekonomike,
- Sigurimit të bazës për **bashkëpunim në sferën e së drejtës dhe punëve të brendshme**,
- Sigurimit të bazës për **bashkëpunim ekonomik, social, qytetar, shkencor, teknologjik, energjetik, kulturor** gjegjësisht bashkëpunim në sferën e mjedisit jetësor, përmes mbështetjet të procesit të aproksimacionit të legjislacionit nacional me atë të Bashkimit Evropian.

Përmbajtja dhe struktura e MSA-së

Në bazë të **përmbajtjes dhe strukturës juridike**, Marrëveshja përbëhet nga: **Preambula, teksti** i marrëveshjes (128 dispozitat në 10 kapituj). **7 Aneksë, 5 Protokolle** (numri i Protokolleve është rritur më vonë) dhe **Deklarata të përbashkëta dhe Unilaterale**. Teksti i Marrëveshjes është i ndarë në 10 Kapituj, duke filluar nga parimet e përgjithshme, dialogu politik, bashkëpunimi rajonal, lëvizja e lirë e mallrave, lëvizja e punëtorëve, themelimi i sipërmarrjeve, shërbimeve dhe kapitalit, afrimi i legjislacionit dhe zbatimi i ligjeve, drejtësia dhe punët e brendshme, politikat e bashkëpunimit, bashkëpunimi financiar dhe institucional. dispozitat e përgjithshme dhe të përbashkëta.

Preambula i definon qëllimet e ndërsjella të Republikë së Maqedonisë dhe BE-së, si dhe platformën, në bazë të së cilës ata merren vesh, duke i pasur parasysh aktet dhe kartat e Bashkësisë Ndërkombëtare në sfera të caktuara, të cilat miratohen në kuadër të Procesit të stabilizim asociimit. Në preambulë definohet edhe e ashtuquajtura **“Klauzolë evolutive”**, e cila për **arsye politike është konsideruar jashtëzakonisht e rëndësishme** në momentin e negociimit të MSA-së, me të cilën bëhet thirrje për gatishmëri të BE-së për ta integruar Republikën e Maqedonisë në masë potenciale më të madhe në rrjedhat politike dhe ekonomike të Evropës dhe ta definojë statusin saj si **kandidat potencial për anëtarësim në BE**.

Në pjesën e **Parimeve të përgjithshme** të MSA-së ndjehen bazat mbi të cilat ndërtohet Marrëveshja, me çka theksohen parimet e definuara me **qasjen rajonale dhe Procesi i stabilizim asociimit**, me respektim të të arriturave individuale të vendeve në planin politik, demokratik dhe ekonomik. Në këtë pjesë është definuar edhe koha, në të cilën do të duhej të arrihet asociimi i plotë, me përcaktim të **periudhës së tranzicionit maksimalisht deri në 10 vite**. Kjo periudhë është e ndarë në **dy faza** me qëllim që Dispozitat e Marrëveshjes të implementohen në mënyrë progresive, ashtu që në **fazën e parë** fokusi të vendoset në sferat e bashkëpunimit rajonal, lëvizjen e lirë, harmonizimin e legjislacionit dhe zbatimin e dispozitave, si drejtësisë dhe punët e brendshme. Sipas dispozitave të MSA-së, **4 vite nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes**, Këshilli për stabilizim dhe asociim do ta vlerësojë raportin e progresit të arritur dhe do të vendos për fillimin dhe kohëzgjatjen e fazës së dytë. **Në vitin 2009, Komisioni Evropian** në bazë të analizës së detajuar dhe vlerësimit të implementimit të MSA-së i dorëzoi **propozim Këshillit të BE-së të jep mendim pozitiv për marrjen e vendimeve për kalim në fazën e dytë të MSA-së**. Këshilli i BE-së, për shkak të obstrukcioneve të Greqisë, **deri më sot nuk e ka përmbushur këtë detyrë**.

MSA-ja e vërteton përcaktimin e BE-së dhe Republikës së Maqedonisë, për intensifikim të **dialogut politik** edhe atë në veçanti për çështjet e karakterit ndërkombëtar, të cilat kanë ndikim të rëndësishëm te palët kontraktuese për bashkëpunim rajonal, si dhe për këndvështrimet e përbashkëta për Evropë të sigurt dhe të qëndrueshme. Gjithashtu, definohet se dialogu politik mund të ruhet në nivel ministror në kuadër të Këshillit për stabilizim dhe asociim dhe në nivel parlamentar, në kuadër të Komitetit parlamentar për stabilizim dhe asociim.

Bashkëpunimi rajonal ka rëndësi të posaçme për MSA-në, para së gjithash për shkak të përvojave nga periudha para vitit 2000, por edhe për shkak të nevojës për krijim ose rifillim të marrëdhënieve dhe relacioneve të ndërprera ndërmjet vendeve të rajonit. Në MSA theksohet nevoja e bashkëpunimit ndërmjet vendeve, të cilat e kanë nënshkruar atë (që paraqet detyrim për nënshkrim të Konventës për bashkëpunim rajonal), ndërmjet vetë shteteve nënshkruese të MSA-së dhe shteteve të cilat në atë periudhë e kanë pasur statusin kandidatit (gjegjësisht i kanë pasur të nënshkruara të ashtuquajturat Marrëveshje të Evropës). Ky kapitull i MSA-së qysh në fillim ishte plotësisht i pranueshëm për Republikën e Maqedonisë, mirëpo më vonë për shtetet tjera të rajonit, të cilat negociuan për MSA pas Maqedonisë, ky ishte njëri ndër kapitujt më problematik, në veçanti gjatë negociatave të Kroacisë dhe Serbisë për MSA-të e tyre.

Pjesa e MSA-së (gjegjësisht Marrëveshja e Përkohshme), e cila e rregullon **lëvizjen e lirë të mallrave**, është më e detajuar dhe më e vëllimshme (Aneksë, Protokolle), për nga sasia dhe kishte ndikim të drejtpërdrejtë në dinamikën e

zhvillimit të ekonomisë, industrisë dhe kahëzimit të marrëdhënieve tona tregtare drejt BE-së. Qasja ishte **asimetrike**, me çka prodhimet tona (çeliku, prodhimet tjera industriale, bujqësore, produktet e peshkut, sheqeri, tekstili etj.) **menjëherë patën qasje të lirë në tregun evropian**, pa doganë dhe kufizime sasiore ose me kufizime të vogla dhe të përkohshme, (me përjashtim të mishit të viçit, verës dhe prodhimeve të alkoolit) dhe njëkohësisht **hapej tregu ynë për produktet evropiane me zvogëlim gradual** të pagesave doganore dhe kufizimeve tjera, në **periudhë kohore deri në 10 vjet**. Qasja e këtillë kishte për qëllim, **t'iu jep mundësi prodhuesve të Maqedonisë të investojnë në teknologji të reja dhe metoda të prodhimit** dhe në këtë mënyrë ta përmirësojnë produktivitetin e tyre dhe aftësinë konkurruese. Në fakt, në këtë drejtim mund (dhe ende mund) të shfrytëzohen edhe mjetet e IPA-s dhe të fondeve tjera të BE-së. Përmes kësaj **qasje asimetrike**, në fund të periudhës së tranzicionit (pra pas 10 viteve), krijohet **zona e tregtisë së lirë** ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian. **Ky qëllim është arritur më 01.06.2011.**

Pjesa e MSA-së, e cila ka të bëjë me **lëvizjen e lirë të të punësuarve**, i definojnë kushtet, modalitetet dhe trajtimin e personave, qytetarë të Republikës së Maqedonisë, të cilët punojnë në vendet anëtare të BE-së, me faktin se në parim duhet të respektohen kushtet e punës, kompensimet në marrëdhëniet të punës, procedurat për largim nga puna, qasja në tregun e punës për bashkëshortët/bashkëshortet dhe fëmijët e punëtorëve, ofrimi i sigurimit social, pensioneve etj., të cilat vlejné për qytetarët e shteteve anëtare të BE-së. Në segmentin e **Themelimit të sipërmarrjeve**, definojnë mënyrat për themelim të funksionim të personave juridik – kompanive, kompanive subvencionuese dhe filialeve në territoret e palëve kontraktuese. Në **ofrimin e shërbimeve**, definojnë detyrimet e ndërsjella në drejtim të liberalizimit të mëtejshëm të shërbimeve transportuese në sferën e trafikut tokësor, ajror dhe ujor, si qasja e ndërsjellë në tregjet e palëve kontraktuese. **Pagesat rrjedhëse dhe lëvizjet e kapitalit** i definojnë kushtet për pagesë dhe transferim në llogarinë rrjedhëse të bilanceve të pagesave ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Maqedonisë.

Njëra ndër shtyllat kyçe të MSA-së, e cila ndërhyr në esencën e procesit të integritimit në BE, gjithsesi së është pjesa, me të cilën përcaktohet fushëveprimi dhe dinamika e **harmonizimit të legjislacionit tonë me të atë Bashkimit Evropian, si dhe sigurimi i mbështetjes institucionale për implementim të tij**. Pra fjala është për një vëllim të madh të dispozitave, direktivave, vendimeve dhe rekomandimeve (të ashtuquajtura **Acquis communautaire**), të cilat gradualisht futen në legjislacionin tonë, gjegjësisht bëhet transpozicioni i tyre në sistemin tonë juridik nacional. Në pajtim me **MSA-në**, harmonizimi i legjislacionit është paraparë **të rrjedh në dy faza. Faza e para fillon të rrjedh menjëherë** pas nënshkrimit të MSA-së, ndërsa faza e dytë ka të bëjë me vendimin për kalim zyrtar në fazën e dytë të implementimit të MSA-së. Prioritet i fazës së parë, në të cilën zhvillohet procesi i harmonizimit sipas MSA-së, është harmonizimi i dispozitave, të cilat e rregullojnë çështjen e **Tregut të vetëm evropian** (katër liritë themelore) dhe **dispozitat e sferës së tregtisë**, ndërsa pastaj vijon orientimi gradual edhe drejt sferave tjera të MSA-së. Për segmentet me rëndësi të posaçme, përfshirë edhe ndihmën e shtetit, standardizimin dhe akreditimin, furnizimet publike, pronën industriale dhe intelektuale si dhe ruajtjen e të dhënave, janë të përcaktuara edhe afate kohore për harmonizim të plotë ose të pjesshëm me të drejtën evropiane. Shumë është me rëndësi të dihet se në procesin e harmonizimit të legjislacionit, **transmetimi i dispozitave evropiane si të tilla nuk është i mjaftueshëm**, por nevojitet të sigurohet edhe strukturë e shëndoshë institucionale, e cila do të mundësojë zbatimin e dispozitave të reja ligjore. Në këtë kontekst u potencua edhe nevoja e **reformës së sistemit gjyqësor**, me qëllim që të përmirësohet efikasiteti i tij, si dhe reformat në drejtim të krijimit të **administratës kompetente dhe profesionale shtetërore, lokale dhe publike**.

Në MSA-në tonë për herë të parë pas miratimit të Marrëveshjes së Amsterdami (1999), BE-ja në një marrëveshje asociative, e përfshiu kapitullin, me të cilin rregullohet **bashkëpunimi në sferën e së drejtës dhe punëve të brendshme**, edhe atë në segmentet e fuqizimit të institucioneve dhe sundimit të ligjit, vizave, kontrollit kufitar, azilit dhe migracionit, parandalimit dhe kontrollit të imigrimit ilegal, riadhesimin (të rregulluar me marrëveshje të posaçme), luftën kundër larjes së parave, parandalimin dhe luftën kundër kriminalitetit dhe aktivitetet tjera ilegale dhe bashkëpunimin në luftën kundër drogave të ndaluara.

Kapitull i posaçëm në MSA i kushtohet **krijimit të mundësive për bashkëpunim pothuajse në të gjitha politikat sektoriale të BE-së**, përmes lidhjes institucionale, transferim të politikave të BE-së në politikat tona nacionale dhe ndërtimit të bazës për kompatibilitet dhe komplementaritet të sistemeve tona në të gjitha sferat, të cilat janë lëndë e MSA-së, duke filluar nga bashkëpunimi ekonomik, bashkëpunimi statistikor, bashkëpunimi në sektorin bankar dhe shërbimet financiare, promovimi dhe mbrojtja e investimeve bashkëpunimi industrial, bashkëpunimi në segmentin e sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme, turizmi, dogana, taksat, bashkëpunimi social, arsimi, bashkëpunimi kulturor, informacione dhe komunikimi, bashkëpunim audio-vizuel, telekomunikime dhe shoqëri informatike, e deri te sferat e mbrojtjes së konsumatorëve, transporti, energjetika, bujqësia dhe sektori i agro-industrisë, zhvillimi rajonal dhe lokal, bashkëpunimi në hulumtimin e zhvillimit teknologjik të mjedisit jetësor dhe siguria bërthamore.

Në kuadër të MSA-së ishte definuar korniza, llojet dhe kushtet e **bashkëpunimit financiar**, i cili duhej të sigurojë mbështetje të konsiderueshme gjatë realizimit të detyrimeve, të cilat burojnë nga Marrëveshja në sferën e **investimeve plotësuese dhe shpenzimeve**, të cilat detyrimisht do të buronin nga procesi i reformave dhe transformimit, përmes të së cilit është dashur të kalojë sistemi ynë i atëhershëm. MSA-ja parasheh, që bashkëpunimi financiar mund të jetë në **formë të granteve** (ndihmës së pakthyeshme përmes Programit KARDS, më vonë IPA), në **formë të kredive** (përmes EIB-së), **ndihmës makrofinanciare dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë buxhetore**. Në pajtim me dispozitat e MSA-së, gjatë përdorimit të mjeteve financiare nevojitet të sigurohet **koordinim efikas** me burimet tjera të ndihmës financiare, e cila fitohet në mënyrë bilaterale përmes vendeve anëtare të BE-së dhe shteteve tjera donatore, ose përmes institucioneve ndërkombëtare financiare, për çka palët kontraktuese kanë për detyrë të shkëmbejnë informacione.

Kapitulli i fundit i MSA-së ka të bëjë me **dispozitat institucionale dhe përfundimtare**, me të cilat definohet krijimi i mënyrës së punës së institucioneve të posaçme të përbashkëta, të cilat duhet ta ndjekin implementimin e Marrëveshjes edhe atë **Këshilli për stabilizim dhe asociim (në nivel ministrash)**, i cili e mbikëqyr zbatimin dhe implementimin e Marrëveshjes dhe sipas nevojës merr vendime dhe udhëzime për implementim të dispozitivve të caktuara, **Komiteti për stabilizim dhe asociim**, me shtatë nënkomitetet sektoriale dhe grupi i specializuar për ndjekje të reformave në administratën publike, të cilët më detajisht e ndjekin dhe udhëzojnë implementimin e MSA-së dhe e përgatisin punën e Këshillit për MA dhe **Komitetin e Përbashkët Parlamentar për MA**, si forum i përbashkët, në të cilin anëtarët e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe të Parlamentit Evropian shkëmbejnë mendime për tema, të interesit të përbashkët.

Në pajtim me dispozitat përfundimtare, **Marrëveshja për Stabilizim Asociim është lidhur për kohë të pacaktuar dhe ngel në fuqi edhe pas përfundimit të vitit të dhjetë të implementimit të saj**, gjegjësisht do të vlejë derisa njëra nga palët nuk kërkon të heq dorë. MSA-ja do të vlejë derisa të zëvendësohet me **Marrëveshjen aderuese**, në rast të anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë në BE.

Implementimi i Marrëveshjes së stabilizim asociimit

Kontinuiteti në implementim

Kontinuiteti dhe implementimi i përpiktë i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe Marrëveshja e përkohshme për tregti gjatë këtyre dhjetë e më shumë viteve i ka vënë themelet e këtyre dokumenteve të detyrueshme ligjore me të gjitha aspektet e tyre, në bazat e sistemit tonë politik dhe juridik, i ka kahëzuar politikat ekonomike dhe tregtare dhe i ka definuar politikat kyçe sektoriale. Ndërkohë **reformat e prioritetit më të lartë** të karakterit politik, ekonomik ose sektorial, si p.sh. reformat, që kanë të bëjnë me krijimin e ambientit të tregut të lirë ekonomik dhe sistemi i barazisë sociale, respektimi i të drejtave fundamentale të njeriut, reformat në sistemin gjyqësor dhe polici, reformat në administratën publike dhe reforma tjera **janë mbajtur në fokus të të gjitha përbërjeve të qeverive dhe kuvendit, pavarësisht nga platformat politike dhe**

Përbushja e kritereve politike dhe ekonomike

Implementimi i përpiktë i MSA-së, respektimi i të gjitha detyrimeve juridike ndërkombëtare dhe të **kritereve politike të Kopenhagës**, përfshirë edhe frymën e **Marrëveshjes së Kornizë të Ohrit** dhe participimin aktiv të të gjitha **iniciativave rajonale** dhe **përbushja e kritereve ekonomik**, mundësuan që Republika e Maqedonisë sot të dallojë në masë të konsiderueshme nga ajo se si ishte në vitin 1991, gjegjësisht në vitin 2001. **Dialogu politik** me Bashkimin Evropian dhe vendet anëtare është i orientuar drejt platformës së përmirësimit të mirëkuptimit të ndërsjellë dhe artikulimit të qëndrimeve dhe interesave tona, ndërsa **përmes kritereve të definuara politike** janë orientuar dhe dirigjuar reforma në sistemin politik dhe juridik të shtetit, me avancim të dukshëm, që ka rezultuar me konstatim të përgjithshëm për **përbushje të duhur të kritereve politike të Kopenhagës**. Përmes implementimit të MSA-së në pjesën e **marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare**, rrjedhimisht kanë lëvizur reformat, të cilat e afrojnë vendin drejt përbushjes së **kritereve ekonomike të Kopenhagës**. Politikat nacionale ekonomike drejtpërsëdrejti “ndërlidhen” me politikat ekonomike të BE-së, përfshirë edhe përshtatjen e instrumenteve të reja për koordinim dhe monitorim, në veçanti pas krizës globale financiare. Gjatë implementimit të MSA-së dhe si rezultat i avancimit tonë të vazhdueshëm në procesin e euro-integritimit, Republika e Maqedonisë e fitoi **statusin e vendit kandidat** në vitin 2005, siguroi liri të lëvizjes, gjegjësisht **liberalizimit të vizave** në zonën Shengen nga viti 2009, ndërsa meritoi edhe **rekomandim për fillim të negociatave aderuese** nga KE-ja, po ashtu në vitin 2009 (e përsëritur në vitet 2010, 2011, 2012, 2013).

Avancimi i marrëdhënieve tregtare

Padyshim se implementimi i MSA-së dhe i Marrëveshjes së përkohshme për tregti dhe marrëdhënie tregtare me BE-në, në periudhën e kaluar **ka kontribuar për dinamizmin e zhvillimit të ekonomisë sonë** dhe prodhimitarisë sonë industriale dhe bujqësore, si dhe veprimtaritë gjithnjë e më të rëndësishme shërbyese. Në përgjithësi relacionet e ekonomisë sonë me BE-së u fuqizuan dhe u thelluan, ndërsa orientimi i marrëdhënieve tregtare siç është pritur është rikahëzuar drejt tregut të BE-së, ashtu që në periudhën nga viti 2001 deri në vitin 2011, gradualisht është krijuar **zona e lirë tregtare** ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian. Për **ilustrim të efekteve të MSA-së, vetën nën prizmin e vëllimit të shkëmbimit tregtar** (burimi: Eurostat, të dhënat e vitit 2012), mund të shënohet se **në vitin 2002, eksporti i Republikës së Maqedonisë në BE ka qenë 613 milion euro**, ndërsa **në vitin 2007** (vetëm 3 vite pas hyrjes në fuqi të MSA-së dhe 6 vite pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së përkohshme), u trefishua dhe ishte **1.859 milion euro**, gjegjësisht **në vitin 2012 ka qenë 3.300 milion euro**, që paraqet **rritje për 135 pikë përqindje**. Është evidente se edhe përkundër faktit, që kemi deficit tregtar në shkëmbimin tregtar me BE-së, **dinamika në rritje e eksportit tonë në BE, është dukshëm më e shpejtë nga dinamika e rritjes së importit nga BE-ja**, që gjithsesi se mes tjerash është rezultat i kushteve preferuese, të cilat i ofron MSA-ja. Në favor të **efekteve të implementimit të MSA-së** vijnë edhe të dhënat statistikore (burimi: Eurostat, të dhënat e vitit 2012) në raport **me orientimin e shkëmbimit tonë tregtar (eksport-import)**, ashtu që **54,5% të vëllimit të përgjithshëm të eksportit tonë është kahëzuar drejt tregu i BE-së**, 12,2% drejt Kosovës, 7,6% drejt Serbisë, 3,3% Ukrainës, 3,0% drejt Kinës etj., **ndërsa 74% të importit tonë vjen nga vendet e anëtare të BE-së**, 7,9% të Serbisë, 4,9% të Turqisë, 2,2% të Kroacisë, 1,6% të Kinës etj.

Harmonizimi i legjislacionit

Implementimi i Nenit 68 të Marrëveshjes për Stabilizim Asociim, në mënyrë të përpiktë kërkon harmonizimin e gjithë legjislacionit ekzistues dhe të ardhëm, me atë të BE-së (acquis communautaire), ndërsa paralelisht me atë proces edhe ndërtimin e kapaciteteve institucionale për zbatimin efikas të tij. Përmes **harmonizimit të legjislacionit të Republikës së Maqedonisë me atë të BE-së**, realizohet absorbim gradual të korpusit të plotë të **acquis communautaire**, me çka sigurohet taban ligjor për pjesëmarrje aktive të Republikës së Maqedonisë, në zhvillimin e ardhshëm të së drejtës së BE-së pas arritjes së anëtarësimit të plotfuqishëm në BE. **Maqedoni** menjëherë pas nënshkrimit të MSA-së dhe **Mar-**

rëveshjen e përkohshme tregtare, në mënyrë të vazhdueshme, sistematike, të organizuar dhe të përpiktë, ka hyrë në procesin e aproksimacionit, që deri më sot ka rezultuar me **transpozicion të mbi 2.300 dispozitave të BE-së (rregulla, direktiva, vendime)** në legjislacionin tonë nacional, edhe atë në më shumë se **350 akteve ligjore dhe mbi 1.800 akteve nënligjore**. Angazhimi i qartë për afrim të legjislacionit nacional drejt atij të BE-së në periudhën e kaluar është vënë në **Ligjin për Qeveri të Republikës së Maqedonisë**, si dhe të **dispozitave afariste të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe Rregulloren për punë të Republikës së Maqedonisë**, ndërsa **Sekretariati për legjislacion** morri kompetenca të reja për vlerësim të harmonizimit dhe dispozitave me legjislacionin e BE-së. Hartuesit e dispozitave juridike, të cilat janë lëndë të harmonizimit me të drejtën e BE-së, detyrimisht dorëzojnë **Deklaratë për harmonizim** të dispozitave të reja juridike me ato të *acquis communautaire*. Përmes kësaj procedure, gjatë gjitha këtyre viteve që lëmë pas, Republika e Maqedonisë e morri legjislacionin e BE-së si **model referues** gjatë përgatitjes së të gjitha dispozitave të reja juridike. Përveç kësaj, inkluziviteti në proces, gjegjësisht pjesëmarrja në **opinionin akademik, gjykatësit, prokurorët, subjektet ekonomike, sektori joqeveritar**, sigurojnë implementim më efikas të dispozitave juridike. Rezultatet e procesit të harmonizimit të legjislacionit tonë me atë të BE-së, me siguri do të ishin më të mirë, nëse Këshilli i BE-së siguronte konsensus për avancimin tonë në **Fazën e dytë të implementimit të MSA-së**, gjegjësisht nëse merrej **vendimi** shumë që moti i merituar, **për fillim të negociatave aderuese**.

Përkthimi i së drejtës evropiane

Suksesi dhe dinamika e procesit të harmonizimit të legjislacionit, varet nga cilësia e **përkthimit të dispozitave evropiane**. Republika e Maqedonisë nga fillimi, krijoi sistem funksional dhe efikas të përkthimit të dispozitave juridike të BE-së, që në fakt paraqet **përgatitje të versionit të maqedonishtes së *acquis communautaire***, i cili do të themelohet në sistem nacional juridik. Përmes implementimit të MSA-së, e para së gjithash për shkak të nevojës për përsheptim të procesit të transpozicionit të së drejtës së BE-së në sistemin tonë nacional, Republika e Maqedonisë siguroi **përkthim të profesionalizmit të lartë të mbi 8.000 akteve juridike të BE-së** (rregulla, direktiva, vendime etj), gjegjësisht përkthim në gjuhën maqedonase të **rreth 87.000 faqeve** të tekstit juridik nga gjuhët e vendeve anëtare të BE-së.

Planifikimi dhe monitorimi

Parimisht çdo vit Qeveria e Republika e Maqedonisë përgatit **Programi për afrim të legjislacionit nacional drejt atij të BE-së (NPAA)**. Në të jepet pasqyrim të detajuar të aktiviteteve të afrimit, masat e BE-së, të cilat janë lëndë e transpozicionit në ligjet nacionale, institucionet kompetente dhe afatet e implementimit. Në **fazën fillestare të implementimit të MSA-së**, Programi për harmonizim ishte më i thjeshtë dhe me numër më të vogël të aktiviteteve, me qëllim të artikulohet dhe evoluohet në një plan gjithëpërfshirës, kompleks dhe të detajuar, i cili e determinon kornizën e veprimit të Qeverisë në të gjitha sektorët dhe në të gjitha institucionet e veta, por e dikton edhe fushëveprimin e punës dhe të Kuvendit të RM-së. Nga ana tjetër politika jonë nacionale ekonomike, si platformë për dialog me BE-në orientohet përtej **programeve trevjeçare ekonomike paraaderuese. Monitorimi i procesit të harmonizimit të legjislacionit dhe implementimit të tij**, gjegjësisht monitorimi i implementimit të Programit nacionale për harmonizim në legjislacionin nacional me atë evropian (NPAA) është shembull i mirë për vënie të sistemit funksional me efekte të drejtpërdrejta kthyes operative. Implementimi i NPAA-së, përfshirë edhe MSA-në është **pikë e rregullt e seancave të Qeverisë**, si gjenerator të aktiviteteve të saj dhe korrigjues të orientimeve dhe prioriteteve.

Administrata kompetente dhe efikase

Implementimi i suksesshëm i MSA-së nuk do të ishte i mundshëm pa **administratë kompetente dhe profesionale**, ashtu që fuqizimi i vazhdueshëm i kapacitetit të institucioneve është faktor kyç për zbatim efektiv të së drejtës së BE-së në sistemin juridik nacional. Qëllimi final është krijimi i **administratës publike, e cila do të jetë e aftë ta merr përsipër barrën e integritet në Bashkimin Evropian**, më tej edhe **detyrimet, të cilat burojnë nga ajo**. Ky është prioriteti më

i lartë, i cili horizontalisht i ndërlidh të gjitha reformat të sektorëve në procesin e integritit evropian dhe paraqet faktor qenësor të suksesit të tyre. Republika e Maqedonisë vazhdimisht në mënyrë strategjike dhe sistematike realizon **reforma në pjesën e administratës**, përfshirë edhe trajnimin e specializuar për zhvillim të aftësive specifike për implementim të MSA-së, gjegjësisht për zbatim të së drejtës evropiane dhe praktikave të mira. Me këta reforma përfshihet administrata e shtetit, ajo lokale dhe publike, si dhe sistemi gjyqësor dhe organet që sigurojnë zbatim të ligjit si policia dhe shërbimet inspektuese.

Informimi i publikut

Implementimi i MSA-së dhe reformat, të cilat zbatohen në mënyrë të vazhdueshme, detyrimisht kërkon marrje të vendimeve, të cilat kanë të bëjnë me **sistemin politik, social dhe ekonomik**, me çka në masë të konsiderueshme u ndikua në mënyrën dhe cilësinë e jetës së të gjithë qytetarëve. Prandaj, në veçanti është e jashtëzakonshme, që **publiku të informohet me kohë dhe plotësisht për vendimet**, shkakët për marrje të tyre, dobi dhe shpenzime, të cilat me siguri do të dalin nga këta. Në këtë mënyrë publiku inkurajohet të merr pjesë në këtë proces dhe të angazhohet në mënyrë më proaktive dhe kyçet në të. Për momentin shumica dërmuese e popullatës e mbështet anëtarësimin e plotfuqishëm në Bashkimin Evropian edhe përkundër variacioneve, që kohëve të fundit hasen, gjegjësisht ndodhive negative në lidhje me BE-në dhe unionin monetar.

Menaxhimi dhe koordinimi i implementimit të MSA-së

Gjatë viteve të kaluara implementimi i Marrëveshjes komplekse për stabilizim asociim (nga vitin 2004) gjegjësisht e Marrëveshjes së përkohshme tregtare profilizoi **kompetenca të posaçme** të institucioneve kompetente ekzistuese, të formuara në institucione të reja nacionale, definimi i organeve dhe procedurave për **bashkëpunim ndërinstitucional dhe koordinim** dhe krijim të **organeve të përbashkëta të Qeverisë dhe Kuvendit të MR-së me Bashkimin Evropian, Komisionin Evropian he Parlamentin Evropian**, përmes së cilëve ndiqet dhe kahëzohet implementimi i MSA-së. Në nivel institucional, **struktura e menaxhimit me procesin e integritit evropian** filloi të zhvillohet para pothuajse dhjetë viteve. **Kontinuiteti dhe profesionalizmi**, si bazë për akumulim të diturisë dhe përvojës, mundësoi **stabilitet dhe avancim** të mëtejme në drejtim të zgjerimit dhe thellimit të ingerencave dhe detyrave, por edhe përmirësim të funksionimit dhe efikasitetit. **Në vitin 2001 sistemi i përhershëm**, natyrshëm e mori përgjegjësinë për koordinim të implementimit të MSA-së dhe atë funksion e përmbush me sukses gjatë gjithë periudhës së kaluar. Në këtë drejtim struktura plotësisht korrespondon me të gjitha institucionet dhe funksionet shtetërore përmes inkorporimit të MSA-së në Kushtetutat e tyre dhe ingerencat ligjore, në sferat të cilat i prekin segmentet e implementimit të MSA-së.

Kompetencat e posaçme

Kryetari i Republikës së Maqedonisë, si institucion më i lartë me kompetenca në sferën e politikës së jashtme, përmes sigurimit të politikës së quajtur “një zë” ka vend të rëndësishëm dhe ndikim në gjithë procesin e integritit evropian, përfshirë edhe implementimin e MSA-së. Nga ana tjetër **Kuvendit të Republikës së Maqedonisë**, me rol kyç në procesin e miratimit të akteve të reja ligjore, i besua roli të sigurojë, që ato akte ligjore plotësisht të harmonizohen me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Kuvendi në këtë proces është ndihmuar nga **Komisioni për Çështje Evropiane në kuadër të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë**, i cili mes tjerash e ka për detyrë t’i përmbush ta ndjek përmbushjen e detyrimeve, të cilat dalin nga marrëdhëniet kontraktuese ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian, si dhe nga **Këshilli Nacional për Integritim Evropian**, siç organ i specializuar për mbikëqyrje të procesit të integritit evropian, të paraqitur nga përfaqësuesi i opozitës, me pjesëmarrje në punën e vetë dhe të përfaqësuesve të shoqërisë qytetare, si platformë për sigurim të inkluzivitetit në proces. **Qeveria e Republikës së Maqedonisë** në procesin e integritit evropian, pa dyshim ka rol qendror dhe të përgjegjshëm, gjegjësisht ka për detyrë t’i definojë prioritetet strategjike,

të cilat i fut në Programin e vetë vjetor të punës dhe për ta siguron mbështetje financiare me mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe burime tjera. Po ashtu Qeveria është partner i drejtpërdrejtë në komunikim me institucionet relevante të BE-së. Për ta dëshmuar përkushtimin vetë në procesin e integritimit dhe implementimit të MSA-së Qeveria ka emëruar **Zëvendës kryeministër për Çështjet Evropiane** (nga viti 1996 e këndej), me çka i jep peshë të madhe politike gjithë procesit të integritimit evropian dhe implementimit të MSA-së. Zëvendëskryeministri i Qeverisë i ngarkuar me çështjet evropiane është ministër përgjegjës për menaxhimin dhe koordinimin e procesit të integritimit evropian. Në këtë drejtim mbështetja profesionale administrative sigurohet Sekretariatit për çështje evropiane. **Ministria e Punëve të Jashtme** është kompetente për promovim të qëllimeve tona të jashtme politike, afirmimin e rezultateve të arritura dhe sigurimin e mbështetjes së jashtme politike për procesin integruar të Republikës së Maqedonisë. Në këtë drejtim është e patjetërsueshme të sigurohen, përcillen, distribuohen dhe prezantohen në të gjitha informacionet politike, strategjike, operative dhe pozicionet, që kanë të bëjnë me integritimin evropian përmes **Misionit të Republikës së Maqedonisë në BE, me seli në Bruksel**, edhe atë të të gjitha strukturat tona në vendet anëtare të BE-së, te ambasadat e vendeve anëtare të BE-së në vend dhe te të gjitha strukturat tjera evropiane. MPJ-ja siguron mbështetje në aspektin e politikës së jashtme të integritimit, me theks të veçantë në dialogun politik, bashkëpunimin rajonal, marrëdhëniet kontraktuese me BE-në dhe vendet anëtare të saj, vendet aderuese, vendet e reja anëtare, vendet kandidatë, vendet fqinje dhe vendet anëtare të procesit të stabilizim asociimit. **Sektori për Integritime Evropiane**, më pas kaloi në **Sekretariat i Qeverisë për Çështje Evropiane**, nën kompetencë të drejtpërdrejtë të zëvendës kryeministër për çështjet evropiane, ka për detyrë ta organizojë, koordinojë dhe sinkronizojë procesin e integritimit evropian. Aktivitetet më të rëndësishme të Sekretariatit kanë të bëjnë me ndjekjen e implementimit të Marrëveshjeve me BE-në, koordinimin horizontal të afrimit të legjislacionit vendor drejt legjislacionit të BE-së, mbështetje dhe udhëzim drejt procesit të përgatitjes së institucioneve për funksionim në BE, përkthim të dispozitave evropiane, orientim drejt fondeve të BE-së, koordinim të ndihmës së huaj si dhe informim dhe publicitet në lidhje me BE-në dhe procesin e integritimit evropian.

Koordinimi ndërmjet resorëve

Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka krijuar **sistem të institucionalizuar për koordinim ndërmjet resorëve në procesin e integritimit evropian** në më shumë nivele. Përpos kompetencave të rregullt të Qeverisë së RM-së, Zëvendëskryeministrit për çështjet evropiane dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme në drejti të sigurimit të qasjes së koordinuar dhe sinkronizuar për realizim të detyrimeve tona në procesin e integritimeve në BE, përfshirë edhe implementim e MSA-së, u formuan edhe organe të reja plotësisht operative. **Komiteti i Punës për Integritim Evropian**, i kryesuar nga Zëvendëskryeministrit për çështjet evropiane, ku bëjnë pjesë edhe sekretarët shtetërorë të të gjitha ministrive, si dhe përfaqësues të organeve tjera kyçe (Drejtoria e të Hyrave Publike, Dogana, Banka Popullore e RM-së, Enti i Statistikës etj.). Komiteti i Punës funksionon sipas strukturës operative, në të cilën shqyrtohen çështje të rëndësishme në sferën e integritimeve evropiane (implementimi i marrëveshjeve me BE-në, ndjekja e procesit të stabilizim asociimit, harmonizimi i legjislacionit, përkthimi i akteve ligjore, koordinimi ndihmës së huaj), gjegjësisht propozime dhe zgjidhje për intensifikim të procesit integruar. Po ashtu është themeluar edhe **Nënkomiteti i Komitetit të punës për integritime evropiane për afrim të legjislacionit të Bashkimit Evropian**, ku koordinohen kahjet operative në funksion të realizimit të Programit për punë të Qeverisë, e sinkronizuar më Programin Nacional për miratim të së drejtës së Bashkimit Evropian (PNMD-BE), gjegjësisht implementim të MBA-së dhe përdorim të fondeve të BE-së. Janë formuar edhe **Grupe të specializuara të punës për harmonizim me *acquis communautaire***, duke e ndjekur strukturën 35 kapitujve të *acquis*. Në punën e tyre marrin pjesë përfaqësues të ministrive, institucioneve shkencore, Oda ekonomike, Sekretariati për legjislacion dhe subjekte tjera.

Organet e përbashkëta për ndjekje të implementimit të MSA-së

Pas hyrjes në fuqi të MSA-së, nga 01 prilli i vitit 2004, në pajtim me dispozitat e saj, formohen organe të përbashkëta ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian, edhe atë, **Këshilli për Stabilizim dhe Asociim**, i cili njëherë në vit zhvillon takime në Bruksel në nivel të Ministrave të punëve të brendshme, si dhe forumi për dialog politik

në lidhje me çështjet më të ndjeshme politike, që kanë të bëjnë me procesin e integrimit dhe implementimit të MSA-së; **Komiteti për Stabilizim dhe Asociim**, i cili njashu takohet njëherë në vit në Bruksel dhe Shkup, me **shtatë nën-komitete**, si organe ndihmëse, të cilat mbulojnë sera të ndryshme të MSA-së përmes, të cilave ndiqen të gjitha detajet dhe aspektet teknike të implementimit të MSA-së dhe **Grupit të specializuar** për ndjekje të Reformës së administratës publik; **Komiteti i përbashkët parlamentar për stabilim dhe asociim RM-BE**, si forum, në të cilin deputetët shkëmbejnë opinione, diskutojnë çështje të ndara dhe i shqyrtojnë perspektivat për integrim të Maqedonisë në Bashkimin Evropian.

Shpenzimet dhe mbështetja financiare për implementim të MSA-së

Implementimi i MSA-së shkakton **pasoja të drejtpërdrejta dhe të tërthorta**, ndaj buxhetit tonë shtetëror dhe ekonomisë sonë, gjegjësisht ndaj operatorëve ekonomik. **Shpenzimet për implementim të MSA-së** dhe në përgjithësi për realizim të qëllimit tonë strategjik për integrim të plotë në BE pothuajse është e pamundshme të llogariten, mirëpo është plotësisht e qartë se ato janë **jashtëzakonisht të larta**. Peshë e **buxhetit nacional** në formë të **shpenzimeve të drejtpërdrejta** për realizim të reformave, definim të politikave të reja sektoriale, përgatitje të institucioneve ekzistuese, krijim të institucioneve të reja dhe hapje të vendeve të reja të punës dhe ndërlidhja me rrjetin e infrastrukturës evropiane kërkon investime të mëdha shtetërore dhe tjera. Këtu duhet të përfshihen edhe investimet dhe shpenzimet e operatorëve ekonomik, si **shpenzime të tërthorta** për gjithë ekonominë, e cila vazhdimisht duhet në mënyrë intensive të investojë, për shkak të hasjes së standardeve të reja për sigurinë dhe cilësinë e prodhimeve, përfshirjen e teknologjive bashkëkohore dhe përmirësimin e konkurrencës së produkteve të tyre në tregun vendor, rajonal dhe evropian. Në shpenzimet e integrimit, gjegjësisht në implementimin e MSA-së dhe Marrëveshjes së përkohshme tregtare duhet të merren parasysh edhe **të ardhurat e humbura në formë të doganës, tatimeve dhe akcizave**, për shkak të liberalizimit të marrëdhënieve tregtare me BE-në dhe hapje të tregut tonë për prodhimet evropiane.

Në masë të madhe shpenzimet e këtylla janë **ngarkesë e buxhetit nacional dhe operatorëve ekonomik**, ndërsa një pjesë më e vogël kompensohet përmes **fondeve të BE-së** për mbështetje të procesit të integrimit. Implementimi i MSA-së ishte i mbështetur në fillim përmes **Programit FARE (PHARE)** (1991-1999) me rreth **25-20 milion euro** në vit, më tej përmes **Programit KARDS (CARDS)** (2000-2006) me rreth **40-45 milion euro** dhe përmes **Programit IPA** (2007-2013) me rreth **80-85 milion** në vit. Me kushte të caktuara në fillim të implementimit të MSS-së janë përdorë edhe **grante dhe kredi** për sigurim të bilancit të rrogave dhe stabilitetit makroekonomik, ndërsa gjatë krizës së Kosovës edhe tensionit të brendshëm edhe **mbështetje e drejtpërdrejtë buxhetore** dhe mjete për tejkallim të pasojave të krizës dhe implementim të Marrëveshjes kornizë të Ohrit. Ndihma përmes fondeve të BE-së është plotësisht e targetuar dhe ka prioritetë të fokusuar në ndihmën teknike dhe investimeve me qëllim që të mbulohen shpenzimet e rritura për implementim të reformave dhe përmirësim të kriterëve politike dhe ekonomike. Për harmonizim të legjislacionit dhe përgatitjes së administratës për anëtarësimin e ardhshëm në BE, si dhe përmirësim të infrastrukturës sonë shfrytëzohen edhe instrumentet **TAIEX, Twinning** projekte dhe pjesëmarrje në **Programet dhe Agjencitë e Unionit**. Mbështetja për implementim të MSA-së përmes fondeve të BE-së, vazhdon edhe më tej përmes **Programit IPA2** (2014-2020), me potencial për përdorim të rreth **85 milion eurove** në vit.

Gjatë disa viteve të fundit të implementimit të fondeve të BE, me sukses është krijuar një sistem kompleks në nivel nacional për **planifikim, programim dhe monitorim**, si dhe **implementim të decentralizuar** të fondeve të disponueshme të BE-së. Sistemi është komplementar me funksionet e Delegacionit të BE-së në vend dhe nga viti në vit paraqet përparim në shkallën e absorbimit të mjeteve të disponueshme.



Ana Lind, ministre e punëve të jashtme të Suedisë dhe presidente e Këshillit të Evropës bisedoi para nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimitme Ljubčo Georgievski, kryeministrin e Maqedonisë, me Sërxfhan Kerimin, ministrine punëve të jashtme të Maqedonisë dhe me Kristofer Patenin, anëtar i Komisionit Evropian. Maqedonia ka qenë shteti i parë i Ballkanit Perëndimor, që me sukses i ka përmbyllur negociatat dhe e ka nënshkruar këtë Marrëveshje me BE-në.



Përfaqësues të Bashkimit Evropian dhe Republikës së Maqedonisë në rreshtin e parë (nga e majta në të djathtë) Sër Khan Kerim, Ljubčo Georgievski, Bedredin Ibrahim, Zoran Krstevski në protokolll dhe Arben Xhaferi, Risto Gushterov, Brano Crvenkovski të tubuar me rastin e nënshkrimit zyrtar të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit në Luksemburg.

Përgjigjet e pyetësorit



Dr. Fatmir Besimi,

Zëvendës Kryeministër për Çështje Evropiane, Qeveria e Republikës së Maqedonisë

Përshkruani se si MSA ka mbështetur përpjekjet e Republikës së Maqedonisë për të përmbushur kriteret politike për anëtarësim në BE.

Nënshkrimi i Marrëveshjes për SA ndodhi në vitin më të trazuar politik për Maqedoninë. Me ndihmën e SHBA-ve, BE-së dhe NATO-s, në vitin e njëjtë, nga njëra anë, u nënshkrua Marrëveshja Kornizë e Ohrit si një bazë e re për zhvillimin e marrëdhënieve të brendshme ndërnacionale, dhe nga ana tjetër, u nënshkrua Marrëveshja për SA me të cilën u hap perspektiva e vendit drejt integritit të plotë të vendit në BE. Prej atëherë e deri më sot, në bazë të Marrëveshjes për SA, Maqedonia punon vazhdimisht dhe me vendosmëri në drejtim të përmbushjes së kriterëve politike të Kopenhagës, ku është vendosur edhe përmbushja e objektivave të Marrëveshjes së Ohrit. Unë vendosmërisht besoj se përmbushja e kriterëve politike, nuk është një qëllim në vetvete, por një nevojë historike dhe vendimtare për zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë shumëkombëshe dhe shume fetare të Maqedonisë.

Përveç kësaj, zbatimi i marrëveshjes pasqyroi një përpjekje të fuqishme për rritjen dhe zhvillimin e shoqërisë civile me çka filluan procesin e reformës së administratës publike, si dhe është kryer edhe reforma gjithëpërfshirëse e gjyqësorit. Rritja e bashkëpunimit me BE-në në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme, kontribuoi ndaj përmirësimit të parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe për të forcuar parimet e shtetit ligjor.

Përshkruani se si MSA ka përkrahur harmonizimin e legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian, duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve administrative për të zbatuar ligjet e reja.

Marrëveshja për SA menjëherë pas nënshkrimit, filloi një proces të harmonizimit të legjislacionit tonë me BE-në, e cila gradualisht ndryshoi fizionominë e shoqërisë sonë. Një proces masiv që pothuajse nuk la anash askënd, nga Qeveria dhe i gjithë pushteti ekzekutiv e cila përmes politikave të reja dhe projekteve ligjore e rimodeloi të gjithë sistemin, përmes Parlamentit e cila kaloi shumë qindra ligje, reformat e thella në reformën e sistemit gjyqësor dhe reformat në administratë, deri në angazhimin e gjerë të komunitetit akademik dhe ekspertëve dhe vet shoqërisë civile. I gjithë vendi gjithë këto vite pulsonte përmes procesit të integritit, fjalëve dhe mekanizmave të Marrëveshjes për SA. Edhe pse masiv, procesi i harmonizimit të legjislacionit është i planifikuar mirë, nëpërmjet Programit Kombëtar për Harmonizimin e Legjislacionit (PKHL), është i monitoruar mirë dhe trupat punues të Qeverisë dhe Parlamentit dhe, sipas mendimit tim, të organizuar mirë dhe menaxhohet nga Sekretariati për çështje evropiane. Pajtueshmëria e legjislacionit kombëtar me legjislacionin e BE-së është konfirmuar edhe me strategjinë e fundit të zgjerimit, duke deklaruar se vendi ka arritur një shkallë të lartë të konsistencës kur është në procesin e pranimit dhe ka bërë progres në përmirësimin e aftësisë për të përmbushur detyrimet e anëtarësimit të plotë. Maqedonia kohë më parë ka dëshmuar se është politikisht e pjekur dhe me institucione të gatshme për hapin e ardhshëm, që është fillimi i negociatave për anëtarësim.

Përshkruani se si MSA ka promovuar marrëdhëniet ekonomike të harmonizuara dhe gradualisht ka zhvilluar një zone për tregti të lirë mes BE-së dhe Republikës së Maqedonisë.

Marrëveshja për SA dhe Marrëveshja e Përkohshme për Tregti, përmes trajtimit preferencial asimetrik të produkteve tona, nga njëra anë siguroi kushte të favorshme për eksportet tona dhe përmirësimin e konkurrencës së produkteve tona në tregun e BE-së, dhe nga ana tjetër, siguruan që ndikimi konkurrues në tregun tonë të brendshëm nga teknologjitë e zhvilluara të prodhimit të BE-së të janë të amortizuara. Kjo do të thotë përfitim në kohë për investime në përmirësimin e produktivitetit të prodhuesve tanë, por edhe për zhvillimin e politikave përkatëse sektoriale për të stimuluar zhvillimin e produkteve që kanë një avantazh të caktuar krahasues në tregun e BE-së. Pas nënshkrimit të MSA-së mes BE-së dhe Republikës së Maqedonisë është regjistruar rritje e dukshme në vëllimin e tregtisë midis Republikës së Maqedonisë dhe shteteve anëtare të BE-së. Në vitin 2005, eksportet në BE arritën në 1,084,151 mijë \$ të SHBA-ve, në vitin 2010 eksportet arritën 2,025,241 mijë \$ SHBA. Në vitin 2005 pjesëmarrja e vendeve anëtare të BE-së në eksport ishte 53.1%, ndërsa në vitin 2010, 61.3%. Gjithashtu investimet e huaja të drejtpërdrejta kanë shënuar një rritje të madhe të 100.4 milion euro në 2003 ndërsa 506,0 milionë euro në vitin 2007, para fillimit të krizës ekonomike globale. Harmonizimi i ekonomisë sonë me ekonominë e BE-së është në rritje dhe me siguri do të vazhdojë më tutje, duke pasur parasysh se edhe ekonomia e BE-së është në evolucion dhe ndryshim e sipër, respektivisht është e pashmangshme të përshtaten me trendet ekonomike globale. Maqedonia përmes organeve të MSA-së ka një dialog të rregullt dhe të qëndrueshëm me BE-në dhe Komisionin Evropian në lidhje me politikat tona ekonomike dhe drejtimin e tyre të vazhdueshëm ndaj politikave ekonomike të BE-së, duke e përdorur si bazë programin ekonomik të para-aderimit.

Përshkruani se si përmes MSA-së është arritur bashkëpunimi rajonal në fushat të cilat janë të përfshira me Marrëveshjen.

Fakti se Marrëveshje për SA nënshkruan të gjitha vendet e rajonit, përveç Kosovës, negociatat me BE-në e të cilit janë të vazhdueshme, dhe se të gjitha marrëveshjet një nga kapitujt kryesore është se cili fokusohet në bashkëpunimin rajonal në platformën e harmonizuar flet prerazi për rëndësinë e bashkëpunimit rajonal. Përveç kësaj, një parakusht i domosdoshëm për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndërmjet vendeve të rajonit dhe BE-së ishte nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me secilin vend anëtar të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Këso marrëveshje janë nënshkruar me Kroacinë, Serbinë, Shqipërinë dhe Malin e Zi dhe ato përfshijnë bashkëpunim në dialogun politik, krijimi i një zone të tregtisë së lirë në mes të palëve, koncesione të ndërsjella në lidhje me lëvizjen e punëtorëve, themelimin e shoqatave, ofrimin e shërbimeve, pagesat rrjedhëse dhe lëvizjen e kapitalit, bashkëpunim në fusha të tjera, etj. Pas të gjitha luftërave dhe shkatërrimeve nga dekada e fundit e shekullit të kaluar, dekada e parë e shekullit të ri, në rajonin tonë është shënuar me marrëdhënie të përtërirë, komunikim të freskët, projekte të reja të infrastrukturës rajonale dhe të kuptuar më të mirë. Natyrisht, pasojat e konflikteve nuk do të zhduken brenda natës, e as që riparohen dëmet vetvetiu. Vetëm vizion afatgjatë, vullnet më të mirë dhe gatishmëri për kompromis dhe falje, mund të rezultojë në zhvillimin e secilit vend veç e veç, dhe në këtë mënyrë të tërë rajonit. Të mos harrojmë, të gjitha vendet në rajonin tonë janë të vogla, me territor dhe numër të banorëve, ndërsa mikro-ekonomitë tona janë vetëm një pjesë e parëndësishme e tregtisë me BE-në. Por, MSA-ja ofron hapësirë për ekonomitë tona përmes bashkëpunimit rajonal dhe përdorimin e preferencave individuale apo rajonale të tregtisë për të shpejtuar zhvillimin e saj.

Përshkruani se si MSA ka përgatitur Republikën e Maqedonisë për përdorimin efikas të fondeve aktuale nga BE-ja si dhe fondet koheze dhe strukturore në të ardhmen.

Marrëveshja për SA, e përcjellë nga instrumentet financiare, që janë zhvilluar të gjitha këto vite (PHARE, CARDS, IPA), arriti të stimulojë zhvillim në kapacitetet tona administrative për planifikim dhe absorbim të fondeve në dispozicion. Obligimet dhe reformat e kërkuara nga MSA në të gjitha fushat, në periudhën e kaluar na bëri të përcaktojmë dhjetëra

strategji të reja, plane të veprimit, të përcaktojmë rendin e prioriteteve dhe të përqendrojmë fondet kombëtare dhe të BE-së të cilat janë në dispozicion për të realizuar qëllimet strategjike. Me këtë ishte e pashmangshme për të zhvilluar edhe kapacitete për planifikim, koordinim dhe zbatim të projekteve të mëdha dhe komplekse, qoftë të infrastrukturës ose të reformave të thella sistemike. Natyrisht, procesi i ndërtimit të kapaciteteve institucionale dhe mësimi, metoda dhe teknika të reja do të vazhdojë të marrë, si çdo fazë të re të integritit të mundësive të hapura të reja dhe të përballet me sfida të reja. Energjia jonë është e drejtuar drejt zbatimit sa më efikas të burimeve që kemi në dispozicion, por gjithashtu edhe për t'u përgatitur për sfidën e ardhshme, dhe kjo është përdorimi i fondeve strukturore dhe atyre të kohezionit në të ardhmen.

Cilat janë përshtypjet e përgjithshme të zbatimit të MSA-së, e cila është nënshkruar mes BE-së dhe Republikës së Maqedonisë?

Nëse e krahasoni standardin e jetesës ndërmjet vendeve të BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor do të vëreni shumë ndryshime. Në vitin 2008, PBB-ja për banorë në vendet e eurozonës ishte rreth 30,000 euro, ndërsa PBB për banorë në vendet e Ballkanit Perëndimor për atë vit ishte rreth 5,000 euro. Gjithashtu, ka edhe dallime të konsiderueshme në shkallën e papunësisë. Shkalla mesatare e papunësisë në eurozonë është 8-9%, ndërsa shkalla mesatare e papunësisë së vendeve të Ballkanit Perëndimor e tejkalon 21%. Këto të dhëna tregojnë dallime të mëdha në mes të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe vendeve anëtare të BE-së. Në vitin 2000, para nënshkrimit të MSA-së, shkalla e papunësisë në Republikën e Maqedonisë ishte 32.2%, dhe kjo u reduktua në 30.5% në vitin 2001 dhe 28.6% në vitin 2013. Me qëllim që t'i afrohem ekonomive të vendeve anëtare të BE-së, Ballkani Perëndimor, duke përfshirë edhe Maqedoninë, duhet të zhvillohet me një ritëm më të shpejtë dhe të bëhet më konkurrues.

Dua të theksoj se procesi i stabilizimit dhe asociimit e cila u themelua në vitin 1999, ishte menduar si një mekanizëm që do të sigurojë një perspektivë evropiane për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe politikën e BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor. Në këtë mënyrë këto vende ishin të përfshira në një partneritet progresiv që kanë për qëllim stabilizimin e rajonit dhe krijimin e një zone të tregtisë së lirë.

Dhjetë vjet të zbatimit të qëndrueshëm të Marrëveshjes për SA dhe realizimin e të gjitha angazhimeve tona, nuk mund të mos konsiderohet si sukses. Vendosja e mekanizmave funksional institucional, sigurojnë një dialog të papenguar dhe të vazhdueshëm në të gjitha nivelet e BE-së dhe udhëzime për përcaktimin dhe zbatimin e reformave gjithëpërfshirëse dhe të thella në të gjitha fushat e mbuluara nga MSA. Përdorimi i instrumenteve financiare, veçanërisht nëpërmjet zbatimit të një sistemi të decentralizuar, me të cilën u shtua pronësia jonë ndaj mjeteve, ndihmuan në zbatimin e suksesshëm të projekteve të shumta me efekt të dukshëm. Liberalizimi i plotë i tregtisë, krijoi hapësirë për investime të reja dhe rritjen e prodhimit dhe eksportit. Për të përfunduar përshtypjet pozitive të zbatimit dhjetë vjeçar të Marrëveshjes për SA, nevojiten ende më shumë përpjekje dhe punë për të siguruar një kalim formal në fazën e dytë të MSA-së, e cila do të sigurojë një zbatim të plotë për të gjitha detyrimet kontraktuese. Unë fuqimisht besoj se sa më shpejt të jetë e mundur do të fillojmë negociatat gjatë të pritura për anëtarësim, sepse unë jam i bindur që Republika e Maqedonisë nuk ka një opsion tjetër, pos që të jetë një anëtar i familjes evropiane, aty ku edhe takon.



Mr. Nikolla Poposki,

Ministër i Punëve të Jashtme i Republikës së Maqedonisë

Përshkruani se si MSA ka mbështetur përpjekjet e Republikës së Maqedonisë për të përmbushur kriteret politike për anëtarësim në BE.

Marrëveshja për SA në Kapitullin e VII-të Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme përfshijnë detyrimet kryesore kontraktuese dhe udhëzimet në lidhje me përmbushjen e kriterëve politike - forcimin e institucioneve dhe sundimin e së drejtës me një fokus të veçantë në sigurimin e pavarësisë së gjyqësorit, përmirësimin e efikasitetit të saj dhe trajnim për gjykatësit dhe prokurorët. Në periudhën e kaluar 10-vjeçare u sigurua një rrjedhë e rregullt e dialogut midis Republikës së Maqedonisë dhe BE-së për përmbushjen e kriterëve politike (duke përfshirë edhe nëpërmjet organeve të MSA-së - Këshillin, Komitetin dhe nën komitetet).

Maqedonia bëri reformë të plotë të gjyqësorit në periudhën 2004-2010 brenda të cilit u përfshinë ndryshime të rëndësishme të Kushtetutës, miratimin e Ligjit për Gjykatat dhe Ligjin për Këshillin Gjyqësor, themelimin e Akademisë për trajnim të gjykatësve dhe prokurorëve, duke futur kriterë më të rrepta profesionale për kryerjen e funksioneve të gjyqësorit dhe të prokurorisë, ngritjen e Gjykatës Administrative, zbatimin e vendimeve të gjykatave nga të punësuar profesional, duke reduktuar gjykimet e mbetura gjyqësore, futjen e ndihmës ligjore falas dhe ndërmjetësimin, futjes së një sistemi të automatizuar për menaxhimin e lëndëve gjyqësore dhe E-drejtësi, si dhe një reformë e plotë të ligjit penal dhe reformën policore.

Në fushën e politikave anti-korrupsion korniza legislative në masë të madhe është e kompletuar dhe i është nënshtuar raundeve të përsëritura të vlerësimit GRECO në periudhën prej vitit 2002. Janë themeluar një numër i organeve dhe agjencive nacionale të përfshira në luftën kundër korrupsionit dhe forcimin e kapaciteteve administrative. Është zhvilluar një dosje për arritjet e aktpadive të ngritura, akuza dhe aktgjykime nga ana e organeve të ligjit dhe të gjykatave, si dhe aktivitetet parandaluese të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

Në vitin 2000 është miratuar Ligji për punonjësit shtetëror i cili rregullon statusin, të drejtat, obligimet, përgjegjësitë dhe sistemin e pagave për shërbyesit civil. Aktuale është reforma gjithëpërfshirëse në sistemin e administratës publike e bazuar në parimet e transparencës, meritës dhe përfaqësimit të drejtë. Vazhdimisht avancohet edhe legjislacioni administrativ (Ligji për procedurë të përgjithshme administrative, Ligji për konteste administrative, Ligji për inspektimin administrativ).

Kuadri kushtetues dhe ligjor i vendit është në përputhje me Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, e cila është në fuqi në Republikën e Maqedonisë që nga viti 1997. Në vitin 1997 është themeluar Avokati i Popullit ndërsa ligji për mbrojtjen e të dhënave personale ka hyrë në fuqi në vitin 2005, kur u krijua edhe Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Për zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit e nënshkruar në vitin 2001 u miratuan 15 amendamente kushtetuese dhe u ndryshua Preambula e Kushtetutës. Gjithashtu janë miratuar edhe 70 ligje me të cilat u zbatuan parimet e paraqitura në kontratë.

Në 5 rekomandimet e fundit të njëpasnjëshme të negociatave të KE-së me Republikën e Maqedonisë u konstatua se vendi i plotëson kriteret politike dhe vazhdon të bëjë progres në të gjitha fushat prioritare në fushën e demokracisë dhe sundimit ligjor.

Përkruani se si MSA ka përkrahur harmonizimin e legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian, duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve administrative për të zbatuar ligjet e reja.

MSA-ja ofron kornizë sistematike për harmonizimin e legjislacionit nacional me legjislacionin e BE-së dhe ristrukturimin institucional sipas strukturave kryesore administrative të BE-së. Prioritetet për pajtueshmërinë ligjore të identifikuara në MSA e udhëhoqën procesin e përafrimit ligjor, i cili ishte me prioritet në mënyrë të mirëfilltë me partneritetet e Evropës/aderimit.

Në bazë të MSA-së janë zhvilluar mekanizma/plane nacionale për harmonizimin e legjislacionit dhe ndërtimit të institucioneve. Nga arritja e statusit të kandidatit, qeveria çdo vit përgatit dhe azhurnon Programin nacional për miratimin e së drejtës së BE-së e cila e përcakton dinamikën e miratimit të acquis, drejtimet strategjike, politikat, reformat, strukturat, resurset dhe afatet që duhet të zbatohen me qëllim që RM të plotësojnë kushtet për anëtarësim në BE.

Institucionet e Maqedonisë treguan një shkallë të lartë të përmbushjes dhe vetë iniciativës sa i përket programimit legjislativ. KE në raportet e tyre të progresit ka konstatuar se RM ka arritur tashmë një nivel të lartë të pajtueshmërisë në krahasim me fazën në të cilën gjendet procesi i aderimit dhe se vazhdimisht përparon në përmirësimin e aftësisë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit në BE.

Zbatimi i MSA-së nxiti ndryshime në institucionet ekzistuese në vend, si dhe krijimin e një numri të madh të institucioneve të reja. Të njëjtat janë tashmë të etabluara dhe fokusi është në gjenerimin e një dosjeje të besueshme gjatë zbatimit të përgjegjësisë të tyre.

Përkruani se si MSA ka promovuar marrëdhëniet ekonomike të harmonizuara dhe gradualisht ka zhvilluar një zone për tregti të lirë mes BE-së dhe Republikës së Maqedonisë.

Me hyrjen në fuqi të MSA-së tregtia e jashtme është liberalizuar plotësisht. Zbatimi efektiv i Marrëveshjes së Përkohshme (e cila zbatohet edhe para ratifikimit të MSA-së nga të gjitha vendet anëtare të BE-së) si dhe zbatimi i mëtejshëm i protokolleve që rregullojnë tregtinë reciproke me Bashkimin Evropian, kanë kontribuar në përmirësimin dhe rritjen e këmbimit tregtar të vendit tonë me BE-në. Zona e lirë ekonomike me BE-në u themelua me 1 janar të vitit 2011.

Në fazën e parë të zbatimit të Stabilizim-Asociimit u eliminuan monopolet shtetërore në fushën e telekomunikacionit dhe u forcua mbrojtja e së konkurrencës së tregut. Në radhë të parë u formua administrata e Monopolit brenda Ministrisë së Ekonomisë e cila me miratimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës u shndërrua në një komision si që organ i pavarur shtetëror përgjegjës për mbrojtjen e konkurrencës në Republikën e Maqedonisë. Që nga viti 2006, kontrolli i ndihmës shtetërore është marrë përsipër nga Komisioni.

Hyrja në fuqi e MSA-së do të thotë liberalizimi i rregullave për themelimin e ndërmarrjeve. Hyrja në fazën e dytë të zbatimit të MSA-së (për çka, sipas procedurave të brendshme të BE-së, nevojitet pëlqim nga Këshilli i BE-së) do të shënojë edhe liberalizim më të madh për themelimin e ndërmarrjeve nga subjekte të huaja. Faza e dytë e zbatimit të MSA-së do të shënojë edhe liberalizimin e një pjese të madhe të shërbimeve financiare.

Zbatimi i Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim ka pasur efekte pozitive në ekonominë e Republikës së Maqedonisë. Liberalizimi i tregtisë, rregullimi i monopoleve shtetërore dhe krijimi i kushteve të barabarta për sipërmarrje të subjekteve ekonomike kontribuoi që Republika e Maqedonisë të konsiderohet si “de facto” ekonomi funksionale e tregut (ky status i është njohur Maqedonisë nga Banka Botërore, por jo edhe nga ana KE-së, Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit).

Përshkruani se si përmes MSA-së është arritur bashkëpunimi rajonal në fushat të cilat janë të përfshira me Marrëveshjen.

MSA-ja dha një shtytje të fortë dhe një dimension të ri në zhvillimin dhe thellimin e bashkëpunimit rajonal. Në bazë të dispozitave të Nenit 12 të MSA-së në 10 vitet e fundit është zgjeruar kuadri kontraktues për bashkëpunim me çdo vend nga procesi i Stabilizim-Asociimit me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me BE-në. Kontratat përfshijnë elemente të dialogut politik, krijimin e një zone të tregtisë së lirë në mes të palëve, koncesione të ndërsjella në lidhje me lëvizjen e punëtorëve, krijimin e kompanive, ofrimin e shërbimeve, pagesat rrjedhëse dhe lëvizjen e kapitalit, bashkëpunimit në fusha të tjera, etj.

Me nënshkrimin e marrëveshjeve për bashkëpunim në kuadër të pranimit në BE me Kroacinë, Serbinë, Shqipërinë, Malin e Zi dhe Turqinë u hap një fushë e gjerë për shkëmbimin e përvojave në procesin e integritit evropian. Me këto dialogu politik dhe marrëdhëniet dypalëshe mes vendeve fituan një cilësi të re. Marrëveshjet parashikojnë mekanizma institucionale për zbatimin e tyre dhe paraqesin një mjet të shkëlqyer për thellimin e bashkëpunimit për çështjet e BE-së dhe që kanë të bëjnë me sfidat e procesit të pranimit në BE.

Republika e Maqedonisë ka marr/merr pjesë në mënyrë aktive në nismat rajonale, duke përfshirë Procesin për bashkëpunimin në Evropën Jug-Lindore, Këshillin për bashkëpunim rajonal, Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), Nisma e Evropës Qendrore (CEI) dhe SECI - qendra në Bukuresht, MAARI - Qendra në Shkup, e nënshkruan protokollin plotësues për liberalizimin e mëtejshëm të bujqësisë në kuadër të Marrëveshjes së CEFTA-s, Marrëveshjes së Komunitetit të Energjisë dhe të Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA). RM vazhdoi të jep kontributin e tij ndaj misionit ALTHEA të BE-së në Republikën e Bosnjës dhe Hercegovinës. Përfaqësi në Republikën e Maqedonisë gjithashtu kanë edhe Rrjeti shëndetësor i vendeve të EJT, Sekretariati i Rrjetit të Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS), Grupi i Përhershëm Punues për Zhvillim Rajonal Rural (GSP), ndërsa me përfaqësues të tyre merr pjesë edhe në Këshillin për bashkëpunim rajonal . Republika e Maqedonisë ka statusin e vëzhguesit në procesin e Danubit, ndërsa plotësisht mbështet qasjen makro-rajonale për bashkëpunim të promovuar nga Bashkimi Evropian dhe ka paraqitur kërkesë për përfshirje në strategjinë makro rajonale të Adriatik-Jon.

BE-ja përmes instrumenteve për ndihmë financiare në vazhdimësi e përkrah bashkëpunimin ndërkuftar. Republika e Maqedonisë është duke implementuar projekte të përbashkëta me Greqinë, Bullgarinë, Shqipërinë, dhe rishtazi përmes IPA bashkëpunimit ndërkuftar është nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim me Kosovën.

Përshkruani se si MSA ka përgatitur Republikën e Maqedonisë për përdorimin efikas të fondeve aktuale nga BE-ja si dhe fondet kohezive dhe strukturore në të ardhmen.

Përdorimi i fondeve të BE-së është i lidhur ngushtë me përshtatjen e kuadrit ligjor nacional të Republikës së Maqedonisë me legjisllacionin e BE-së që ishte një nga qëllimet kryesore të MSA-së. Nga kjo del se dinamika e harmonizimit të kuadrit ligjor ka ndikuar në rritjen e kapacitetit absorbues të vendit për të përdorur fondet e BE-së.

RM duke u udhëhequr pjesërisht nga korniza kontraktuese e MSA-së ka ndërtuar strukturë institucionale që lejon përdorimin efikas të fondeve të BE-së. Si vend kandidat për anëtarësim që nga viti 2005, Republika e Maqedonisë ka qasje në të gjitha pesë komponentët e IPA që nga viti 2007 dhe e ka decentralizuar menaxhimin e IPA fondeve të të gjitha komponentët, përveç komponentit II. Për të përmbushur kushtet për delegimin e kompetencave menaxhere nga ana e Komisionit Evropian, Republikës së Maqedonisë, formoi një sistem kompleks, por njëkohësisht funksional të organeve dhe të menaxherëve.

Përmirësimi i mëtejshëm i aftësive për të përgatitur plane dhe programe gjithëpërfshirëse dhe të detajuara të mesme dhe afatgjate (d.m.th. programim ekonomik) do të jetë një kusht kritike për përdorimin e suksesshëm të fondeve ekzistuese në dispozicion si dhe të fondeve të kohezionit dhe atyre strukturore të BE-së pas anëtarësimit.

Cilat janë përshtypjet e përgjithshme të zbatimit të MSA-së, e cila është nënshkruar mes BE-së dhe Republikës së Maqedonisë?

Më 1 prill 2014 u shënuan dhjetë vjet nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit mes Republikës së Maqedonisë dhe Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre Anëtare (MSA). Zbatimi i MSA-së në dhjetë vitet e fundit i mundësoi Republikës së Maqedonisë të arrijë një nivel të kënaqshëm të harmonizimit me legjislacionin e BE-së (acquis communautaire) dhe të zbatojë standardet evropiane në fushat e parapara nga MSA, e cila është vendimtare në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian.

Edhe pse perspektiva e anëtarësimit mungon si një qëllim i drejtpërdrejtë në dokument, MSA paraqet një udhëzues për të arritjen e qëllimit strategjik - anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Rëndësia politike e marrëveshjes pasqyrohet në faktin se zbatimi i dispozitave të saj është një element i rëndësishëm në vlerësimin e Komisionit Evropian për përparimin e Republikës së Maqedonisë.

Dr. Andrej Lepavcov,
Ambasador i Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian



Përshkruani se si MSA ka mbështetur përpjekjet e Republikës së Maqedonisë për të përmbushur kriteret politike për anëtarësim në BE.

Nuk ka dyshim se Marrëveshja për SA mund të shihet nga një kënd politik dhe historik si pikëtakimi në rrugën për përafrimin e vendit ndaj arritjes së qëllimit strategjik të anëtarësimit në BE. Dhjetë vitet e para (1991-2000) të pavarësisë sonë kaluan në përpjekje për njohjen e shtetit, e përcjellur me pengesa dhe bllokada, konsolidimin e sistemit të brendshëm politik dhe përpjekjeve për ngritjen e institucioneve funksionale dhe krijimin dhe ndërtimin e ekonomisë së tregut. Dhjetë vitet tjera që pasuan (2001-2010) pas nënshkrimit të MSA-së, kaluan në përpjekje për të harmonizuar marrëdhëniet ndëretnike dhe ndërtimin e një shoqërie funksionale, shumetnike dhe shumë fetare me respekt të plotë dhe përmbushje të kriterëve politike të Kopenhagës për anëtarësimin në BE. Kushtetuta jonë ishte baza me një orientim të qartë politik, ndërsa Marrëveshja e SA është gjenerator dhe kahësues i reformave të nevojshme në të gjitha fushat, të financuara nga fondet e BE-së që ishin në dispozicion për ne. Është dëshmuar se reformat kryhen më lehtë në kushte kur ka një objektiv të qartë, kornizë produktive dhe mbështetje financiare për shpenzimet e rritura (çdo reformë kushton para).

Përshkruani se si MSA ka përkrahur harmonizimin e legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian, duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve administrative për të zbatuar ligjet e reja.

Baza ligjore për harmonizimin e legjislacionit tonë me BE-në i cili është përcaktuar me Marrëveshjen për SA, me ratifikimin e saj në Kuvendin tonë është bërë një pjesë integrale e sistemit tonë juridik në vend. Procesi ishte tërësisht i pranuar dhe i respektuar në vazhdimësi edhe nga Qeveria e RM edhe nga Kuvendi i RM. Qeveria përgatiti një plan të detajuar për harmonizimin e legjislacionit, ndërsa pika e harmonizimit të legjislacionit dhe përmbushjes së kriterëve për anëtarësim në BE janë bërë një pjesë integrale e çdo seance të Qeverisë. Në këtë mënyrë u zhvillua edhe një mekanizëm efektiv për monitorim përmes së cilës përcillej çdo akt dhe pajtueshmëria e tij me legjislacionin e BE-së. Qindra rregullativa kanë kaluar dhe ende rregullisht kalojnë nëpër këtë filtër dhe mijëra akteve ligjore të BE-së janë bartur me sukses në sistemin tonë ligjor vendor. Në mënyrë të pashmangshme procesi është përcjellur me strategji të duhur dhe plane për reformimin e administratës publike, në mënyrë që të ndërtohen kapacitetet institucionale për zbatimin e përpiktë dhe korrekt të rregullave të reja.

Përshkruani se si MSA ka promovuar marrëdhëniet ekonomike të harmonizuara dhe gradualisht ka zhvilluar një zone për tregti të lirë mes BE-së dhe Republikës së Maqedonisë.

Dialogu i thellë dhe i sistematizuar politik, brenda kuadrit të Marrëveshjes për SA, u pasua paralelisht me dialogun e

pasuruar ekonomik. Në të gjitha mbledhjet e Këshillit për SA, Komitetit për SA dhe veçanërisht të nën komitetit për Çështje Ekonomike dhe Financiare, vërehen tema ekonomike që prekin drejtpërdrejt mënyrën dhe dinamikën e harmonizimit të politikave kombëtare ekonomike me politikat ekonomike të BE-së. Me këtë merren në konsideratë ndryshimet e përditshme që ndodhin në BE, nën ndikimin e krizës financiare dhe nevojës për të konsoliduar ekonominë e BE-së, si dhe për të përmirësuar aftësinë e tyre konkurruese në skenën botërore. Marrëdhëniet tregtare përsëri u zhvilluan brenda kuadrit të rënë dakord me MSA dhe të Marrëveshjes së përkohshme, të cilat gjatë një periudhe prej 10, respektivisht 14 viteve, rezultuan në një zonë të tregtisë plotësisht të liberalizuar mes BE-së dhe Maqedonisë. Këmbimi tregtar është rritur dukshëm disa herë gjatë kësaj periudhe, por tani ne duhet të punojmë në përmirësimin e strukturës së këtij këmbimi tregtar.

Përshkruani se si përmes MSA-së është arritur bashkëpunimi rajonal në fushat të cilat janë të përfshira me Marrëveshjen.

Nëse fillimi i 90-ve u shënua nga luftërat në rajonin tonë, fundi i nëntëdhjetave me përpjekje më të mëdha të komunitetit ndërkombëtar dhe BE-së për të vendosur themelet e bashkëpunimit rajonal, fillimi i shekullit të ri dhe nisja e marrëveshjeve për stabilizim-asociim, ishin një shenjë për masa konkrete me qëllim konkret dhe mjete konkrete të mbështetjes nga BE. Ajo që para MSA-së llogaritej të jetë vështirë për tu realizuar, pas nënshkrimit të MSA-së nga pothuajse të gjitha vendet e rajonit është bërë një realitet. Perspektiva evropiane e ofruar nga MSA-ja, jo vetëm me kusht të bashkëpunimit të hapur rajonal e që është një nga shtyllat e ndërtaura në MSA, është shtytësi për rikrijimin e marrëdhënieve të ndërprera mes vendeve të rajonit dhe për ndërtimin e marrëdhënieve të reja. Sot ne jemi dëshmitarë të shumë iniciativave rajonale, mekanizmave dhe projekteve të suksesshme. Duhet theksuar se Maqedonia është ndoshta vendi i vetëm në rajon, i cili gjatë gjithë kësaj periudhe të pavarësisë deri më sot, pavarësisht nga pengesat e rastit, mbetën më të qëndrueshëm dhe të përkushtuar në politikën e bashkëpunimit rajonal.

Përshkruani se si MSA ka përgatitur Republikën e Maqedonisë për përdorimin efikas të fondeve aktuale nga BE-ja si dhe fondet kohezive dhe strukturore në të ardhmen.

Çdo vend i cili aspiron të bëhet anëtar i BE-së, veçanërisht vendet e vogla dhe relativisht të dobëta ekonomike, grup i cili e përfshinë edhe Maqedoninë, shpresojnë në qasje sa më të shpejtë në fondet e kohezionit dhe ato strukturore të BE-së. Qasja në këto fonde të mëdha do të thotë përshpejtim i zhvillimit dhe zvogëlim të pabarazive ekonomike, brenda në nivel kombëtar, në rajon dhe më gjerë në BE. Gjatë gjithë këtyre viteve të kaluara, Marrëveshja për SA, ofron hapësirë dhe mundësi për zhvillimin e kapaciteteve tona kombëtare për qasje dhe përdorim të fondeve të BE-së, në radhë të parë fondet si PHARE, CARDS, IPA dhe më pas fondet strukturore dhe ato të kohezionit. Kryesore është që të zhvillojë kapacitetet për planifikimin dhe drejtimin e fondeve, dhe mandej edhe absorbimin e tyre të plotë në drejtim të reformimit të sistemit politik dhe ekonomik, duke krijuar vende të reja pune dhe përmirësimin e standardit të jetesës të popullsisë. Në periudhën e kaluar Maqedonia me sukses po ndërton sistemin e vet nacional për koordinimin, drejtimin, menaxhimin dhe zbatimin e decentralizuar të fondeve të BE-së, që kanë për qëllim marrjen e pronësisë dhe përgjegjësinë e plotë për përdorimin e tyre.

Cilat janë përshtypjet e përgjithshme të zbatimit të MSA-së, e cila është nënshkruar mes BE-së dhe Republikës së Maqedonisë?

Në 10, respektivisht 14 vitet e fundit të zbatimit të Marrëveshjes për SA, duke përfshirë edhe marrëveshjen e përkohshme të tregtisë, padyshim kanë një rëndësi të madhe për zbatimin e reformave që Maqedonia i ka kaluar dhe është duke i kaluar. MSA ka përmbyshur qëllimin dhe objektivat e saja, e ka dhënë drejtimin, ka caktuar dinamikën, ka krijuar mekanizma për dialog ekonomik dhe politik por edhe harmonizimin e legjislacionit kombëtar me atë të BE-së, ka filluar me ndërtimin e kapaciteteve institucionale për zbatimin e legjislacionit dhe për absorbimin e fondeve evropiane.

Atë që MSA me sukses e paraqiti si fundament tani ka për të shërbyer, nëpërmjet procesit të negociatave për anëtarësim, për të ndërtuar një vend i cili është politikisht dhe në aspektin e sigurisë stabil si dhe ekonomikisht i begatshëm, i cili do të jetë pjesë integrale e BE-së dhe politikave të saja globale. Është koha e fundit, që BE të sjellë vendimin e kyç dhe të vetëm të drejtë, për të filluar negociatat e anëtarësimit të Maqedonisë, duke ju bërë të mundur qytetarëve të Maqedonisë trajtim të barabartë dhe të drejtë me të gjithë qytetarët e tjerë të rajonit tonë.

Dr. Teuta Arifi,
Ish Zëvendës Kryeministre e Republikës së Maqedonisë
për Çështje Evropiane



Përshkruani se si MSA ka mbështetur përpjekjet e Republikës së Maqedonisë për të përmbushur kriteret politike për anëtarësim në BE.

Me nënshkrimin e MSA-së Republika e Maqedonisë kaloi në kategorinë e shteteve që kanë hedhur hapin e parë formal drejt perspektivës për anëtarësimin e plotë në BE. Kjo marrëveshje ka ofruar mundësinë, së pari, për një punë shumë më të qëndrueshme, të përbashkët, bilaterale, midis Bashkimit Evropian dhe shteteve anëtare nga njëra anë dhe Republikës së Maqedonisë ku masat më të mëdha janë marrë në qeverisjen e vendit, janë diskutuar, negociuar dhe vendosur bashkë me strukturat e BE-së edhe me vendet anëtare. Me nënshkrimin e MSA-së ne në fakt kemi filluar të punojmë dhe të mësojmë me ritmin edhe me logjikën e Bashkimit Evropian. Dhe në qoftë se deri në kohën para nënshkrimit të MSA-së marrëdhëniet jonë me BE-në ka qenë rekomandim për ligje, me nënshkrimin e saj kemi hyrë në nivelin e punës të përbashkët të bazuar në marrëdhënie me karakter juridik dhe obligues për tu respektuar.

Përshkruani se si MSA ka përkrahur harmonizimin e legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian, duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve administrative për të zbatuar ligjet e reja.

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ka hedhur bazat e një marrëdhëniejeje të ngritur në një shkallë më të lartë, tashmë të konceptuar si partneritet, kontratë, bashkëpunim gjithëpërfshirës, midis vendit tonë dhe BE-së. Me vetë faktin që nga nënshkrimi i MSA-së si kontratë juridike buron obligimi i Republikës së Maqedonisë për të harmonizuar legjislacionin vendor me atë të BE-së ndërsa ndihma e ofruar teknike dhe monitorimi i zbatimit të dispozitave ka ndikuar pozitivisht në ngritjen e kapaciteteve administrative për zbatimin praktik të legjislacionit vendor të harmonizuar me kërkesat e BE-së.

Përshkruani se si MSA ka promovuar marrëdhëniet ekonomike të harmonizuara dhe gradualisht ka zhvilluar një zone për tregti të lirë mes BE-së dhe Republikës së Maqedonisë.

Procesi i stabilizim -asociimit ka ndikuar në përshtetimin e tranzicionit në ekonominë e tregut, promovimin i bashkëpunimit rajonal dhe perspektivës së anëtarësimin të BE-së si dhe aftësinë e vendit tonë për të ndërtuar kapacitete për përshtatjen dhe implementimin e standardeve evropiane, për të thelluar bashkëpunimin me vendet e rajonit dhe për ta ngritur aftësinë e vendit për të qenë konkurente në tregun evropian. MSA ka ndihmuar Maqedoninë në përpjekjen e saj për të krijuar një ekonomi funksionale të tregut dhe për të zhvilluar gradualisht një zonë të tregëtisë së lirë ndërmjet Komunitetit dhe Maqedonisë.

Përshkruani se si përmes MSA-së është arritur bashkëpunimi rajonal në fushat të cilat janë të përfshira me Marrëveshjen.

MSA ka nxitur bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë mes vendeve të rajonit në kuptim të lëvizjes së lirë të personave, mallrave, kapitalit dhe shërbimeve si dhe zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët, veçanërisht

të atyre që lidhen me luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parave, emigrimit të paligjshëm dhe trafikimit.

Përshkruani se si MSA ka përgatitur Republikën e Maqedonisë për përdorimin efikas të fondeve aktuale nga BE-ja si dhe fondet kohezive dhe strukturore në të ardhmen.

Procesi i Stabilizim-Asociimit është i bazuar në partneritetet progresiv, ku BE ofron lloje të ndryshme të koncesioneve tregtare, ndihma ekonomike e financiare (Instrument për Asistencën e Para-Anëtarësimit) dhe marrëdhënie kontraktuale (Marrëveshjeve për Stabilizim-Asociim). Kjo metodë e KE-së ndihmon vendet e Ballkanit Perëndimor për të pasur garë pozitive mes tyre në plotësimin e kushteve për anëtarësim dhe paralelisht me procesin e reformave administrative zhvillon kapacitetet vendore për të përdorur në mënyrë efikase fondet e BE.

Cilat janë përshtypjet e përgjithshme të zbatimit të MSA-së, e cila është nënshkruar mes BE-së dhe Republikës së Maqedonisë?

Implementimi i MSA –së dhe agjenda evropiane në përgjithësi ka ndikuar pozitivisht në procesin e tranzicionit post komunist dhe modernizimit social, politik dhe ekonomik dhe ndërtimit të institucioneve demokratike në Maqedoni. Dinamika e zbatimit të mëtutjeshëm të kornizës kontraktuale mes BE-së dhe Maqedonisë e dikton edhe afatin kohor brenda të cilit Republika e Maqedonisë do të bëhet anëtare e plotë e BE-së megjithatë përveç vazhdimit të procesit reformues marrëdhëniet e mira me fqinjët dhe veçanërisht zgjidhja e kontesteve bilaterale duhet të jenë në fokus të veprimit politik për të shty para procesin e plotësimit të agjendës evropiane të vendit.

Dr. Zlatka Popovska,

Ish Zëvendës Kryeministre për Çështje Evropiane në
Qeverinë e Republikës së Maqedonisë



Përshkruani se si MSA ka mbështetur përpjekjet e Republikës së Maqedonisë për të përmbushur kriteret politike për anëtarësim në BE.

Që në fillim të pavarësisë, Republika e Maqedonisë u përcaktua për një shoqëri demokratike dhe ekonominë e tregut. U përcaktua edhe për qëllimin, integrimin në BE. Në rrugën drejt integrimit të plotë, MSA-ja u pranua si një “urë” e cila çon drejt qëllimit. Kriteret politike realizoheshin përmes qëndrimit aktivistit ndaj ndryshimeve që do të thotë zhvillimin e demokracisë, sundimin e së drejtës, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve. Themeli i këtij qëndrimi aktivist është mbështetja e gjerë qytetare dhe entuziazmi për anëtarësim në BE, që ishin forca motivuese për të kapërcyer edhe sprova të mëdha. Por sot, mos kapërcimi i “urës”, për shkak të mungesës së përgjigjes për të hyrë në fazën e dytë të zbatimit të MSA-së, nuk mund e të mos e godas këtë forcë motivuese, e as për të kufizuar qëndrimin aktivist të mirëmbajtur një gjatë kohë. Është e domosdoshme të praktikohen forma efikase të dialogut politik.

Përshkruani se si MSA ka përkrahur harmonizimin e legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian, duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve administrative për të zbatuar ligjet e reja.

Harmonizimi i legjislacionit vendas me legjislacionin e BE-së nuk paraqet vetëm nivelin e aftësisë për të përgatitur dhe miratuar ligje, por edhe aftësinë për të zbatuar dhe për të monitoruar ato deri në shndërrimin e tyre në një sistem efikas rregullator. Prandaj, është një kontribut veçanërisht i rëndësishëm i MSA-së në avancimin e modaliteteve për të monitoruar procesin e zbatimit. Ndarja e qartë e kohës për ndryshime, respektivisht realizimin e detyrimeve që rrjedhin nga MSA brenda afateve të parapara, është një parakusht për një qasje të integruar ndaj ndërtimit të kapaciteteve për harmonizuar legjislacionin kombëtar.

Kapaciteti administrativ është gjithsesi shumë i rëndësishëm, por megjithatë, kjo është vetëm një pjesë e kapacitetit të përgjithshëm. Mbështetja nga MSA-ja është e dobishme, por rreziku i “lodhjes” së administratës për shkak të “ngadalësimit” ose “pritjes” së një fazë të re të ndryshimeve, mund të zhvlerësojnë përpjekjet e bëra dhe të thellohet hendekun midis rezultateve të realizuara dhe ato të dëshiruara.

Përshkruani se si MSA ka promovuar marrëdhëniet ekonomike të harmonizuara dhe gradualisht ka zhvilluar një zone për tregti të lirë mes BE-së dhe Republikës së Maqedonisë.

Republika e Maqedonisë në periudhën e tranzicionit ka pasur reforma të thella në fushën e liberalizimit dhe de rregullimit. Këto procese ndër-varura morën një vrull të posaçëm me veprimin e MSA-së në funksion të zhvillimit të një klime të re për bashkëpunim ekonomik nga e cila pritëshin efekte për rritjen e tregtisë dhe investimeve. Tregu shtetëror u zgjerua në mënyre drastike përmes qasjes në tregun e BE-së, si dhe përmes qasjeve në tregjet e vendeve të tjera

(marrëveshje rajonale dhe dypalëshe). Sipas MSA-së, është kryer liberalizimi i plotë i importit të prodhimeve industriale dhe janë ndërmarrë aktivitetet e shumta në fushën e importit dhe eksportit të mallrave dhe shërbimeve, si dhe në fusha të tjera të rëndësishme për promovimin e marrëdhënieve ekonomike. Qëllimi kryesor i këtyre aktivitetet janë ndryshime që donë të thonë intensifikimin e ristrukturimit dhe rritjen e aftësisë konkurruese të prodhimeve të Maqedonisë në bazë të kriterëve të tregut evropian. Me fjalë të tjera, liberalizimi, tregtia e lirë, janë vetëm fillimi i aftësimin ekonomik që të zhvillohet si një ekonomi konkurruese. Është e domosdoshme mbështetja për forcimin e proceseve integrative në fushat e tregut të kapitalit dhe tregun e punës.

Përshkruani se si përmes MSA-së është arritur bashkëpunimi rajonal në fushat të cilat janë të përfshira me Marrëveshjen.

Bashkëpunimi është duke u bërë një nga faktorët “e pamatshëm” të rritjes që nga fillimi i shekullit të 21të. Proceset e rrjetëzimit (prodhimi, financat, tregtia, teknologjitë, etj...) në mes të ekonomive në nivel global, e bëjë absurde çdo qëndrim i cili e pengon ndërlidhjen dhe intensifikimin e bashkëpunimit me fqinjët. Republika e Maqedonisë kërkon në radhë të parë për të pasuruar format e bashkëpunimit në nivel rajonal dhe t’i shtrijë në mjedis më të gjerë. MSA dha një shtytje të fortë në këtë plan. Me zgjerimin e kuadrit kontraktues u pasuruan edhe domenet edhe format e bashkëpunimit rajonal. Lëvizja e lirë e kapitalit, forcës punuese, mallrave dhe shërbimeve në të njëjtën kohë do të thotë zgjerimin e kanaleve për transferimin e njohurive dhe përvojës midis vendeve të rajonit. Në të njëjtën kohë, me disa prej tyre shkëmbehen njohuritë për proceset integruese në BE, gjë që e forcon dialogun politik dhe gatishmërinë për zgjidhje të përbashkët të sfidave të reja. Rritja dhe forcimi i projekteve në fushën e bashkëpunimit rajonal mund të ketë rol plotësues dhe stimulues për lidhjen e vendeve në fushën e integritimit evropian.

Përshkruani se si MSA ka përgatitur Republikën e Maqedonisë për përdorimin efikas të fondeve aktuale nga BE-ja si dhe fondet kohezive dhe strukturore në të ardhmen.

Është i rëndësishëm niveli i shfrytëzimit efikas i fondeve aktuale përmes implementimit të projekteve të rena dakord. Lartësia e këtij niveli varet nga kapaciteti i integritimit të resurseve vendore në kryerjen e detyrës, por edhe nga dinamika e transferimit të njohurive dhe përvojës në zbatimin e programuar të MSA-së në këtë fushë. Rëndësia e fondeve nuk është vetëm e rëndësishme në aspektin e madhësisë së mjeteve financiare, por edhe në drejtim të asaj se për çfarë transferimi të njohurive dhe përvojës është duke u kryer dhe cilat kanale përdoren për përhapjen e tyre më të gjerë. Tejkalmi i dobësive ekzistuese është për të lehtësuar qasjen ndaj fondeve kohezive dhe strukturore që mund të japin një shtytje të fortë për përshpejtimin e ristrukturimit të ekonomisë maqedonase dhe përshtatjen e tij të përshpejtuar, sipas kriterëve të tregut evropian.

Cilat janë përshtypjet e përgjithshme të zbatimit të MSA-së, e cila është nënshkruar mes BE-së dhe Republikës së Maqedonisë?

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat në të cilat Republika e Maqedonisë është duke e kaluar rrugën e saj të tranzicionit, është e pashmangshme e vërteta se ajo është një vend që ka paguar çmimin më të lartë në ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe një ekonomie efikase të tregut, në krahasim me vendet e tjera në tranzicion. Pavarësisht nga realizimi i të gjitha detyrimeve sipas fazës së parë të zbatimit të MSA-së deri në 2009, Republika e Maqedonisë si dhe në vitin 2014 akoma është në pritje të një përgjigjeje nga Këshilli i BE-së për të filluar fazën e dytë të asociimit. Vonesa “vetëm e rritë dhe ashtu koston e lartë shoqërore të ndryshimeve në tranzicion. MSA nuk është program jashtëkohor, kontratat nuk mund të ndryshojë kushtet fillestare të mjedisit të tyre të zbatimit, e as që mund të shprehet integritimi në BE e as mund të jetë një vizion pa rezultat. “Pritja” shkakton “lodhje” por edhe ndjenja te populli që BE-ja nuk është duke përdorur të gjitha mekanizmat e saja për të zhblllokuar dhe për të shpejtuar procesin. Republika e Maqedonisë ende duke qëndruar në rrugën e integritimit të plotë vazhdon me ndryshimet të cilat duan të thonë pushtim i vlerave dhe standardeve evropiane në shumë domene të organizimit shoqëror.

Dr. Srxhan Kerim,

Ish Ministër i Punëve të Jashtme i Republikës së Maqedonisë



Përshkruani se si MSA ka mbështetur përpjekjet e Republikës së Maqedonisë për të përmbushur kriteret politike për anëtarësim në BE.

Republika e Maqedonisë dhe Bashkimi Evropian në vitin 2001 bënë një sintezë të përvojës së tyre në bashkëpunim dhe partneritet me anë të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, i cili hap perspektiva të mëdha për anëtarësimin e Maqedonisë në BE. Vendi ynë ishte i pari ndër republikat ish-jugosllave, me përjashtim të Sllovenisë, me të cilën BE-ja nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit në vitin 2001. Kjo nuk është aksidentale, por është për shkak të faktit se Maqedonia ishte e vetmja nga ish republikat jugosllave e cila gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë u bë e pavarur në mënyrë paqësore dhe pa veprime ushtarake. Për më tepër, modeli ndër-etnik i bashkëjetesës dhe zhvillimit demokratik të vendit e përballoi sprovën e kohës duke përfshirë këtu edhe konfliktet dhe tensionet në gjysmën e parë të vitit 2001 të cilat rezultuan në miratimin e Marrëveshjes Kornizë. Anëtarësimi i asociuar është hapi i fundit dhe vendimtar përpara anëtarësimin të plotë në BE, dhe fakti që kjo marrëveshje ka marrë përkufizimin ku stabilizimi është vendosur në plan të parë nënkupton forcimin e këtij procesi, duke qenë se ky dimension në Europën Juglindore duhet të jetë më i pranishëm.

Përshkruani se si MSA ka përkrahur harmonizimin e legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian, duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve administrative për të zbatuar ligjet e reja.

Në Maqedoni, tani më 20 vjet ekziston konsensus mes aktorëve politikë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. Nënshkrimi i MSA-së midis BE-së dhe Maqedonisë synonte nga njëra anë për të vlerësuar arritjet e Maqedonisë në ndërtimin e modelit demokratik të zhvillimit, dhe nga ana tjetër inkurajim nga ana e BE-së për zhvillimin e institucioneve demokratike dhe reforma të përgjithshme të shtetit dhe të shoqërisë, në mënyrë që Maqedonia të jenë plotësisht e përgatitur për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Një nga përcaktuesit më të rëndësishëm është procesi i harmonizimit të legjislacionit vendor me të drejtën e BE-së nëpërmjet zbatimit të Programit nacional për miratimin e Acquis së BE-së. Duke pasur parasysh se BE-ja në këto pesë dekada evoluon për të shkuar përpara, ne gjithashtu u obliguam për të arritur këto standarde më të larta të cilat BE-ja vet i vendosë. Qeveria dhe Parlamenti nëpërmjet sferës legjislative të përshtatjes së ligjeve dhe rregullave tona punojnë për të nxitur ekonominë, administratën dhe qytetarët në përgjithësi të jetë gati për procesin e integritimit evropian dhe të bëhen pjesë përbërëse e saj.

Përshkruani se si MSA ka promovuar marrëdhëniet ekonomike të harmonizuara dhe gradualisht ka zhvilluar një zone për tregti të lirë mes BE-së dhe Republikës së Maqedonisë.

Njerëzit nga Maqedonia duhet të dinë se kanë një të ardhme të afërt në Evropë dhe se e ardhmja e meriton për të luftuar për të, të bëjë çdo përpjekje për të qenë pjesë e familjes evropiane. Këto fjalë e zotit Javier Solana janë folur me rastin e nënshkrimit të MSA-së, por nuk e kanë humbur rëndësinë. Duhet të jemi të vetëdijshëm se ndonjëherë gabimisht imponohen teza për debat se atë që e bëjmë duhet ta bëjmë për shkak të BE-së. Nuk është e vërtetë - reformat na nevojiten neve dhe ne i bëjmë që të kemi kushte të favorshme për të tërhequr kapitalin e huaj. Prandaj, theks i veçantë u vu në nënshkrimin e Marrëveshjes së përkohshme për tregti dhe çështje të tregtisë midis Republikës së Maqedonisë dhe BE-së, përmes së cilës praktikisht vendi e hapi tregun e saj me Bashkimin Europian dhe fitoi mundësinë për të tregtuar në kushte të favorshme me BE-në.

Përshkruani se si përmes MSA-së është arritur bashkëpunimi rajonal në fushat të cilat janë të përfshira me Marrëveshjen.

Një nga qëllimet e MSA-së është që të kultivojë bashkëpunimin rajonal në të gjitha fushat e mbuluara nga marrëveshja. Jo rastësisht përmes tekstit të Marrëveshjes theksohet se paqja dhe stabiliteti ndërkombëtar dhe rajonal, si dhe zhvillimi i marrëdhënieve të mira fqinjësore janë thelbësore për Procesin e Stabilizim-Asociimit. Respektivisht, si një faktor kyç në mes të Maqedonisë dhe BE-së vendoset detyrimi që Republika e Maqedonisë të krijojë bashkëpunim dhe marrëdhënie të mira fqinjësore. Bashkëpunimi rajonal në dimensionin e saj institucional duhet të ndjekë modelin skandinav të Këshillit Nordik. Kjo qasje është nisur gjatë Samitit të Procesit të Bashkëpunimit të ShEE në Shkup në vitin 2001, ndërsa në maj 2013 në Ohër PBShEE vendosi të krijojë Asambleenë Parlamentare, i cili është një hap i rëndësishëm në institucionalizimin e bashkëpunimit rajonal.

Përshkruani se si MSA ka përgatitur Republikën e Maqedonisë për përdorimin efikas të fondeve aktuale nga BE-ja si dhe fondet kohezive dhe strukturore në të ardhmen.

Nënshkrimin e MSA-së e konsideroj si një nga momentet më të lumtura dhe më të rëndësishme në karrierën time diplomatike prej tre dekadave.

Edhe atëherë, menjëherë pas nënshkrimit të MSA-së, por edhe sot, jam i bindur në një deklaratë të cilën e dëgjova si shefi i diplomacisë maqedonase, që është se Republika e Maqedonisë është e trajtuar nga BE-ja si një mik dhe partner. Ajo duhet të jetë vazhdimisht në mendimet tona, kur mendojmë për atë çka na pret në të ardhmen. A ka ndonjë dëshmi më të mirë që BE dëshiron t'i mbështesë reformat në Maqedoni, të na ndihmojë ta përsosim sistemin politik, të forcojmë demokracinë dhe funksionalitetin e institucioneve, përveç fondeve evropiane të cilat i kemi në dispozicion?

Cilat janë përshtypjet e përgjithshme të zbatimit të MSA-së, e cila është nënshkruar mes BE-së dhe Republikës së Maqedonisë?

Edhe pse Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit është menduar dhe konceptuar në një mënyrë që do të mundësojë Republikën e Maqedoninë për anëtarësim në BE. Zbatimi i saj ishte për fat të keq nuk ishte e mjaftueshme për të siguruar status të kandidatit duke përfshirë këtu edhe negociatat për anëtarësim. Një problem politik i paparë në marrëdhëniet ndërkombëtare bashkëkohore u paraqit para nesh. Bëhet fjalë për mosmarrëveshjen lidhur me emrin kushtetues të Republikës së Maqedonisë me Greqinë fqinje. Edhe pse kjo mosmarrëveshje është subjekt i zgjidhjes në OKB dhe me ndërmjetësimin e tyre, si rezultat i presionit të Greqisë në BE e shndërroi atë në një kusht të domosdoshëm pa të cilin nuk është e mundur marrja e statusit të kandidatit dhe hapjes së negociatave me BE-në. Kjo sjellje e Greqisë tingëllon edhe si paradoks, pasi që ishte pikërisht ajo në mesin e atyre vendeve anëtare të BE-së e cila dha kontribut të rëndësishëm në nënshkrimin e MSA-së me Republikën e Maqedonisë në vitin 2001. Fakti që Komisioni Evropian rregullisht del me rekomandime për hapjen e negociatave për anëtarësimin e RM-së në BE tregon se pothuajse të gjitha elementet e MSA-së

janë realizuar dhe flasin në favor të pjekurisë, respektivisht gatishmërisë së Republikës së Maqedonisë për të negociuar anëtarësimin në Union. Për këtë shkak do të ishte e leverdishme që shtetet anëtare të Bashkimit Evropian të kërkojnë nga Republika e Greqisë të solidarizohen me të mundësojnë që në këtë mënyrë të hapin rrugën e anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë në BE. Duke përcjellë logjikën e sjelljes së anëtareve të BE-së ndaj kandidatëve potencial për anëtarësim pikërisht Greqia duhet të jetë port i hyrjes së RM-së siç ishte Finlanda për Estoninë, respektivisht Sllovenia për Kroacinë.

Sasho Stefkov,

Ish Ambasador i Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian



Përshkruani se si MSA ka mbështetur përpjekjet e Republikës së Maqedonisë për të përmbushur kriteret politike për anëtarësim në BE.

Përmbushja e kriterëve politike të Kopenhagës është një detyrim i interesit më të lartë për Maqedoninë, siç përcaktohet në Deklaratën e Kuvendit, i cili hap rrugën për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe përcakton standardet shoqërore të familjes evropiane të cilës i takon. Nuk ka asnjë dyshim që Republika e Maqedonisë në periudhën e kaluar ka bërë përpjekje të mëdha në bashkëpunimin dhe mbështetjen e BE-së dhe vullnetin e shprehur në mënyrë të qartë për përmbushjen e detyrimeve politike të ngarkuara me nënshkrimin e MSA-së duke arritur rezultate të padyshimta të cilat u njohën edhe nga Komisioni Evropian dhe Parlamenti Evropian.

Por, me këtë rast imponohet nevoja për të përmendur faktin se pas 10 viteve zbatimi të Marrëveshjes, Maqedonia, për shkak të bllokadave në Këshillin, nuk kaloi në fazën e dytë të parashikuar dhe nuk u mundësua fillimi i negociatave për anëtarësim në BE.

Përshkruani se si MSA ka promovuar marrëdhëniet ekonomike të harmonizuara dhe gradualisht ka zhvilluar një zone për tregti të lirë mes BE-së dhe Republikës së Maqedonisë.

Përfitimi pozitiv i Marrëveshjes është sigurisht avancimi i marrëdhënieve ekonomike. Ilustrim i mjaftueshëm është vëllimi i tregtisë gjatë nënshkrimit të Marrëveshjes edhe dhjetë vite pas kësaj. Pavarësisht dallimeve të mëdha në vëllimin dhe kapacitetin e operatorëve ekonomik të palëve të huaja nënshkruese, si dhe fakti që pranimi i anëtarëve të rinj solli ndryshime të mëdha në marrëdhëniet ekonomike të Maqedonisë me ta, mund të përfundojë se u arrit dispozita nga neni 15 për përcaktimin e zonës së tregtisë së lirë. Përballja me partnerë shumë më konkurrues u lehtësua me heqjen e njëanshme të tarifave doganore mbi mallrat e Maqedonisë në BE dhe krijimit të një regjimi tranzicional prej dhjetë viteve për të reduktuar gradualisht tarifën për mallrat nga BE-ja në Maqedoni. Me këtë edhe operatorët ekonomik u liruan nga detyrimet tjera financiare që kishin të njëjtin efekt si tarifën doganore si dhe nga pagesat tjera administrative, me çka u arrit një harmonizim i konsiderueshëm i rregulloreve.

Përshkruani se si përmes MSA-së është arritur bashkëpunimi rajonal në fushat të cilat janë të përfshira me Marrëveshjen.

Nuk ka asnjë dyshim se marrëveshja i dha një shtyrje të fortë për themelimin e bashkëpunimit rajonal në shumë fusha. Por sigurisht se për shumë forma të bashkëpunimit rajonal, Maqedonia ishte dhe mbetet një iniciator, e cila mbetet të veprojë fuqishëm në promovimin e tij. Ajo ishte një pjesëmarrëse aktive në Paktin e Stabilitetit, mandej dha një kontribut

të rëndësishëm në krijimin e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, si dhe në zëvendësimin e shumë marrëveshjeve bilaterale tregtare me marrëveshjen rajonale CEFTA 2006. Është për të përmendur rezervën e shprehur nga disa shteteve anëtare, ndaj emrit kushtetues, e shprehur gjatë nënshkrimit të marrëveshjes, gjë që nuk ju pengon të respektojnë një kuadër tjetër të bashkëpunimit rajonal - Nismën e Evropës Qendrore.

Përshkruani se si MSA ka përgatitur Republikën e Maqedonisë për përdorimin efikas të fondeve aktuale nga BE-ja si dhe fondet kohezive dhe strukturore në të ardhmen.

Maqedonia nuk dallon shumë nga pozita fillestare e shteteve të reja anëtare të Unionit në drejtim të aftësisë për të përdorur në mënyrë efektive këto fonde, gjë që në përgjithësi ka qenë e ulët. Bashkimi Evropian ofroi një varg të gjerë të kurseve, duke filluar nga nevojat e ndërtimit të kapaciteteve administrative përmes TAIEX, e deri në formimin e strukturave të specializuara të organeve shtetërore. Gjithsesi do të ishte i dobishëm një sistem gjithëpërfshirës për njoftimin e tërë shoqërisë për vëllimin dhe strukturën e këtyre fondeve në një mënyrë të thjeshtë dhe të pranueshme të bazuara në shembullin e anëtarëve të reja të suksesshme të BE-së, e pastaj edhe mbështetje për përgatitjen e propozimeve dhe trajnim për procedurat për qasje në fonde.

Cilat janë përshtypjet e përgjithshme të zbatimit të MSA-së, e cila është nënshkruar mes BE-së dhe Republikës së Maqedonisë?

Zbatimi i marrëveshjes sigurisht duhet të ketë një qasje më të madhe nga qytetarët për çka do të ishte shumë e dobishme të gjinden metoda të përshtatshme për të informuar sistematikisht publikun për qëllimin e saj dhe rrjedhën e zbatimit të tij. Problemi më i madh që zakonisht paraqitet në media është se kjo çështje nuk konsiderohet si tërheqëse për publikun e gjerë dhe për këtë arsye ajo është pak prezente në përmbajtjet e publikuara. Me gjithë përpjekjet e bëra në këtë drejtim nga Qeveria - Sekretariati për Çështje Evropiane, Ministria e Punëve të Jashtme si dhe nga agjencitë dhe organizatat e tjera, prandaj mund të konsiderohet krijimi i një forumi të specializuar publik për përcjelljen e vazhdueshme të zbatimit të MSA-së.

Mr. Jovan Andonovski,

Bashkëkryesues i Komitetit për Stabilizim dhe Asociim dhe
Sekretar Shtetëror në Sekretariatit për Çështje Evropiane



Përshkruani se si MSA ka mbështetur përpjekjet e Republikës së Maqedonisë për të përmbushur kriteret politike për anëtarësim në BE.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit u hap e u ilustrua perspektiva e qartë e vendit në integrimin e plotë të familjes evropiane të kombeve. Fakti se Republika e Maqedonisë plotësisht dhe me përpjekje të madhe është e dedikuar drejt plotësimit të kriteriumeve politike të Kopenhagut e vërtetojnë edhe pesë rekomandimet e njëpasnjëshme të Komisionit Evropian për fillimin e negociatave të RM-së me BE-në e në të cilat konfirmohet se vendi në mënyrë të vazhdueshme arrin progress në të gjitha sferat prioritare.

Republika e Maqedonisë mban një dialog të rregullt politik me BE-në që kontribuon në përforcimin e besimit dhe bashkëpunimit e poashtu mes tjerash kontribuon në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian.

Me zbatimin e angazhuar të MSA-së, përmisimin e legjislacionit kombëtar, vendosjen e institucioneve funksionale e profesionale, ndërtimin e kapaciteteve administrative, reformën e administratës publike dhe gjyqësore, plotësisht jam i bindur se Republika e Maqedonisë është një shembull i shkëlqyer për zbatimin e dedikuar të reformave që i posedon vetë procesi i integritimit evropian.

Përshkruani se si MSA ka përkrahur harmonizimin e legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian, duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve administrative për të zbatuar ligjet e reja.

Harmonizimi i legjislacionit kombëtar me legjislacionin e Bashkimit Evropian nuk është aspak process i lehtë.

Republika e Maqedonisë menjëherë pas nënshkrimit të MSA-së, në mënyrë sistematike, përgjegjëse e të organizuar e filloi procesin e harmonizimit. Gjer më tani, mijëra rregullore të BE-së janë të zhvendosura – direktiva e vendime rregullore. Në këtë process të harmonizimit, paralalisht përkthehet legjislacioni i EU-së në gjuhën maqedonase.

Procesi i harmonizimit të legjislacionit është i koordinuar përmes Sekretariatit për Çështje Evropiane, i planifikuar nga Programi Kombëtar për Harmonizimin e Legjislacionit (PKHL) gjersa i vrojtuar përmes këshilleve punuese e komisioneve të Qeverisë e të Kuvendit, mes tjerash dhe përmes grupeve punuese në korniza të MSA-së.

Janë të sjellur një numër i madh ligjeve ndërsa në drejtim të zbatimit të tyre janë miratuar më shumë akte nënligjore. Në pajtueshmëri me vlerësimin e dhënë dhe në strategjinë e fundit të KE-së lidhur me zgjerimin dhe sfidat kyçe të vitit 2013-2014, vendi ka arritur një nivel të lartë të pajtueshmërisë me acquis në drejtim të procesit të integritimit.

Përshkruani se si MSA ka promovuar marrëdhëniet ekonomike të harmonizuara dhe gradualisht ka zhvilluar një zone për tregëti të lirë mes BE-së dhe Republikës së Maqedonisë.

Në korniza të Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim përmes Programit të Parapranimit Ekonomik në të cilën Republika e Maqedonisë e përgatitën veç më disa vite, u vëndua në shprehje dialog ekonomik për të udhëhequr politikat ekonomike të vendit.

Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, tregtia e jashtme u liberalizua plotësisht, gjithashtu kjo nënkuptoi edhe liberalizimin e regullativës për themelimin e ndërmarrjeve. Faza e dytë e zbatimit të MSA-së, nënkupton edhe liberalizim të një niveli më të lartë për themelimin e ndërmarrjeve nga individë të huaj si dhe liberalizim më madh në nivel të lartë të shërbimeve financiare.

Zbatimi i Marrëveshjes së Përkohshme (e cila u implementua edhe para ratifikimit të MSA-së nga të gjitha vendet anëtare të BE-së) dhe zbatimi i mëvonshëm i protokolleve me të cilat rregullohej tregtia reciproke me Bashkimin Evropian, kontribuan në avancimin dhe zhytjen e mëthellshme të rritjes së shkëmbimit tregtar në vendin tonë me Bashkimin. Zona e lirë ekonomike me BE-në është e themeluar më 1 janar 2011.

Përshkruani se si përmes MSA-së është arritur bashkëpunimi rajonal në fushat të cilat janë të përfshira me Marrëveshjen.

Në drejtim të bashkëpunimit rajonal (Akti III), Republika e Maqedonisë vazhdon me politikën e avancimit të marrëdhënieve bilaterale me vendet regjionale dhe në mënyrë aktive që pjesëmarrëse në iniciativat rajonale, duke përfshirë procesin për bashkëpunim në Evropën Juglindore, Këshillin për Bashkëpunim Rajonal, Marrëveshjen e Evropës Qendrore për Tregëti të Lirë, Nismën qendrore-evropiane, etj.

Republika e Maqedonisë plotësisht bashkëpunoi me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. U nënshkruajtën marrëveshje për bashkëpunim me Kroacinë, Serbinë, Shqipërinë dhe Malin e Zi, në pajtueshmëri me kushtet e përcaktuara në nenin 12 të MSA-së, e njëkohësisht me këta vende u konkluduan Marrëveshje për bashkëpunim në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Në suaza të bashkëpunimit ndërkufitar, Republika e Maqedonisë zbaton projekte të përbashkëta me Greqinë, Bullgarinë, Shqipërinë, gjersa para pak kohe u nënshkrua edhe marrëveshja e bashkëpunimit me Kosovën.

Në nenin 3 të Marrëveshjes është i dhënë konteksti politik i Marrëveshjes në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Verifikohet se nënshkrimi dhe zbatimi i Marrëveshjes është në korniza të qasjes rajonale në përputhje me përfundimet e Këshillit të BE-së që nga 29 prill i vitit 1997, në bazë të arritjeve individuale të çdo shteti që është i kyçur në qasjen regjionale. Këta konkluzione të Këshillit e shpallin parimin e kushtëzimit kundrejt shteteve të qasjes rajonale, ku parashihet progres i mëtejshëm varësisht nga plotësimi i kushteve. Qasja rajonale themeluar në vitin 1997 është zhvilluar më tej me anë të dokumenteve të konkluzioneve të Këshillit të Stabilizimit e Asociimit (Konkluzionet e Samitit Feiras 2000, Axhenda e Selanikut, Strategjia e Zgjerimit 2003), por gurrëthemeli mbetet politika e kushtëzimit shpallur në vitin 1997.

Bashkëpunimi rajonal është themeluar si një faktor kyç në zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet vendeve, duke marrë kështu përgjegjësinë edhe për koncesione reciproke me vendet rajeonale në aspektin e lëvizjes së individëve, mallrave, kapitalit dhe shërbimeve, si dhe zhvillimin e projekteve me interes të përgjithshëm.

Në pajtueshmëri me nenin 4, Republika e Maqedonisë detyrohet të krijojë bashkëpunim dhe marrëdhënie të mira ndërfqinjësore me vendet e tjera rajonale. Duke e pasur parasysh faktin se paqja, stabiliteti ndërkombëtar dhe zhvillimi i marrëdhënieve të mira ndërfqinjësore janë thelbësore për procesin e stabilizimit dhe asociimit si dhe për zhvillimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit me Bashkimin Evropian, Republika e Maqedonisë ka vendosur dhe në mënyrë të vazhdueshme mirëmban marrëdhënie të mira me vendet rajonale dhe fqinje me çka kontribuon në fushat që janë të mbuluara me MSA-në, gjersa janë të një interesi reciprok. Republika e Maqedonisë ka nënshkruar një numër të madh të marrëveshjeve bilaterale me vendet fqinje.

MSA-ja i dha shtytje të fuqishme dhe një dimenzion të ri në zhvillimin dhe zhytjen mbi bashkëpunimin rajonal. Në përputhje me dispozitat e nenit 12 të MSA-së, në 10 vitet e fundit u përhap korniza e marrëveshjes për bashkëpunim me çdo vend nga Procesi i Stabilizimit dhe Asociimit pas nënshkrimit të Marrëveshjeve për Stabilizim dhe Asociim me BE-në. Marrëveshjet i përfshinë elementet e dialogut politik, themelimin e zonës tregtare mes palëve, koncesione të ndërsjella lidhur me lëvizjen e punëtorëve, themelimin e shoqërive, dhënien e shërbimeve, pagesat aktuale dhe lëvizja e kapitalit, bashkëpunim në sfera të tjera, etj.

Me nënshkrimin e marrëveshjes për bashkëpunim në kuadër të anëtarësimit në BE me Kroacinë, Serbinë, Shqipërinë dhe Malin e Zi, u hap një fushë e gjerë për shkëmbim përvojash në procesin e eurointegrit. Me ta, dialogu politik dhe marrëdhëniet bilaterale të shteteve përfituan kualitet të ri. Marrëveshjet parashikojnë mekanizma institucional për zbatimin e tyre dhe pasqyrojnë një mjet të shkëlqyeshëm për zhytje më të thellë të bashkëpunimit me çështjet e BE-së dhe ballafaqimin me sfidat në procesin e pranimit në BE.

Përfundimi i këtij lloji të marrëveshjes pasqyron përmbushjen e parakushteve të nevojshme për zhvillim të mëtejshëm të marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe BE-së, që është parashikuar me nenin 12 të MSA-së.

Përshkruani se si MSA ka përgatitur Republikën e Maqedonisë për përdorimin efikas të fondeve aktuale nga BE-ja si dhe fondet kohezive dhe strukturore në të ardhmen.

Ndihma financiare nga Bashkësia në formën e granteve dhe kredive është e një rëndësie të madhe për Republikën e Maqedonisë për mbështetje të reformave që aktualisht zhvillohen. Format e shpërndarjes së ndihmës pavarësisht kontributit financiar mundësuan proces të të mësuarit përmes punës që siguron qëndrueshmërinë e efekteve të harmonizimit të ligjit të BE-së në suaza të legjislacionit kombëtar dhe institucione që e zbatojnë të njëjtën.

Me promovimin e instrumentit CARDS në vitin 2000 u hap nevoja për promovim të përshtatshëm të instrumentit por edhe aktiviteteve rreth zbatimit të saj në plan kombëtar, por edhe në atë rajonal.

Sistemi i koordinimit të zbatimit të këtij instrumenti që i themeluar nga aspekti i mbështetjes së procesit të programimit dhe zbatimit të instrumentit CARDS e ndërkohë duke bashkëpunuar me agjencionin Evropian për Rindërtim, e cila kishte mandat formal ligjor për zbatimin e projekteve CARDS në Republikën e Maqedonisë.

Sigurisht që rolin më të lartë në sistemin e koordinimit të ndihmës së huaj e kishte Komiteti i Ministrave për Koordinimin e Asistencës së Huaj, që në përputhje me dokumentet kryesore të KE-së (Dokumentit Kombëtar e strategjisë rajonale dhe Programeve të treguesve shumëvjeçar) dhanë drejtimin strategjik dhe prioritetet për finansim me mjetet e CARDS.

Në vitin 2007 u implementua instrumenti IPA i cili duke pasur rolin e instrumentit të para-pranimit ofroi një gamë më të gjërë aktivitetesh dhe një numër më të madh të fondeve të mjeteve financiare për financim të projekteve mbi përforcimin e kapacitetit të institucioneve kombëtare për zbatimin e ligjit të BE-së, por edhe përgatitjen e shtetit mbi shfrytëzimin e instrumenteve të ardhshme financiare siç janë Fondet Kohezive dhe Strukturore.

Duke filluar që nga viti 2007, Republika e Maqedonisë filloi me ndërtimin e sistemit kombëtar të decentralizuar për zbatimin e ndihmës së BE-së që sërish kërkon angazhim të madh dhe ndërtim të kapaciteteve të nevojshme për të ardhmen. Sistemi i menaxhimit të decentralizuar është i ndërtuar përmes vendosjes së katër strukturave operative dhe emërimit të funksioneve të të gjithë drejtuesve me të ashtuquajturin DIS sistem përmes punësimeve të reja, grupeve të reja punuese për zbatimin e IPA-së, rregullave dhe rregulloreve të reja që qenë subjekt i akreditimit nga ana e Komisionit Evropian.

Përfundimisht, në vitin 2013 filluan përgatitjet për vënien e Instrumentit të para-pranimit për Nidhmë II për periudhën 2014-2020 vjeçare. Në praktikë, IPA e re do të përqëndrohet në qasje sektoriale duke pasur pikë fokale rregullën e shtesës së mjeteve nga BE në fondet kombëtare buxhetore të sektoreve, me çka pritet nivel më i lartë i dukshmërisë, efikasitetit, efektivitetit dhe ndikimit të ndihmës së BE-së në Republikën e Maqedonisë. Shuma e mjeteve të parapara për Republikën e Maqedonisë rrotullohen në drejtime të njëjta ashtu si IPA e periudhës 2007-2013, rreth 600 milionë euro.

Mes tjerash, risia është mundësia e përdorimit të modeleve të ndryshme për zbatim (në mënyrë direkte, indirekte, si dhe përmes organizatave ndërkombëtare) në krahasim me IPA-në e periudhës 2007-2013, kur ekskluzivisht u kërkuva themelimi e zbatimi i një sistemi të centralizuar.

Cilat janë përshtypjet e përgjithshme të zbatimit të MSA-së, e cila është nënshkruar mes BE-së dhe Republikës së Maqedonisë?

Republika e Maqedonisë, është vendi i parë në rajon i cili e nënshkroi Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim, shtet i cili është udhëheqës në procesin e stabilizimit dhe asociimit. Marrëveshja për stabilizim dhe asociim mes Republikës së Maqedonisë dhe Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare, është nënshkruar më 9 prill të vitit 2001, gjersa hyri në fuqi pas procesit të ratifikimit në Republikën e Maqedonisë dhe në të gjitha shtetet anëtare të BE-së më 1 prill të vitit 2004.

Në përputhshmëri me nenin 5, paragrafi 1, është paraparë se “Asociimi do të realizohet brenda një periudhe kohore maksimum 10 vjet, ku i njëjti do të ndahet në dy faza të njëpasnjëshme”. Qëllimi i kësaj ndarjeje në faza të njëpasnjëshme është ngase dispozitat e Marrëveshjes për Stabilitet dhe Asociim duhet të implementohen në formë progresive dhe të fokusohen në fushat që janë përshkruar në aktet III, V, VI, dhe VII gjatë kohës së fazës së parë.

Nënshkrimi i MSA-së është e një rëndësie të jashtëzakonisht të madhe për zhvillimin e marrëdhënieve mes Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian. Në marrëdhëniet kontraktuale mes dyja palëve u vëndua një kualitet i ri, komponenta – asociim e cila përfshin elemente të një shkalle më të lartë të përkatësisë dhe komunitetit.

Nënshkrimi i Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim kishte një rëndësi të madhe politike sepse Republikës së Maqedonisë iu dha status i një kandidati të ardhshëm, që hap mundësi për anëtarësim të ardhshëm në Bashkimin Evropian. Kjo thuhet qartë në preambulën e cila konfirmon:

“Gatishmëria e BE-së për ta integruar Republikën e Maqedonisë gjer në shkallën më të lartë të mundshme në rrjedhat politike dhe ekonomike të Evropës dhe statusit të saj për kandidat të ardhshëm për anëtarësim në BE, në bazë të Traktatit të Bashkimit Evropian dhe përbushjes së kriteriumeve të përcaktuara nga ana e Këshillit Evropian në qershor të vitit 1993 në Kopenhagen, në varësi të zbatimit të suksesshëm të kësaj Marrëveshjeje, veçanërisht sa i përket bashkëpunimit rajonal”

Më 01.04.2014 u shënuan 10 vite nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) dhe 13 vite nga zbatimi i marrëveshjes së përkohshme për tregti dhe çështje tregtare. Viteve të fundit, Republika e Maqedonisë ka ruajtur rekord të pacenueshëm të implementimit. Marrëveshja, vendosi një kornizë kohore dhjetë vjeçare për përgatitje të procesit të

anëtarësim, që nënkupton vendosjen e perspektivës, se në vitin 2014, Maqedonia do të jetë në faza të negociatave për anëtarësim. Zbatimi i dispozitave nga Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim, ka kontribuar mbi avancimin politik dhe stabilizimin ekonomik dhe institucional të Republikës së Maqedonisë, doemos përmes zhvillimit të shoqërisë civile dhe demokratizimit, përf forcimin e institucioneve, reformat e administratës publike, përf forcimin e bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik, përf forcimin e sigurimit kombëtar e rajonal. Përf jekje të vazhdueshme bëhen edhe në aspekt të krijimit të mekanizmave të nevojshme në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme.

Shkalla e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) rregullisht ndiqet përmes pëunës së grupeve të përbashkëta të punës të vënë në pajtueshmëri me Marrëveshjen, synimi i së cilës është intensifikimi dhe promovimi i bashkëpunimit mes dy palëve.

Mr. Dragan Tilev,

Ish Bashkëkryesues i Komitetit për Stabilizim dhe Asociim



Përshkruani se si MSA ka mbështetur përpjekjet e Republikës së Maqedonisë për të përmbushur kriteret politike për anëtarësim në BE.

Nëse historikisht, Pakti i Stabilitetit mund të konsiderohet si një platformë ndërkombëtare për stabilizimin e rajonit tonë të trazuar dhe Procesi i Stabilizim-Asociimit si një kuadër e përcaktuar nga ana e BE për të drejtuar energjinë kolektive (si dhe në nivel rajonal) për të përmbushur qëllimin tonë strategjik të qartë anëtarësimi në BE, atëherë Marrëveshja për SA mund të konsiderohet si një bazë ligjore për të arritur këtë qëllim, e mbështetur përmes instrumenteve financiare të BE-së. Ne gjithmonë ishim plotësisht të vetëdijshëm se përmbushja e kriterëve politike të Kopenhagës janë parakushti themelor për përparim në procesin drejt anëtarësimi në BE. Pikërisht për këto arsye, përmes zbatimit konsekuent të MSA-së në të gjitha segmentet e saj, avancimin e legjislacionit tonë dhe ndërtimin e institucioneve kompetente dhe profesionale, duke përdorur format institucionale të dialogut politik të ofruara nga MSA-së (në nivel politik dhe ekspert), në periudhën e kaluar Maqedonia arriti ti përmbushë kriteret politike. Në fakt, ky është edhe konkluzioni i Komisionit Evropian për shumë vite tani.

Përshkruani se si MSA ka përkrahur harmonizimin e legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian, duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve administrative për të zbatuar ligjet e reja.

Një nga shtyllat themelore të MSA është neni 68, i cili kërkon në mënyrë të qartë pajtimin e të gjithë legjislacionit kombëtar ekzistues dhe të ardhshëm me atë të BE (acquis communautaire), dhe paralelisht me këtë proces, edhe ndërtimin e kapaciteteve institucionale për zbatimin e tij efikas. Maqedonia menjëherë pas nënshkrimit të MSA-së në mënyrë të vazhdueshme, sistematike, të organizuar dhe në përputhje, hyri në procesin e përafrimit, i cili rezultoi në zhvendosjes së mbi 2,300 rregulloreve të BE-së (rregulloreve, udhëzimeve, vendimeve) në legjislacionin tonë nacional, dhe atë me mbi 350 ligje të reja dhe mbi 1,800 akte nënligjore. Në të njëjtën kohë, legjislacioni i BE-së është e përkthyer në mënyrë të vazhdueshme në gjuhën maqedonase dhe është duke u krijuar një acquis communautaire maqedonase. Procesi i harmonizimit të legjislacionit, solli me vete përmirësimin e politikave sektoriale ekzistuese dhe definimin e të rejave, si dhe forcimin e institucioneve ekzistuese apo ndërtimin e institucioneve të reja, për funksionimin e të cilave u realizuan programe masive të trajnimit, por edhe u profilizuan ekspertiza të specializuara ngushtë, deri atëherë të panjohura për sistemin tonë.

Përshkruani se si MSA ka promovuar marrëdhëniet ekonomike të harmonizuara dhe gradualisht ka zhvilluar një zone për tregëti të lirë mes BE-së dhe Republikës së Maqedonisë.

Marrëveshja e SA në pjesën e politikave të bashkëpunimit, drejt i referohet bashkëpunimit ekonomik dhe vet procesit të integritetit, parashikon përmbushjen e kriterëve ekonomike të Kopenhagës. Përmes MSA, si kornizë, në bashkëpunim

me FMN-në dhe Bankën Botërore për të u vendos një dialog intensiv politik për të udhëhequr politikat tona ekonomike, duke filluar nga politika makroekonomike, fiskale dhe monetare, deri në ato të arsimit dhe politikës sociale, por edhe ndërtimin e një gjyqësori efikas dhe administratës, përmes së cilave matet funksionaliteti i ekonomisë tonë të tregut. Programi ekonomik i para-aderimit, të cilën Maqedonia për shumë vite me radhë është duke e përgatitur me sukses, paraqet një platformë për dialogun ekonomik me BE-në. Në pjesën e marrëdhënieve tregtare, me anë të MSA-së tashmë është arritur liberalizim i plotë i tregtisë, apo zone e lirë tregtare. Në periudhën e kaluar, e matur nga viti 2002 deri më vitin 2012, për 2,5 herë janë rritur eksportet tona në BE dhe për 1,5 herë importet tona nga BE. Në të njëjtën kohë BE-ja është partneri ynë më i madh tregtar, i pakrahasueshëm me çdo treg tjetër, duke absorbuar rreth 55% të totalit të eksporteve tona.

Përshkruani se si përmes MSA-së është arritur bashkëpunimi rajonal në fushat të cilat janë të përfshira me Marrëveshjen.

Një nga qëllimet e Marrëveshjes për SA ishte edhe rivendosja e lidhjeve të këputura ose krijimi i të reja, ndërmjet vendeve të Procesit për SA. Në periudhën kur i filloi negociatat me Maqedoninë, dhe më pas edhe me Kroacinë dhe vendet e tjera të rajonit, pasojat e luftës ishin akoma të freskëta dhe armiqësitë e ndërsjella të forta. PSA dhe MSA, i caktuan kriteret për bashkëpunim rajonal, vendosën standarde të sjelljes dhe themeluan mekanizma për drejtimin e energjisë drejt asaj që na bashkon, dhe jo drejt asaj që na ndanë. Çdo vend me MSA të nënshkruaj kishte obligim për të hyrë në bisedime me një vend tjetër me MSA të nënshkruar dhe të krijojë një kornizë ligjore, apo marrëveshje për bashkëpunim (ose konventë). Maqedonia tashmë e ka bërë këtë me Kroacinë, Serbinë, Malin e Zi dhe Shqipërinë, i përfundoi bisedimet me Bosnjë-Hercegovinën dhe do të presë rezultatet e negociatave të Kosovës për MSA-në e tyre. Realiteti i sotëm është që vendet e rajonit bashkëpunojnë përmes 45 iniciativave rajonale, edhe atë në të gjitha fushat, duke filluar nga ato ekonomike dhe të tregtisë përmes sigurisë, drejtësisë dhe punëve të brendshme, deri ato për infrastrukturë. Sipas shumë vetave, Maqedonia ka qenë dhe mbetet një lider në bashkëpunimin e hapur rajonal, pa rezervë dhe në të gjitha fushat.

Përshkruani se si MSA ka përgatitur Republikën e Maqedonisë për përdorimin efikas të fondeve aktuale nga BE-ja si dhe fondet kohezeve dhe strukturore në të ardhmen.

Objektivat e politikës së zgjerimit të BE-së, gjithmonë janë të shoqëruara me ndihmë financiare. Maqedonia përmes programit PHARE në periudhën e viteve 1996-1999 ka përdorur rreth 24-30 milion euro në vit (ose rreth 12-15 euro për person). Si një kornizë ligjore për të arritur qëllimet politike, Marrëveshja për SA shoqërohej nga instrumenti financiar CARDS, në periudhën e viteve 2000-2006, kur Maqedonia merrte ndihmë prej rreth 40-45 milion euro në vit (ose rreth 20-23 euro për person), respektivisht përmes instrumentit IPA, në periudhën 2007-2013, kur Maqedonia ka në dispozicion mesatarisht rreth 80-90 milion euro në vit (ose rreth 40-45 euro për person). Shuma e fondeve, e kombinuar me objektivat strategjike të cilat duhet arritur me ato, ishin motivim i mjaftueshëm gjatë zbatimit të MSA-së për të ndërtuar mekanizma funksionale për koordinim, planifikim, programim, zbatim dhe monitorim. Maqedonia aktualisht ka krijuar një sistem të decentralizuar të zbatimit të fondeve të BE-së, të cilat fokusohen në pronësi dhe llogaridhënie për fondet të cilat janë transferuar në nivel kombëtar. Këto janë procese të cilat janë fokusuar tërësisht në përgatitjen e terrenit për përdorimin e fondeve strukturore, ato të kohezionit, dhe fondet për mbështetjen e bujqësisë të cilat do të jenë në nivel të konsiderueshëm më e lartë sesa mjetet të cilat i përdorim tani. Simulimet tregojnë se si anëtare e BE-së, Maqedonia fillimisht do të kenë qasje në mesatarisht rreth 250-350 milion euro në vit (ose 125-175 euro në vit për person).

Cilat janë përshtypjet e përgjithshme të zbatimit të MSA-së, e cila është nënshkruar mes BE-së dhe Republikës së Maqedonisë?

Zbatimi i MSA-së, në partneritet me institucionet e BE-së, por në radhë të parë me Drejtorinë e Përgjithshme për Zgjerim është vendosur vite me radhë, me nivel të lartë profesional. Mekanizmat institucionale funksionojnë në mënyrë rutimore, ndërsa dialogu është i hapur dhe produktiv. Procesi i themeluar i harmonizimit të legjislacionit është duke u

zhvilluar në vazhdimësi dhe me nivel të lartë të ekspertizës. MSA ka ndihmuar në udhëheqjen e politikave tona sektoriale dhe harmonizimin e tyre gradual me politikat ekzistuese dhe të ardhshme evropiane. Në planin ekonomik dhe tregtar, është arritur qëllimi i krijimit të një zone të tregtisë së lirë me një orientim të lartë tregtar drejt tregut evropian dhe respektimin e të gjitha elementeve që përbëjnë një ekonomi moderne dhe funksionale të tregut. Për fat të keq, bllokada për hyrje formale në fazën e dytë të MSA-së na pamundëson që në tërësi reciprokisht të përmbushim detyrimet dhe qëllimet e rëna dakord. Në nivelin politik, MSA siguroi një dialog të thelluar politik, politika të harmonizuara të sigurisë së jashtme deri në nivelin më të lartë të mundshëm dhe progres në procesin e integrimit deri në nivelin e vendit-kandidat, me pesë rekomandime për fillimin e negociatave për anëtarësim, por pa asnjë datë për fillimin e negociatave. Është e qartë se në këtë pjesë, MSA nuk e ka përmbushur objektivin e saj gjatë këtyre dhjetë vjetëve të ekzistimit.

Dr. Malinka Ristevska-Jordanova,

Ish Bashkëkryesuese e Komitetit për Stabilizim dhe Asociim



Përshkruani se si MSA-ja i mbështet angazhimet e Republikës së Maqedonisë për përmbushjen e kriterëve politike për aderim në BE.

Për fat të keq nënshkrimi i MSA-së nuk ishte nxitje e mjaftueshme për evitimin e përlëshjes së armatosur, e cila praktikisht filloi në të njëjtën kohë në vitin 2001. MSA-ja ka qenë nxitje e fuqishme për përmbushje të kriterëve politike për anëtarësim në BE, mirëpo pasi subjektet politike vendore mblodhën forcat për arritje të pajtueshmërisë, iniciuan reforma të thella politike dhe njëkohësisht ndërtuan agjendë evropiane duke dorëzuar kërkesë për anëtarësim dhe status kandidati. Porosia e institucioneve evropiane se “rruga drejt Brukselit shpie kah Ohri” nuk ishte vetëm parullë, por nënkuptonte angazhim politik me përkushtim real. Vërtetë MSA-ja ka kontribuar në përmbushjen e kriterëve politike për anëtarësim, mirëpo një gjë e tillë është arritur falë vizionit të qartë dhe vullnetit politik për një agjendë të re reformuese të Republikës së Maqedonisë.

Përshkruani se si MSA-ja e mbështet harmonizimin e legjislacionit nacional me legjislacionin e Bashkimit Evropian, përfshirë edhe ndërtimin e kapaciteteve administrative për implementim të ligjeve të reja.

Marrëveshja ka paraparë harmonizim të programuar të së drejtës së BE-së dhe bashkërisht me procedurën e kërkesës për anëtarësim, ka kontribuar në ndryshim të konsiderueshëm të qasjes së Republikës së Maqedonisë drejt harmonizimit me politikën dhe legjislacionin e BE-së. Në këtë drejtim gjithsesi se ka kontribuar Programi nacional për miratim të së drejtës së BE-së, si dhe dialogu strukturor në strukturën institucionale të Marrëveshjes - Komiteti për stabilizim asociim dhe nënkomitetet e tij, si dhe komiteti parlamentar. Në veçanti në rrethana të këtilla, përderisa nuk kanë filluar as negociatat e as skringu i legjislacionit, praktikisht MSA-ja paraqet kornizë të vetme për dialog, me qëllim që të arrihet harmonizim me politikën dhe legjislacionin e BE-së. NPAA-ja dhe zbatimi i MSA-së kanë qenë kyçe në fuqizimin e kapaciteteve të administratës së Maqedonisë për transportim dhe zbatim të së drejtës së BE-së.

Përshkruani se si MSA-ja i ka avancuar marrëdhëniet e harmonizuara ekonomike dhe gradualisht e ka zhvilluar sferën e tregtisë së lirë ndërmjet BE-së dhe Republikës së Maqedonisë.

Me nënshkrimin e MSA-së u ndryshuan trendet e përgjithshme të bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik të Republikës së Maqedonisë, e cila tani është në masë të madhe ekonomikisht e integruar me BE-në. Mirëpo bllokada greke pamundësoi të hyjë fuqi faza e dytë e Marrëveshjes, pamundësoi shkallë më të lartë të integritit të Republikës së Maqedonisë me BE-në dhe pati ndikim negativ në motivin për reformat e mëtejme për aderim në BE, përfshirë edhe integrimin ekonomik.

Përshkruani se si me MSA-në është arritur bashkëpunim rajonal në sferat, që mbulon ajo.

Vetë MSA-ja, gjegjësisht detyrimi, të cilin e parashihte për marrëveshje bilaterale me shtetet e procesit të stabilizim asociimit, nuk mjaftonte për të siguruar bashkëpunim të zhvilluar rajonal, për shkak se Marrëveshja ne parim kishte karakter bilateral. Elementi që në mënyrë plotësuese e mbështeste bashkëpunimin rajonal ka qenë nxitja politike e BE-së, marrëveshjet rajonale të sektorëve, formimi i këshillit rajonal për bashkëpunim, si dhe mbështetja e komponentit horizontal rajonal të IPA-s. Gjithsesi se substanca e bashkëpunimit rajonal në parim ka qenë e varur nga vullneti politik i rajonit.

Përshkruani se si PSA-ja e përgatiti Republikën e Maqedonisë për përdorim efikas të fondeve rrjedhëse të BE-së dhe fondeve kohezive dhe strukturore në të ardhmen.

Në këtë drejtim MSA-ja më shumë ka kontribuar tërthorazi e më pak drejtpërdrejtë – përmes dialogut në strukturat e NPAA-së, i cili e përfshin edhe dialogun për përdorim të fondeve paraaderuese. Vetë përdorimi i fondeve paraaderuese dhe përgatitja për fondet strukturore dhe kohezive është varur nga kapacitete vendore nga njëra anë dhe vullneti politik nga ana tjetër – nga dinamika e procesit të aderimit, e cila për fat të keq në rastin e Republikës së Maqedonisë ishte e ngadalshme.

Cilat janë përshtypjet e përgjithshme për zbatim të MSA-së së nënshkruar ndërmjet BE-së dhe Republikës së Maqedonisë?

MSA-ja ishte paralajmëruar si instrument kyç për procesin e aderimit të Ballkanit perëndimor. Për Republikën e Maqedonisë ajo paraqiste shpërblim kryesor, para së gjithash për qasjen e tyre konstruktive në bashkëpunimin rajonal, në veçanti gjatë krizës së Kosovës, por edhe për politikën e atëhershme të saj për stabilitet politik. Kur MSA-ja hyri në fuqi, ajo paraqiste nxitje të fuqishme për fuqizim të kapaciteteve nacionale me qëllim që të realizohet agenda evropiane, e cila nga segmenti politik ishte politikisht fuqishëm e etabluar. Për fat të keq, gradualisht venitej lavdia e MSA-së së parë, ashtu që pas dhjetë viteve faza e dytë është ende e bllokuar nga Greqia, gjegjësisht janë të bllokuara negociatat e rekomanduara për anëtarësim në BE. Për të qenë fati edhe më i keq, janë duke u zhvilluar disa procese retrograde në sferat kyçe të demokracisë në vend. Shkuar nga perspektivë, Marrëveshja duhet të shikohet dhe vlerësohet si një aspekt i procesit aderues dhe në përgjithësi në marrëdhëniet ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe BE-së, roli i së cilës ishte i ndryshëm në periudhat e rrezikshme të aderimit, varësisht nga vullneti politik nga të dy anët.

Mr. Ermira Mehmeti,

Kryetare e Komisionit për Çështje Evropiane,
Kuvendi i Republikës së Maqedonisë



Përshkruani se si MSA-ja i mbështet angazhimet e Republikës së Maqedonisë për përmbushjen e kriterëve politike për aderim në BE.

Rëndësia e nënshkrimit të MSA-së, në pjesën e përmbushjes së kriterëve politike nga Kopenhaga është e madhe, nëse merret parasysh se ky është udhërrëfyes bazë dhe motiv për arritjen e institucioneve stabile, të cilat garantojnë demokraci, sundim të së drejtës, të drejtat e njeriut dhe respektim të mbrojtjes së pakicave, si dhe për bashkëpunim rajonal, marrëdhënie të mira fqinjësore me vendet aspirate për anëtarësim në BE dhe vendet anëtare të BE-së.

Për Republikën e Maqedonisë, krahas kriterëve klasike politike, implementimi i Marrëveshjes së Ohrit ishte dhe është pjesë esenciale e kriterëve politike për anëtarësim në BE (të drejtat e njeriut / të drejtat e bashkësive, funksionimi i shtetit juridik, dialogu politik, bashkëjetesa, reformat në administratë dhe gjyqësi, duke e përfshirë edhe përfaqësimin e drejtë). Implementimi i MKO-së e ka legjitimuar Republikën e Maqedonisë si kandidat për anëtarësim në BE.

Nevoja që të respektohet “fryma e marrëveshjes” është vazhdimisht prezentë në agjendën e përfaqësuesve të BE-së, si obligim të cilin shteti maqedonas detyrimisht duhet ta zbatojë.

Përshkruani se si MSA-ja e mbështet harmonizimin e legjislacionit nacional me legjislacionin e Bashkimit Evropian, përfshirë edhe ndërtimin e kapaciteteve administrative për implementim të ligjeve të reja.

MSA-ja e ka siguruar kornizën juridike dhe institucionale për harmonizimin e legjislacionit maqedonas me legjislacionin e BE-së.

Implementimi i MSA-së ka nxitur ndryshime në institucionet ekzistuese në shtet, si dhe themelimin e një numri të madh të institucioneve të reja. Paralelisht, me procesin e harmonizimit të legjislacionit nacional me legjislacionin e Bashkimit Evropian pasoi edhe procesi i përforcimit të kapaciteteve administrative në shtet.

Në bazë të MSA-së ishte përpiluar Programi nacional për miratimin e të drejtës së BE-së në vitin 2007, i cili revidohet çdo vit, dhe e ndjek dhe e shpreh dinamikën e harmonizimit të institucioneve nacionale ndaj strukturave administrative evropiane, si dhe nivelin e ligjeve të miratuara dhe të projektuara.

Si kryetare, por edhe si anëtare shumëvjeçare e Komisionit për Çështje Evropiane të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, i cili e ndjek harmonizimin e legjislacionit maqedonas me legjislacionin evropian, mund të konfirmoj se secili tekst ligjor me shenjë e BE-së, i cili ka hyrë në procedurë kuvendore dhe u referohet dispozitave të MSA-së.

Përshkruani se si MSA-ja i ka avancuar marrëdhëniet e harmonizuara ekonomike dhe gradualisht e ka zhvilluar sferën e tregtisë së lirë ndërmjet BE-së dhe Republikës së Maqedonisë.

Kur flitet për MSA-në në lidhje me kriteret ekonomike të Kopenhagës, të cilat kanë të bëjnë me funksionalizimin e ekonomisë së tregut dhe kapacitetit për ballafaqim me konkurrencën, mund të thuhet se Maqedonia në aspektin tregtar është më e integruar me BE-në.

MSA-ja edhe këtu ishte udhërrëfyese për themelimin gradual të zonave të lira ekonomike, e cila u vendos më 1 janar 2011 me qëllim që ekonomia maqedonase, krahas asaj që u bë ekonomi e lirë e tregut, gradualisht u ristrukturua dhe e përparoi konkurrencën e saj.

Pozitive janë përvojat nga funksionimi i Marrëveshjes për tregti të lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) nga viti 2006 për tregti të lirë në rajon, e cila zëvendësoi 32 marrëveshje bilaterale për tregti të lirë në rajon, vendosi liberalizim të plotë të tregtisë me prodhime industriale (me periudhë të tranzicionit për disa prodhime) dhe në masë të madhe e liberalizoi tregtinë me prodhime bujqësore, me çka këmbimi tregtar maqedonas me rajonin u rrit, me bilanc pozitiv.

Përshkruani se si me MSA-në është arritur bashkëpunim rajonal në sferat, që mbulon ajo.

Në bazë të kërkesës juridike të MSA-së për bashkëpunim rajonal për lidhjen e konventave bilaterale me shtetet të cilat do të përfshihen me procesin asociativ përmes lidhjes së MSA-së, Republika e Maqedonisë ka lidhur marrëveshje me Kroacinë, Shqipërinë dhe Malin e Zi. Në sferën e infrastrukturës është me rëndësi që të përmenden bashkëpunimet rajonale në bazë të Marrëveshjes për komunitetin energjetik me të cilën integrohet rajoni i Evropës Juglindore në Tregun e Përbashkët të BE-së dhe Marrëveshjen për Qiellin Unik Evropian, anëtare e së cilës është edhe Maqedonia. Bashkëpunimi rajonal është kriter i rëndësishëm për Republikën e Maqedonisë pasi që bën pjesë në kriteret politike dhe marrim vlerësime nga Brukseli për këtë çështje.

Përshkruani se si PSA-ja e përgatiti Republikën e Maqedonisë për përdorim efikas të fondeve rrjedhëse të BE-së dhe fondeve kohezive dhe strukturore në të ardhmen.

Në Kapitullin 9 të MSA-së është paraparë ndihma financiare nga Komuniteti në formë të mjeteve dhe huave të pakthyeshme, duke i përfshirë edhe huat nga Banka Investuese Evropiane. Kjo ndihmë financiare ishte shfrytëzuar për zhvillimin e reformave demokratike, ekonomike dhe institucionale në vend me qëllim të realizohen detyrat e theksuara në MSA-në.

Këto mjete financiare ishin bazë për përgatitjen e Republikës së Maqedonisë për shfrytëzimin e Instrumenteve të reja të BE-së për ndihmë financiare dhe teknike, edhe atë Instrumenti për ndihmë paraaderuese IPA 1 (2007-2013) dhe IPA 2 (2014-2020), në të cilat Republika e Maqedonisë ka qasje.

Cilat janë përshtypjet e përgjithshme për zbatim të MSA-së së nënshkruar ndërmjet BE-së dhe Republikës së Maqedonisë?

Për Maqedoninë, respektimi i MSA-së si prioritet i shtetit dhe kriter kryesor i procesit eurointegruar u tregua si i suksesshëm.

Në rastin e Maqedonisë stabilizimi dhe asociimi rrodhën paralelisht. Komisioni konstatoi se “Republika e Maqedonisë, ka arritur nivel të lartë të respektimit të MSA-së”, dhe në bazë të kësaj në vitin 2009 konstatoi se vendi në mënyrë të kënaqshme i plotësoi Kriteret Politike të Kopenhagës dhe kriteret e DSA-së dhe i rekomandoi Këshillit për kalim në Fazën e Dytë të MSA-së.

Për fat të keq, Këshilli nuk e konfirmoi rekomandimin e Komisionit për shkak të bllokimit grek, dhe Maqedonia nuk hyri në Fazën e Dytë, ashtu siç e meriton. Këtu ngrihet çështja nëse ndarja e dy fazave të MSA-së krijon mundësi për bllokime politike, që nga ana tjetër negativisht ndikon në vazhdimin e procesit eurointegruar të shtetit, por edhe të disponimit të gjerë të qytetarëve për proceset evropiane.

Silvana Boneva,

Ish Nënkryetare e Këshillit Nacional për Eurointegritim,
Kuvendi i Republikës së Maqedonisë



Përshkruani se si MSA-ja i mbështet angazhimet e Republikës së Maqedonisë për përmbushjen e kriterëve politike për aderim në BE.

Republika e Maqedonisë ishte vendi i parë, i cili e nënshkroi Marrëveshjen e stabilizim asociimit me BE-në (MSA) në vitin 2001. Marrëveshja hyri në fuqi më 1 prill të vitit 2004. MSA-ja paraqet kornizë ligjore, e cila i rregullon marrëdhëniet e Republikës së Maqedonisë me BE-në, mundëson kornizë për dialog politik dhe fuqizim të bashkëpunimit rajonal, avancim të zgjerimit të tregjeve dhe marrëdhënieve ekonomike si dhe i krijon bazat për ndihmë teknike dhe financiare.

Në tetor të vitit 2009, Komisioni Evropian i dha rekomandim Këshillit të fillojë negociatat me Republikën e Maqedonisë dhe të kalohet në fazën e dytë të zbatimit të Marrëveshjes së stabilizim asociimit ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe BE-së. Këta rekomandime janë përsëritur në vitet 2010, 2011, 2012 dhe 2013. Këshilli ende nuk ka marrë qëndrim për rekomandimet e Komisionit.

Në mungesë të procesit të negociatave, forumet kryesore për diskutim dhe ndjekje të reformave janë organet e themeluara nga MSA-ja, si dhe Dialogu aderues në nivel të lartë i themeluar në vitin 2012.

Dialogu i rregullt politik dhe ekonomik ndërmjet BE-së dhe RM-së vazhdon përmes strukturave të MSA-së (Komiteti për stabilizim dhe asociim dhe Këshilli për stabilizim dhe asociim).

Vendi ka bashkëpunim të thellë dhe të gjerë me BE-në në të gjitha sferat e legjislacionit evropian dhe është në shkallë të avancuar të harmonizimit të legjislacionit në nivel strategjik dhe institucional.

Nga aspekti i përmbushjes së kriterëve politike në segmentin e gjyqësisë dhe të drejtave fundamentale nga 01.01.2013 zbatohet ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për gjyqësi, në pajtim me të cilin gjykatësit e gjykatave themelore përzgjidhen vetëm nga radhët e kandidatëve-të diplomuarve nga Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publik. Nga 01.07.2013 zbatohen dispozitat, të cilat kanë të bëjnë me kushtet profesionale për përzgjedhje të gjykatësve në gjykatat më të larta. Po ashtu, është miratuar Korniza për implementim të mëtejme të reformës së gjyqësisë 2014-2017.

Përshkruani se si MSA-ja e mbështet harmonizimin e legjislacionit nacional me legjislacionin e Bashkimit Evropian, përfshirë edhe ndërtimin e kapaciteteve administrative për implementim të ligjeve të reja.

- Harmonizimi i legjislacionit nacional me atë evropian

Kuvendi e ndjek harmonizimin nga aspekti i dinamikës së Qeverisë në propozimin e ligjeve në Kuvend, të cilat kanë qenë pjesë e revizionit vjetor të NPAA-së dhe në atë parim janë dorëzuar në Kuvend. Në lidhje me harmonizimin e

legjislacionit nacional me atë të Bashkimit Evropian në vitin 2012 janë miratuar 33 ligje, në vitin 2013 janë miratuar 37 ligje dhe në vitin 2014 janë miratuar 11 ligje.

- Ndërtimi i kapaciteteve administrative për implementim të ligjeve të reja

Në lidhje me ndërtimin e kapaciteteve administrative për zbatimin e ligjeve të reja, Shërbimi i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë vazhdimisht edukohet dhe i zhvillon më tej njohuritë, përvetëson shkathtësi të reja dhe të njëjtat i zbaton në pajtim me punën e përditshme përmes më shumë formave të edukimit, të cilat janë në dispozicion pas hyrjes në fuqi të MSA-së. Në fakt në kuadër të Sekretariatit të Parlamentit të Evropës në Drejtorinë për politika të jashtme ekziston një Departamenti i posaçëm për aktivitetet aderuese (më parë emërtohej Departamenti për marrëdhënie me kuvendet kombëtare të Ballkanit Perëndimor) dhe në vazhdimësi për më shumë se 10 vite është realizuar bashkëpunim shumë i frytshëm dhe i suksesshëm. Çdo vit departamenti në fjalë mesatarisht ka organizuar nga 4 seminare në tema të ndryshme, dedikuar deputetëve dhe nëpunësve të parlamenteve të vendeve të Ballkanit perëndimor përfshirë edhe Turqinë.

Në këta seminare ftohen nga 4 deputetë dhe nga dy nëpunës nga komisionet e resorëve dhe sektorët, ndërsa temat që përpunohen janë gjithnjë aktuale dhe të definuara në pajtim me nevojat dhe iniciativat e shprehura nga parlamentet e ftuara. Seminarët paraqesin mundësi të mrekullueshme për diskutim interkativ dhe të ndërsjellë të deputetëve të këtij rajoni me deputetët evropian, përfaqësuesit e Komisionit evropian, ekspertët me renome, përfaqësuesit e botës akademik dhe të tjerë.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë për dy herë ishte nikoqir i një seminari të këtillë. Herën e parë seminari iu ishte dedikuar nëpunësve të Kuvendit dhe u zhvillua më 19 dhe 20 shtator të vitit 2007, ndërsa vitin e kaluar më 24 dhe 25 shtator një seminar i këtillë u mbajt në temën: “Parlamenti i hapur: transparenca e aktiviteteve parlamentare”, ku përveç pjesëmarrësve të parlamenteve të rajonit, mori pjesë edhe një nënkryetar i Parlamentit Evropian dhe disa deputetë të shquar evropian.

Kuvendi në mënyrë aktive merr pjesë edhe në forma tjera të fuqizimit të kapaciteteve të veta administrative me partnerin e vetë – Parlamentin Evropian. Në nivel vjetor organizohet nga një vizitë studimore, e cila në veçanti iu dedikohet nëpunësve shtetëror të posa punësuar, e cila përfshin vizitë të Parlamentit Evropian, Komisionit Evropian dhe institucioneve tjera të Bashkimit Evropian.

Nga viti i kaluar e kemi në dispozicion një lloj tjetër të trajnimit – stazhi në Parlamentin Evropian i nëpunësve të përzgjedhur nga komisioni i specializuar i Parlamentin Evropian, në kohëzgjatje prej 6 javëve – ku janë të mbuluara të gjitha shpenzimet. Në procedurë e sipër është përgatitja për realizimin e stazhit të dytë të një nëpunësi të Shërbimit të Kuvendit, që duhet të realizohet në pjesën e dytë të vitit 2014.

Edhe në kuadër të ECPRD-së (Qendrës Evropiane për Dokumentim dhe Hulumtim) realizojmë edukim të vazhdueshëm të nëpunësve, me pjesëmarrjen tonë aktive në seminarët e tyre tematike, të cilat zakonisht zhvillohen 2-3 në vit. Javën e kaluar më 8 dhe 9 maj të vitit 2014 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë për herë të dytë ishte nikoqir i Seminarit të ECPRD-së në temën: “Struktura dhe procedurat në këndvështrim të kodeksit etik të deputetëve dhe integritetit të shërbimit parlamentar.”

Në kuadër të IPA projektit “Demokracia dhe të drejtat fundamentale”, i cili u realizua për 18 muaj në periudhën prej janarit të vitit 2011 deri në korrik të vitit 2012, qëllimi parësor ka qenë fuqizimi i kapaciteteve institucionale të Kuvendit, me qëllim që edhe më tepër të përmirësohet transparenca dhe përgjegjësia e tij para qytetarëve. Në këtë drejtim u realizuan një sërë seminaresh me pjesëmarrje të lartë të nëpunësve të sektorëve të targetuar, me çka u arrit nivel mjaft i lartë për përvetësim të njohurive dhe shkathtësive të përfshira në trajnim.

- **Qëllimet specifike të IPA Projektit:** Përmirësimi i profesionalizimit të udhëheqësisë dhe të shërbimit të Kuvendit, në veçanti duke pasur parasysh sfidat, të cilat imponohen me integrimin më të afërt drejt Bashkimit Evropian.

Projekti përbëhet nga tre pjesë:

- **Përmirësimi i funksionimit të mbështetjes profesionale të komisioneve të kuvendit**

Fokus: Sektori për organe të punës, Sektori ligjor-juridik, Sektori për mbështetje të Këshillit Nacional për Eurointegritim (KNEI) dhe Sekretariati për Komitetin e përzier parlamentar të Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian

Realizimi i trajnimit (roli i Parlamentit në procesin e negociatave, përgatitjen e propozim-ligjeve dhe amendamenteve në procesin e negociatave, roli i Parlamentit në Marrëveshjen e Lisbonës)

Vizita studimore për pjesëmarrësit (në ndonjë Parlament të ndonjë vendi të ri anëtar)

Revidimi i punës së komisioneve kuvendore dhe dhënia e rekomandimeve për nevojat e procesit të negociatave për anëtarësim në BE

Revidimi i vëllimit të punës së komisioneve të kuvendit dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësim të efikasitetit

Përpunimi i doracakut dhe/ose ndryshimi i doracakut ekzistues, që do t'i përfshijë procedurat e domosdoshme, të cilat dalin nga Rregullorja e Kuvendit

- **Përmirësimi i kapaciteteve të personelit profesional për përpunim të raporteve analitike**

Fokus: Instituti Parlamentar dhe Sektori për hulumtim, analizë, dokumentim dhe bibliotekë

Analiza e të gjitha kërkesave për hulumtim në procesin e aderimit në BE

Zbatimi i programit për trajnim dhe hulumtim për legjislacionin e BE-së

Vizita studimore për pjesëmarrësit (në ndonjë Parlament të vendit të ri anëtar)

Ruajta e serisë së seminareve për deputetë dhe shërbimit parlamentar në lidhje me çështjet, që kanë të bëjnë me procesin e aderimit

Ndihma e nëpunësve për publikim të së paku gjashtë hulumtimeve më të mëdha, që kanë të bëjnë me procesin e aderimit në BE

Prezantimi i hulumtimeve të publikuara për deputetë dhe palë tjera të interesuara

Ndihma e Kuvendit për zhvillim të strukturave udhëheqëse për kërkesat e veta për hulumtim të informacioneve

- **Përmirësimi i qasjes në sigurimin e informacioneve për deputetët dhe personelin e Kuvendit, në veçanti ato që kanë të bëjnë me aderimin në BE, si dhe përkujdesja që ato informacione të jenë në dispozicion për publikun**

Krijimi i bazës së të dhënave me resurse të paguara për legjislacionin dhe politikat e BE-së në EU Qendrën.

Trajnimi i personelit për përdorim të bazës së të dhënave,

Përgatitja e specifikimit teknik të marrëveshjes për furnizim me harduerë dhe softuerë për arkivim audio-vizual të seancave të Kuvendit me qasje në internet

Punëtoritë për t'ua prezantuar deputetëve dhe personelit të Kuvendit bazat e të dhënave për BE

- **Në pjesën e kofinancimit nacional në kuadër të IPA projektit është hapur EU qendra me hapësira të posaçme brenda ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë**

Në kuadër të projektit TAIEKS, i cili është i sponsorizuar nga Komisioni Evropian dhe iu dedikohet nëpunësve shtetërorë, Shërbimi i Kuvendit në kontinuitet merr pjesë në seminarët TAIEKS, në tema të propozuara nga vetë pjesëmarrësit, ku në mënyrë të argumentuar elaborohen arsyet për shkak të së cilave kërkohet ndonjë edukim i caktuar.

Përshkruani se si MSA-ja i ka avancuar marrëdhëniet e harmonizuara ekonomike dhe gradualisht e ka zhvilluar sferën e tregtisë së lirë ndërmjet BE-së dhe Republikës së Maqedonisë.

Republika e Maqedonisë vazhdon t'i përmbush detyrimet e MSA-së, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me fazën e parë të implementimit të pikës 5 (lëvizja e punëtorëve; themelimi, sigurimi i shërbimeve dhe kapitalit). Është nënshkruar protokollin për zgjerim drejt MSA-së pas hyrjes së Republikës së Kroacisë në BE.

Në sferën e *lëvizjes së lirë të mallrave* është arritur shkallë e lartë e harmonizimit. Vazhdon zbatimi i Planit aksionar për harmonizim me nenet 34-36 të Marrëveshjes për funksionim të Bashkimit Evropian (MFBE), si dhe harmonizim të dispozitave juridike, të cilat janë pjesë e negociatave për lidhje të Marrëveshjes AKA. Numri i përgjithshëm i standardeve të miratuara evropiane si standarde të Maqedonisë është 18.350, gjegjësisht 99% të numrit të përgjithshëm të standardeve evropiane. Të gjitha standardet e miratuara janë të firmosura në Komitetin Evropian për standardizim, Komitetin Evropian për standardizim elektroteknik dhe Institutin Evropian për standarde telekomunikuese. Deri më tani janë akredituar 129 organe për vlerësim të harmonizimit dhe 21 kërkesa të reja për akreditim.

Në lidhje me *lëvizjen e lirë të kapitalit*, harmonizimi i legjislacionit nacional është në rrugë të duhur. Republika e Maqedonisë i përmbush kushtet e fazës së parë të MSA-së, liberalizimi i mëtejshëm i lëvizjes së kapitalit dhe pagesat është paraparë të zbatohet pas kalimit në fazën e dytë të MSA-së. Pas hyrjes në fazën e dytë të MSA-së, Banka Popullore e RM-së do të bëjë harmonizim të përshtatshëm ligjor të akteve nënligjore, të cilat janë nën kompetencat e saj.

Në të ardhurat nga doganat në buxhetin e vitit 2014 të Republikës së Maqedonisë në pajtim me MSA-në është përfshirë edhe efekti i zvogëlimit të doganave për import të mallrave të BE-së.

Ka përfunduar faza e katërt e avancimit të sistemit elektronik me një sportel për lëshim të lejeve për import dhe eksport dhe kuotave tarifore (EXIM).

Në sferën e marrëdhënieve tregtare ndërkombëtare në vitin 2014 Republika e Maqedonisë do ta drejtojë CEFTA-n dhe

Nënkomitetin për bujqësi, masa sanitare dhe fitosanitare, si dhe Grupin e punës për shërbime. Prioritetet e drejtimit janë: liberalizimi i ardhshëm i tregtisë me produkte bujqësore dhe tregti me shërbime; thellimi i implementimit të CEFTA-s për lehtësim të ardhshëm të tregtisë; promovimi i bashkëpunimit rajonal në politikën e konkurrencës, të drejtat e pronës intelektuale dhe furnizimeve publike dhe ruajtja e sinergjisë ndërmjet zbatimit të CEFTA-s dhe Strategjisë së Evropës juglindore 2020 në sferën e rritjes së integruar.

Republika e Maqedonisë ka lidhur 43 marrëveshje për shmangie të tatimit të dyfishtë, nga këta 24 janë marrëveshje me vendet anëtare të BE-së.

Përshkruani se si me MSA-në është arritur bashkëpunim rajonal në sferat, që mbulon ajo.

Avancimi i marrëdhënieve dhe bashkëpunimit me vendet fqinje dhe fuqizimi i bashkëpunimit rajonal janë ndër prioritetet kyçe të politikës së jashtme të Republikës së Maqedonisë.

Në bashkëpunimin rajonal theksi është vënë në pjesëmarrjen e mëtejme aktive në Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (PBEJL); Këshillin për Bashkëpunim Rajonal (KBR); Iniciativën Qendrore Evropiane (IQE); dhe Konventën për zbatim të ligjeve të Evropës Juglindore (SELEK); Qendrën rajonale SEKI në Bukuresht. Në Republikën e Maqedonisë gjendet selia e Iniciativës rajonale për migracion, azil dhe refugjatë në Evropën juglindore (MARRI), me të cilën do të drejtojnë gjatë viteve 2014-2015. Në Republikën e Maqedonisë kanë seli edhe Rrjeti shëndetësor i shteteve të EJL-së (SEEHN); Sekretariati për asociim të pushteteve lokale të EJL-së (NALAS); Grupi i përhershëm i punës për zhvillim rajonal rural (SVG), ku Republika e Maqedonisë ka përfaqësues të vetë edhe në Këshillin për bashkëpunim rajonal edhe në SEKI. Republika e Maqedonisë ka statusin e mbikëqyrësit në procesin e Danubit.

Republika e Maqedonisë plotësisht e mbështet qasjen makrorajonale për bashkëpunim të promovuar nga Bashkimi Evropian dhe do të dorëzojë kërkesë për përfshirje të Strategjisë makrorajonale, e cila është në fazë të përgatitjes në Komisionin Evropian.

Përshkruani se si PSA-ja e përgatiti Republikën e Maqedonisë për përdorim efikas të fondeve rrjedhëse të BE-së dhe fondeve kohezive dhe strukturore në të ardhmen.

Kapitulli 22 (politika rajonale dhe koordinim i instrumenteve strukturore) përfshin koordinimin dhe bashkëpunimin e institucioneve të Republikës së Maqedonisë. Sistemi për mbështetje të zhvillimit rajonal i koordinuar ndërmjet më shumë ministrive dhe institucioneve qeveritare përfshin elemente për nxitje të bashkëpunimit me sektorin joqeveritar dhe atë të biznesit në rajonet e planifikuara.

Instrumenti për ndihmë paraderuese - IPA paraqet pjesë të pakos së aksioneve të jashtme të BE-së. Si bazë për krijim të strukturave të nevojshme dhe organeve kompetente të Republikës së Maqedonisë për menaxhim më IPA asistencës gjatë menaxhimit të decentralizuar, Marrëveshja kornizë është akti themelor juridik, në të cilin janë dhënë parimet për bashkëpunim ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit Evropian në lidhje me implementimin e IPA-së. Është krijuar Sistemi për menaxhim të decentralizuar me IPA (DIS) për implementim të komponentëve 1, 3 dhe 4 në pajtim me kriteret akredituese të Aneksit të Rregulloreve të KE-së nr. 718/2007. Institucionet nacionale janë përgjegjëse për programim, përdorim të drejtë dhe efikas të mjeteve të fituara në kuadër të komponentëve 4 dhe 5 (përveç për IPA komponentin 2 për Bashkëpunim ndërkufitar, i cili implemetohet në mënyrë të decentralizuar nga DEU. Në Strukturën operative të IPA komponentëve 1, 3 dhe 4 në vend janë akredituar 32 institucione, ndërsa në kuadër të strukturave të IPA-s në Republikën e Maqedonisë punojnë rreth 350 njerëz.

Deri më 31.12.2013 janë lidhur një sërë marrëveshjesh, prej të cilave 77 janë nga të komponenti i parë i IPA-s (TAIB

2009 dhe TAIB 2010), 17 në IPA Komponentin 3 dhe 24 marrëveshje të IPA Komponentit 4. IPA do të vazhdojë të funksionojë edhe në periudhën 2014-2016.

Në Instrumentin e ri (IAP II) fokusi më i gjerë i Komisionit Evropian për mbështetje në periudhën 2014-2020 është vënë në zhvillimin socio-ekonomik, sundimin e së drejtës dhe qeverisje së mirë me verifikim të prioritetëve të këtyre sektorëve:

- Sundimi i ligjit dhe së drejtës fundamentale;
- Menaxhimi dhe demokracia;
- Mjedisi jetësor;
- Transparenca;
- Konkurrenca dhe inovacioni;
- Arsimi, punësimi dhe politika sociale;
- Bujqësia dhe zhvillimi rural;
- Bashkëpunimi ndërkufitar.

Republika e Maqedonisë merr pjesë aktive në *programet e BE-së*: Programi i shtatë kornizë për hulumtim, përparim, program për sipërmarrësi dhe inovacione, kulturë, Evropa për qytetarët, Fiskalis 2013, Programi evropian për Evropë inteligjente.

Cilat janë përshtypjet e përgjithshme për zbatim të MSA-së së nënshkruar ndërmjet BE-së dhe Republikës së Maqedonisë?

Komiteti i përzier parlamentar – Republika e Maqedonisë dhe Bashkimi Evropian (BE) është formuar në bazë të Rezolutës së Parlamentit Evropian më 10 mars të vitit 2004, si dhe Vendimit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë nga 7 dhjetori i vitit 2004 për themelimin të Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë në Komitetin parlamentar për stabilizim dhe asociim dhe në bazë të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit të Republikës së Maqedonisë (në veçanti të nenit 114).

Formimi i Komitetit të përzier parlamentar (KPP) e pasqyron përcaktimin e fuqishëm të vendit tonë për anëtarësim të plotfuqishëm në BE dhe angazhimet e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë përmes dialogut parlamentar, që të kontribuojë në procesin e eurointegritimit dhe arritjes së standardeve evropiane.

Komiteti i përzier parlamentar paraqet forum, ku anëtarët e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe Parlamenti Evropian shkëmbejnë përvoja, mendime dhe qëndrime për fuqizim të partneritetit të ndërsjellë. Komiteti paraqet fuqizim formal dhe efikas, gjegjësisht ngritje të nivelit të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërmjet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe Parlamentit të Evropës.

Qëllimi kryesor i KPP-së është shqyrtimi i të gjitha aspekteve të marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe BE-së, në veçanti implementimi i Marrëveshjes së stabilizim asociimit. Me propozim të Byrosë së Komitetit të Përzier Parlamentar mund të jepen rekomandime deri te Parlamenti i Evropës te Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë, te Këshilli i Bashkimit Evropian dhe Komisioni Evropian. KPP takohet dy herë në ditë – njëherë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe një herë në Parlamentin Evropian. Mbledhjet e Komitetit të Përzier Parlamentar përfundojnë me miratimin e Deklaratës përfundimtare, e cila në fakt është dokument, në të cilin janë dhënë qëndrimet e përbashkëta për çështje të caktuara aktuale.

Në drejtim të përmirësimit të strukturave administrative, fuqizimit të kapaciteteve administrative, si dhe rritjes së transparencës dhe përgjegjesisë së administratës edhe në vitin 2014 vazhdon koordinimi i procesit të reformës së administratës publike. Kuvendi e miratoi Ligjin për nëpunës të administratës dhe Ligjin për nëpunës të sektorit publik. Do të vazhdohet me sigurimin e zhvillimit profesional, efikas, të përgjegjshëm, transparent të administratës publike dhe shtetërore të orientuar drejt shërbimeve cilësore. Po ashtu do të ndërmerren një sërë aktivitete në drejtim të përmirësimit të cilësisë së administratës, gjegjësisht: në institucionet shtetërore të krijohet sistemi për menaxhim cilësor sipas standardit ISO 9001, të implementohet Korniza e përbashkët për vlerësim të institucioneve tjera, të fuqizohen kapacitetet e administratës për menaxhim të resurseve njerëzore. Fokus të veçantë është vënë në zbatimin e Marrëveshjes së stabilizim asociimit të lidhur mes Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian, gjegjësisht vendeve anëtare të BE-së, ndjekjen e realizimit të Partneritetit aderues, koordinimin dhe realizimin e prioriteteve të Dialogut aderues në nivel të lartë, si dhe realizimin e NPAA-së.

Dobitë e nënshkrimit të MSA-së janë të mëdha dhe kanë efekt të madh sasior para dhe pas nënshkrimit të saj, pasi që institucionet shtetërore (në këtë kontekst edhe Kuvendi i Republikës së Maqedonisë) kanë dëshmuar gatishmëri për t'i pranuar sfidat e reja, gjegjësisht janë dëshmuar si të gatshme të ofrojnë rezultatet dhe veprime konkrete.

Dr. Simonida Kacarska,

Kryetare e Kuvendit të Institutit për Çështje Evropiane



Përshkruani se si MSA-ja i mbështet angazhimet e Republikës së Maqedonisë për përmbushjen kritereve politike për hyrje në BE.

Periodha në të cilën është nënshkruar Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ishte kyçe për ndërtimin e konsenzusit ndëretnik për reformat politike në Republikën e Maqedonisë. Në çdo rast, në vitet e para pas nënshkrimit të MSA-së, si dhe perspektivën e përgjithshme të aderimit të Republikës së Maqedonisë në BE, ishte e rëndësishme për ndryshimet kushtetuese të lidhura me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit, si dhe më pas ndryshimet kushtetuese të lidhura me pavarësinë e gjyqësorit disa vjet më vonë. Në këtë kontekst MSA-ja dha një shtytje për të përmbushur kriteret për demokracinë dhe sundimin e ligjit, si segmentin e parë nga kriteret politike për anëtarësim në BE. Ky efekt ishte direkt i dukshëm përmes organeve të themeluara me MSA-në, veçanërisht Këshilli dhe Komisioni për stabilizim-asociim.

Përshkruani se si MSA-ja e mbështet harmonizimin e legjislacionit nacional me legjislacionin e Bashkimit Evropian, përfshirë edhe ndërtimin e kapaciteteve administrative për implementim të ligjeve të reja.

MSA-ja e mbështet harmonizimin e legjislacionit nacional përmes bashkërendimit të legjislacionit dhe organeve të krijuara me Marrëveshjen në fjalë. Në nivel teknik nënkomitetet kanë paraqitur bazë për përgatitjet e dokumenteve strategjike si NPAA-ja, me çka kanë mundur edhe avancim dhe planifikim më shumë vjeçar në Republikën e Maqedonisë. Në mungesë të negociatave aderuese, harmonizimi në kuadër të MSA-së paraqet mundësi për avancim të harmonizimit të dispozitave ligjore të Republikës së Maqedonisë me legjislacionin e BE-së. MSA-ja ka hapur mundësi për takime dhe shkëmbim të ekspertizës dhe mendimeve ndërmjet zyrtarëve të BE-së dhe RM-së, me çka është avancuar legjislacioni nacional në rrethanat e ngecjes së RM-së në procesin e aderimit në BE.

Përshkruani se si MSA-ja i ka avancuar marrëdhëniet e harmonizuara ekonomike dhe gradualisht e ka zhvilluar sferën e tregtisë së lirë ndërmjet BE-së dhe Republikës së Maqedonisë.

Marrëdhëniet ekonomike ishin bazë e MSA-së në kohën e nënshkrimit të saj. Përderisa pritej që MSA-ja në mënyrë të tërthortë të ndikojë në përmbushjen e kritereve politike për aderim në BE, rezultati konkret vërehej në kontekst të asociacionit ekonomik dhe tregtisë së lirë ndërmjet BE-së dhe RM-së. Megjithatë, në kontekst të RM-së për shkak të dhënies përparësi të kritereve politike, dimensionin ekonomik i MSA-së ishte në masë të madhe i marginalizuar nga publiku. Hapja e fazës së dytë paraqiste hapin vijues në avancimin e marrëdhënieve ekonomike dhe mundësinë për avancim të tregtisë së lirë ndërmjet BE-së dhe Republikës së Maqedonisë, mirëpo një gjë e tillë ende nuk është materializuar.

Përshkruani se si me MSA-në është arritur bashkëpunim rajonal në sferat, që mbulon ajo.

Bashkëpunimi rajonal si njëri ndër komponentat kyçe të MSA-së u avancua deri në një shkallë të caktuar, mirëpo avancimi i ndryshëm i vendeve të rajonit pamundësoi ndikim esencial të MSA-së ndaj kësaj sfere. Sferat, si tregtia, transporti dhe energjia kanë disa rezultate të dukshme, mirëpo edhe në ta ngel shumë hapësirë për përmirësim në kontekstin e integritetit në rajon dhe në BE. Ngjashëm ishte rasti me institucionet, siç është Këshilli rajonal për bashkëpunim, ndikimi i së cilit ishte i kufizuar. Njëkohësisht duhet të merret parasysh se kushti për bashkëpunim rajonal në periudhën e nënshkrimit të MSA-së në masë të madhe ka qenë i fokusuar drejt krijimit të paqes mes Republikave të ish Jugosllavisë pas konflikteve të viteve të 90-ta dhe kthimit të refugjatëve, ashtu që Republika e Maqedonisë edhe praktikisht ishte në margjinat e këtyre çështjeve.

Përshkruani se si PSA-ja e përgatiti Republikën e Maqedonisë për përdorim efikas të fondeve rrjedhëse të BE-së dhe fondeve kohezeve dhe strukturore në të ardhmen.

Nënshkrimi dhe zbatimi i MSA-së paraqiste hap të rëndësishëm në avancimin e koordinimit të fondeve të BE-së në nivel nacional. Planifikimi i aktiviteteve për zbatim të MSA-së në kuadër të planeve aksionare, si dhe detyrimet e organeve të MSA-së ishin hap përpara drejt koordinimit të politikave nacionale në shfrytëzimin e ndihmës së BE-së. Në këtë kontekst, planifikimi për MSA krijoi bazë për prioritetet e planifikimit të ndihmës së BE-së. Nga ana tjetër KARDS programi si instrument themelor financiar në periudhën e nënshkrimit të MSA-së i krijoi bazat e programimit të ndihmës së BE-së, të cilat më tej u zhvilluan me IPA.

Cilat janë përshtypjet e përgjithshme për zbatim të MSA-së së nënshkruar ndërmjet BE-së dhe Republikës së Maqedonisë?

MSA-ja i ndërtoi themelet e hapave të mëtejme për aderim të Republikës së Maqedonisë në BE, siç është dorëzimi i aplikacionit për anëtarësim. Mekanizmat institucionale të krijuara nga MSA-ja kanë qenë bazë për komunikim ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe BE-së si në nivelin politik po ashtu edhe në atë administrativ. Përderisa në vitet e para të lidhjes së marrëveshjes, organet e MSA-së para së gjithash shërbenin për ushtrim për palën e Maqedonisë, pasi për shkak të mungesës së negociatave, ato paraqitnin mënyrë të ruajtjes së procesit eurointegruar në vend. Megjithatë, bazuar në statusin ekzistues të procesit aderues, mospjesëmarrja e hapjes së fazës së dytë të MSA-së e vë në pikëpyetje projektin e përgjithshëm dhe potencialin e tij për të shërbyer si vegël për avancim të gjendjes së Republikës së Maqedonisë.

Shtefan Fyle,

Komesar për Zgjerim i Komisionit Evropian



Si Komisioner i Bashkimit Evropian përgjegjës për zgjerim, me rastin e botimit të monografisë për dhjetëvjetorin e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, shfrytëzoj rastin t’ju uroj dhjetëvjetorin e implementimit të saj.

Kjo marrëveshje, e para e nënshkruar me një shtet të Ballkanit Perëndimor, ka qenë dhe do të ngel gurthemeli i bashkëpunimit tonë deri në anëtarësimin tuaj përfundimtar në BE. Implementimi i suksesshëm i Marrëveshjes vazhdon ta drejtojë procesin tuaj të reformave dhe t’i ndihmojë shtetit tuaj të përgatitet për anëtarësim përfundimtar në BE.

“Asociimi” ndërmjet BE-së dhe shtetit tuaj, i arritur përmes implementimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, ka ofruar – dhe vazhdon të ofrojë – mundësi për tregti, zhvillim ekonomik dhe integrim rajonal. Gjithashtu, kjo Marrëveshje ka ndihmuar në drejtimin e procesit të reformave në të gjitha sferat e politikave të BE-së, me çka ofron struktura institucionale, të cilat i drejtojnë marrëdhëniet tona. Në vitet e fundit, Marrëveshja është plotësuar me Dialogun për Aderim në Nivel të Lartë, si metodë plotësuese për t’iu dhënë prioritet dhe inkurajuar reformat e BE-së.

Ju uroj gjithë të mirat në përpilimin e monografisë dhe implementimin e vazhdueshëm të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Rainhard Priebe,

Ish Anëtar i Drejtorisë së Përgjithshme për Zgjerim, Komisioni Evropian



Përshkruani se si MSA-ja ka mbështetur përpjekjet e Republikës së Maqedonisë për të përmbushur kriteret politike për anëtarësim në BE.

MSA-ja ndihmoi të përqendrohemi në çështjet e rëndësishme të integritimit në BE dhe për këto arsye duhet të ketë dhënë një nxitje për të ecur para me përmbushjen e kriterëve politike. E vështirë për mua për të gjykuar, nëse kjo ka ndodhur gjithmonë siç pritet.

Përshkruani se si MSA ka përkrahur harmonizimin e legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian, duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve administrative për të zbatuar ligjet e reja.

Marrëveshja dhe në veçanti përcjellja e rregullt e zbatimit të tij do të duhej të ndihmonin për të marrë vendime të drejta legjislative. Kapaciteti administrativ është i domosdoshëm, por kufizimet buxhetore vënë domosdo kufi në atë që mund të bëhet. Kjo do të mbetet një problem.

Përshkruani se si MSA ka promovuar marrëdhëniet ekonomike të harmonizuara dhe gradualisht ka zhvilluar një zonë për tregti të lirë mes BE-së dhe Republikës së Maqedonisë.

Nuk mund të komentoj mbi këtë.

Përshkruani se si përmes MSA-së është arritur bashkëpunimi rajonal në fushat të cilat janë të përfshira me Marrëveshjen.

Të gjitha MSA-të në rajon përmbajnë një angazhim të qartë për të nxitur bashkëpunimin rajonal. Unë dyshoj se realiteti ka qenë ashtu si autorët e Marrëveshjes kanë dashur që ajo të jetë.

Përshkruani se si MSA ka përgatitur Republikën e Maqedonisë për përdorimin efikas të fondeve aktuale nga BE-ja si dhe fondet kohezeve dhe strukturore në të ardhmen.

Unë mendoj se duke marrë hapat e nevojshme për pranimin e fondeve u lehtësuan nga korniza e MSA-së.

Cilat janë përshtypjet e përgjithshme të zbatimit të MSA-së, e cila është nënshkruar mes BE-së dhe Republikës së Maqedonisë?

/



Foto grupore pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit më 9 prill të vitit 2001, ku në rresht të parë (nga e majta në të djathtë) janë Hosep Pike i Kamps (Spanjë), Javier Solana (Bashkimi Evropian), Hubert Vedrin (Francë), Sërxfan Kerim (Maqedoni), Ana Lind (Suedi), Ljubço Georgievski (Maqedoni), Jovan Tegovski (Maqedoni), në rreshti e dytë (nga e majta në të djathtë) janë Lidie Polfer (Luksemburg), Benita Ferero-Ualdner (Austri), Kristofer Paten (Komisioni Evropian), Robin Kuk (Mbretëria e Bashkuar), Jorgos Papandreu (Greqi), në rreshtin e tretë (nga e majta në të djathtë) janë Jozias van Aartsen (Holandë), Umberto Ranieri (Itali), në rreshtin e fundit (nga e majta në të djathtë) janë Erkki Tuomioja (Finlandë) Luis Mishel (Belgjikë), Joshka Fisher (Gjermani), Mogens Liketoft (Danimarkë), Brajan Kouen (Irlandë).

Analizë e implementimit të MSA

Shqyrtimi i zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Maqedonisë, në njërin anë dhe Komuniteteve Evropiane dhe shteteve anëtare të tyre, në anën tjetër

Hyrje

Më 1 prill të vitit 2014 shënohen dhjetë vjet nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, si dhe 13 vjet nga zbatimi i Marrëveshjes së Përkohshme. ¹ Sipas nenit 5, paragrafi 1 përcakton se “asociimi do të realizohet për maksimum 10 vjet, i cili do të ndahet në dy faza të njëpasnjëshme.” Në vitet e fundit, Maqedonia ndërmori të gjitha detyrimet e nevojshme për zbatimin e marrëveshjes me një fokus të veçantë në fushat e Kreut III, V, VI dhe VII. Monitorimi dhe analizimi i rregullt i dispozitave të MSA-së, është kryer nga organet institucionale të cilat në të kaluarën me sukses rrethuan nëntë cikle të takimeve. ²

Si rezultat i plotësimit të detyrimeve të parashikuara në fazën e parë të implementimit të parashikuar në kreun V, Komisioni Evropian në vitin 2009 dha propozim deri te Këshilli i Bashkimit Evropian për kalimin e Republikës së Maqedonisë në fazën e dytë të asociimit. Krahas një propozimi të tillë të Komisionit, Këshilli i BE-së ende nuk e ka miratuar propozim-vendimin për të kaluar në fazën e dytë të MSA-së.

Shqyrtim i të arriturave kryesore në lidhje me zbatimin e deritanishëm të Stabilizim-Asociimit

Republika e Maqedonisë i respekton **parimet e përgjithshme** të përcaktuara me Marrëveshjen, të cilat kanë të bëjnë me respektimin e parimeve demokratike dhe të drejtave të njeriut, të drejtës ndërkombëtare dhe sundimin e ligjit, pa-prekshmërisë së kufijve dhe respekton integritetin territorial të shteteve, zhvillimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore, dhe parimet e ekonomisë së tregut. Në kontekstin e nenit 118 të Marrëveshjes cila përcakton masat për të siguruar zbatimin e Marrëveshjes dhe deklaratës së përbashkët të këtij neni, shkelja e elementeve thelbësore të marrëveshjes konsiderohen shkelje materiale të Marrëveshjes dhe, si një “rast i urgjencës së veçantë” mund të jetë objekt i ndërmarrjes së masave përkatëse nga palët, pa zbatimin e procedurës së konsultimit të Marrëveshjes. Deri më tani nuk është konstatuar asnjë shkelje e elementeve thelbësore të Marrëveshjes. Është e rëndësishme të theksohet se parimet themelore të Marrëveshjes përcaktojnë se asociimi do të arrihet për më së shumti dhjetë vjet, e ndarë në dy faza.

Është themeluar një **dialog politik** i rregullt (Kapitulli II) me BE-në mbi çështjet me interes të përbashkët, dhe Republika e Maqedonisë rregullisht merr pjesë përmes ndonjë ftese nga ana e BE-së ndaj pozitave të përbashkëta, mendimet dhe deklaratat e BE-së lidhur me çështje të ndryshme të interesit ndërkombëtar të BE-së. Vendosija e dialogut politik është një faktor i rëndësishëm në procesin e aderimit të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian dhe ka sjellë një cilësi të re në marrëdhëniet e ndërsjella. Dialogu zhvillohet në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, në nivelin ministror, si dhe atë diplomatik dhe në nivel ekspertësh me institucionet e Bashkimit Evropian. Në nivel parlamentar, dialogu politik zhvillohet në kuadër të Komitetit të përzier parlamentar mes Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe Parlamentit Evropian.

Sa i përket **bashkëpunimit rajonal (Kapitulli III)** Republika e Maqedonisë ka vazhduar me politikën e promovimit të marrëdhënieve bilaterale me vendet e rajonit dhe ka marrë pjesë në mënyrë aktive në iniciativat rajonale, përfshirë këtu Procesin për bashkëpunim në Evropën Juglindore, Këshillin për bashkëpunim rajonal, Marrëveshjen e Evropës Qëndrore

1 Negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit u realizuan në një kohë jashtëzakonisht të shkurtër prill-nëntor në vitin 2000 përmes 3 raundeve të negociatave dhe 5 takimeve në nivel të ekspertëve, respektivisht të negociatave teknike. Marrëveshja u siglue në Samitin e Zagrebit më 24 nëntor vitin 2000, dhe u nënshkrua më 9 prill të vitit 2001 në Luksemburg, pas së cilës filloi procesi i ratifikimit më 12 prill në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Marrëveshja hyri në fuqi pas procesit të ratifikimit në Republikën e Maqedonisë dhe në të gjitha vendet anëtare të BE-së, më 1 prill të vitit 2004.

2 E rregulluar përmes Kapitullit X të MSA-së, Dispozitat institucionale, të përgjithshme dhe përfundimtare.

për tregti të lirë, Iniciativa e Evropës qendrore, etj. Republika e Maqedonisë ka bashkëpunuar plotësisht me Gjykatën penale ndërkombëtare për ish Jugosllavinë. U nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Kroacinë, Serbinë, Shqipërinë dhe Malin e Zi, në bazë të kushteve të përcaktuara në nenin 12 të MSA-së³, dhe gjithashtu në këto vende janë nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Në aspektin e bashkëpunimit ndërkufitar, Republika e Maqedonisë është duke implementuar projekte të përbashkëta me Greqinë, Bullgarinë, Shqipërinë, dhe kohët e fundit nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Kosovën.

Në pjesën e **qarkullimit të lirë të mallrave (Kapitulli IV)**, me përfundimin e periudhës së tranzicionit në 1 janar 2011, importi i mallrave industriale në të dy drejtimet është **liberalizuar plotësisht**. Përveç kësaj, të gjitha obligimet që kanë të bëjnë për produkte të hekurit dhe çelikut janë zbatuar me sukses. Për produktet bujqësore dhe të peshkut me origjinë nga Republika e Maqedonisë gjatë **importit në Bashkimin Evropian** janë hequr të gjitha taksat përveç për bagëti të gjalla, mish lope-i freskët ose i ftohur, mish lope - të ngrirë dhe verë, ndërsa për perime dhe fruta është ngritur tarifa doganore, por jo edhe taksa specifike. Janë parashikuar kuota të veçanta për mish lope dhe është përcaktuar kuota për eksportin e sheqerit me origjinë nga Republika e Maqedonisë. Deri më tani nuk është zbatuar masa adekuate për mbrojtjen e tregut, të parashikuara në nenin 30 të MSA-së. Sa i përket importit në **Republikën e Maqedonisë** të produkteve bujqësore dhe të peshkut me origjinë nga BE-ja, tarifrat doganore janë duke u reduktuar në mënyrë progresive. **Tregtia me verë** në mes të dy palëve është e qeverisur nga protokoli shtesë, sipas së cilës janë vendosur kuota për import dhe eksport.

Republika e Maqedonisë aktualisht aplikon kumulim diagonal me të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, me Turqinë dhe me vendet anëtare të CEFTA-s me përjashtim të Kosovës dhe Moldavisë. Në vijim është procesi për vendosjen e dispozitës për zbatimin e Konventës Rajonale në marrëveshjet e tregtisë së lirë të cilat Republika e Maqedonisë i ka nënshkruar me vendet e EFTA, vendet e CEFTA-s dhe me Turqinë. Në këtë periudhë nuk është marrë masë për heqjen e reduktimit të mëtejshëm të tarifave doganore për ndonjë produkt, e as ndonjë masë për të rritur taksat doganore për import të ndonjë produkti me origjinë në BE. Bashkimi Evropian gjithashtu nuk ka vendosur masa të tilla për importet e ndonjë produkti me origjinë nga Republika e Maqedonisë. Në bazë të dispozitave të MSA-së, pas informimit paraprak të BE-së nga ana e Republikës së Maqedonisë herë pas here janë vendosur masa të përkohshme për kufizim të importit apo eksportit të produkteve të caktuara (me origjinë nga të gjitha vendet). BE-ja deri më tani nuk ka aplikuar këto masa për Republikën e Maqedonisë.

Republika e Maqedonisë i ka plotësuar detyrimet e nevojshme nga faza e parë nga **Kapitulli V, lëvizja e punëtorëve, krijimi, dhënia e shërbimeve, kapitali**. Sipas detyrimeve të ndërmarra me nenin 44, me Ligjin për punësim dhe punë për të huaj⁴⁴ punësimi i të huajve ndalon diskriminimin direkt dhe indirekt në të gjitha bazat, ndërsa anëtarëve të familjes së ngushtë së të huajve që kanë leje pune u jepën leje pune të vlefshme deri sa zgjasin lejet e tyre për qëndrim. Aktualisht aplikohen marrëveshje për sigurim shoqëror me 11 shtete anëtare të BE-së⁵⁵ dhe me Konfederatën Zvicerane, dhe është duke u punuar në përfundimin e marrëveshjeve të tilla edhe me Republikën e Sllovakisë, Republikën e Shqipërisë, Republikën e Francës dhe Mbretërinë e Suedisë. Në pjesën për koordinim të sistemeve për sigurim shoqëror, në fazën e fundit të përshtatjes është vendimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit në lidhje me dispozitat për bashkërendimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore të përfshira në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Shtetasit e vendeve anëtare të BE-së janë qytetarë të barabartë me ata të Republikës së Maqedonisë në drejtim të sigurimeve shoqërore.

3 Kontratat përfshijnë elemente të dialogut politik, krijimin e një zone të tregtisë së lirë në mes të palëve, koncesione të ndërsjella në lidhje me lëvizjen e punëtorëve, krijimin e kompanive, ofrimin e shërbimeve, pagesat rrjedhëse dhe lëvizjen e kapitalit, bashkëpunimit në fusha të tjera, etj.

4 Gazeta Zyrtare e RM, nr.70/07.

5 Republika e Kroacisë, Austria, Republika e Sllovenisë, Republika e Bullgarisë, Gjermania, Republika Çeke, Mbretëria e Holandës, Republika e Polonisë, Republika e Rumanisë, Dukati i Madh i Luksemburgut, Mbretëria e Belgjikës.

Në lidhje me detyrimet e **Kapitullit II** që ka të bëjnë me **krijimin e sipërmarrjeve**, Ligjit për kompani tregtare ⁶ është plotësisht i harmonizuar me legjislacionin e BE-së ndërsa përkufizimet lidhur me “kompani e komunitetit, filialë e kompanisë, përfaqësi e kompanisë, themelim i kompanisë, aktivitete ekonomike dhe qytetar i komunitetit,” janë në përputhje me përcaktimin e Nenit 47 të MSA-së. Plotësisht respektohet parimi i mos-diskriminimit i përcaktuar në nenin 48 dhe është siguruar edhe trajtim i cili nuk është më pak i favorshëm sesa trajtimi i personave fizikë dhe juridikë vendas në lidhje me krijimin e kompanive të Komunitetit dhe në relacion me punën e filialeve dhe përfaqësive të kompanive të Komunitetit në RM. Në fazën e dytë të implementimit do të duhet të marrin në konsideratë mundësinë e zgjerimit të dispozitave për të drejtën e vendosjes së shtetasve të të dy palëve të Marrëveshjes për të ndjekur aktivitete si persona të vetë-punësuar.

Republika e Maqedonisë ka marrë masa të rëndësishme për të siguruar trajtimin e barabartë të shtetasve të shteteve anëtare të BE-së lidhur me të drejtën për të blerë pronë. Ligji për pronësi dhe të drejtat tjera pronësore i lejon personat e huaj juridikë dhe individë nga komuniteti të kanë të drejtën e pronësisë së pasurive të patundshme, tokë për ndërtim dhe marrjes me qira afatgjatë të tokës bujqësore nën të njëjtat kushte si personat vendas juridik dhe fizik. Në fazën e dytë është e nevojshme që të perceptohet mundësia për të zgjeruar të drejtën e arritjes së drejtës së pronësisë mbi pronë të patundshme të përfaqësive të kompanive të Komunitetit. Të dyja palët duhet të konsiderojë zgjerimin e të drejtave të përfaqësive dhe kompanive të Komunitetit, të cilat në fazën e parë përdorëshin vetëm nga filialet e kompanive të Komunitetit.

Për sa i përket shërbimeve financiare, në përputhje me kuadrin ekzistues ligjor ⁷, janë futur kriteret për themelimin dhe funksionimin e institucioneve financiare në baza jodiskriminuese, respektivisht investitorët e huaj mund të krijojnë institucione financiare në Republikën e Maqedonisë, nën të njëjtat kushte si investitorët vendas.

Me miratimin e Ligjit për njohjen e kualifikimeve profesionale ⁸ i cili është i harmonizuar me legjislacionin përkatës të BE-së për njohjen e kualifikimeve profesionale është vendosur sistemi normativ dhe institucional për njohjen e kualifikimeve profesionale. Mosfillimi i fazës së dytë të implementimit të procesit të MSA-së ndikon në kontrollin e plotë të sistemit të njohjes së profesioneve profesionale në aspekt të profesioneve sektoriale, si dhe procesi i integritimit gradual i Republikës së Maqedonisë në tregun e brendshëm të BE-së, për shkak se nuk ka mundësi për mobilitet në tregun e punës. Republika e Maqedonisë që nga hyrja në fuqi e MSA-së nuk ka futur ndonjë masë të cilat përfaqësojnë ndonjë shmangie nga dispozitat e Kapitullit V të MSA-së për të drejtën e themelimit të kompanive. ⁹

Në lidhje me **Kapitullit III i cili ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve**, në përputhje me nenin 55 të Marrëveshjes, Republika e Maqedonisë u qas ndaj zbatimit progresiv të masave që mundësojnë shërbime të përshpejtuara nga të dyja palët e pajtuara. Është përgatitur propozim ligji për shërbime me të cilat bëhet bartja e Direktivës së shërbimeve dhe siguron një kornizë ligjore për të hequr pengesat e mbetura rregullatore që pengojnë qasjen në ushtrimin e aktiviteteve shërbyese në vend të personave juridik dhe fizik në shtetet anëtare të BE-së. Republika e Maqedonisë deri më tani nuk ka ndërmarrë asnjë masë me të cilën krijohen kushte për ofrim të shërbimeve të cilat janë dukshëm më restriktive, në këtë mënyrë duke respektuar nenin 46 të MSA-së. Me hapjen e fazës së dytë të MSA-së do të rezultojë detyrimi për BE-në që të marrin masa për të zbatuar dispozitat për ofrimin e lirë të shërbimeve të personave fizik dhe juridik nga Republika e Maqedonisë në tregun e BE-së.

6 “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 28/2004, 84/2005, 25/2007, 87/2008, 42/10, 48/10, 24/11, 166/12, 70/13, 119/13 dhe 120/13.

7 Ligji për bankat, Ligji për mbikëqyrjen e sigurimeve, Ligji për lizing, Ligji për kompani financiare, etj.

8 Ligji është botuar në Gazetën Zyrtare të RM nr. 171/10, ndërsa zbatimi i tij do të fillojë me anëtarësimin e plotë të Republikës së Maqedonisë në BE.

9 Mundësia e dhënë nga neni 54 i MSA).

Republika e Maqedonisë, në bazë të nenit 57 të Marrëveshjes në periudhën e kaluar e ka bërë përshtatjen e ligjeve, duke përfshirë këtu edhe kapacitetet administrative në fushat e transportit ajror dhe tokësor. Marrëveshja për trafik mes Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian që nga viti 1997 është e vlefshme në fushën e trafikut rrugor. Republika e Maqedonisë ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe me 34 vende në Evropë për transportin ndërkombëtar rrugor për udhëtarë dhe mallra me të cilat synon drejt liberalizimit të transportit për udhëtarë dhe mallra. Liberalizimi i tregut të shërbimeve hekurudhore është shtyrë deri në hyrjen e Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian. Republika e Maqedonisë me bartjen e legjislacionit të aviacionit dhe liberalizimit me BE-në është në fazë tranzicioni të Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit. Kompanive ajrore ju është lejuar të përdorin të drejta të pakufizuara të trafikut midis çdo vendi në Republikën e Maqedonisë dhe në çdo vend të cilit do vendi-anëtar në shtetet Europiane.

Statusi i detyrimeve që rrjedhin nga Kapitulli IV pagesat rrjedhëse dhe lëvizja e kapitalit nga faza e parë e MSA-së në pjesën për drejtim të kapitalit janë të realizuara. Investimet direkte dhe transaksionet e kreditit janë plotësisht të liberalizuara në të dy drejtimet. Investimet e portofolit janë liberalizuar pjesërisht, që mundëson investime të lira të jorezidentëve. Në drejtim të investimeve në pasuri të patundshme, investimet e banorëve në patundësi në vendet e huaja nuk është e lejuar (përveç për përfaqësi diplomatike, konsulare dhe përfaqësi të tjera në vendet e huaja), ndërsa investimet për jo-banorët në patundshmëri në vend është lejuar për persona të huaj juridik dhe fizik nga shtete anëtare të Bashkimit Evropian dhe OECD-së (me përjashtim të tokës bujqësore), ndërsa për të gjitha vendet e tjera vlenë parimi i reciprocitetit.

Duke hyrë në fazën e dytë të MSA-së, sipas Ligjit mbi përdorimin e këmbimit valutor do të liberalizohen investimet në pasuri të patundshme të banorëve jashtë vendit, nxjerrjen dhe futjen e letrave me vlerë jashtë vendit dhe dokumenteve për pjesëmarrje në fondet rezidente të fondeve investuese jashtë vendit, investimet e portofolit të banorëve dhe lëshimin e letrave me vlerë të borxhit të huaj me maturitet mbi tre vjet. Pas përfundimit të fazës së dytë të MSA-së apo hyrjes së Maqedonisë në BE, banorët do të jetë e lirë të hapin dhe të mbajë llogari jashtë vendit.¹⁰ Liberalizimi i kapitalit dhe atij financiar në përgjithësi shihet si një proces pozitiv, ku vendet ndjekin dinamika të ndryshme dhe progresin e liberalizimit. Efektet e mundshme të hyrjes në fazën e dytë në llogarinë kapitale dhe financiare të bilancit të pagesave është vështirë të përcaktohet sasia. Potencialisht, do të sillte ikjen e mjeteve valutore nga Republika e Maqedonisë jashtë vendit. Megjithatë, është e vështirë të vlerësohet nëse dhe në çfarë mase, këto humbje do të realizohen për shkak se ato janë të kushtëzuara jo vetëm nga ndryshimet në legjislacion, por edhe nga shumë faktorë të tjerë ekonomik në vend dhe jashtë vendit në të ardhmen. Gjithashtu, ju duhet të merrni parasysh mundësitë dhe dinamikën e flukseve hyrëse të kapitalit në vend. Sipas nenit 60 të MSA, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit do të duhet të shqyrtojë mënyrat që lejojnë zbatimin e plotë të rregullave të Komunitetit për lëvizjen e lirë të kapitalit.

Sipas nenit 68 nga **MSA për afrimi i legjislacionit nacional me BE-në**, veçanërisht në fushat kryesore të tregut të brendshëm (*konkurrenca, prona intelektuale, prokurimi publik, standardizimi, akreditimi dhe vlerësimet e konformitetit*) dhe zona e tregtisë ishin një nga prioritetet kyçe në periudhën e kaluar. Të gjitha ligjet që dalin si obligim nga faza e parë janë miratuar, dhe në drejtim të implementimit të ligjeve janë miratuar më shumë nënligje për të krijuar dhe për të forcuar kapacitetet institucionale.¹¹ Sipas vlerësimit të bërë në strategjinë e fundit të KE-së për zgjerim dhe sfidat

¹⁰ Është e lejuar hapja e llogarive jashtë shtetit nga: përfaqësi diplomatike, konsulllore dhe të tjera të Republikës së Maqedonisë jashtë vendit të cilat janë të financuara nga buxheti i Republikës së Maqedonisë, persona me qëndrim të përkohshëm në vendin e huaj, gjatë qëndrimit të tyre jashtë shtetit; persona fizik me qëndrim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë të cilët jashtë vendit e kanë fituar të drejtën e: pensionit personal, pensionit të bashkëshortit/es së vdekur, ndihmës sociale, përkrahjes për fëmijë, pagesat për shkollim të fëmijëve për shkak të prindit që ka ndërruar jetë dhe premium / dëmshpërblim nga sigurimit të jetës. Banorët tjerë të cilët nuk janë të autorizuar mund të hapin llogari në banka jashtë shtetit vetëm nëse kanë një leje të lëshuar nga Banka Kombëtare.

¹¹ Është miratuar Ligji për mbrojtjen e konkurrencës, Ligji për kontrollin e ndihmës shtetërore, Ligji për prokurimin publik, Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, janë ratifikuar marrëveshjet ndërkombëtare që rregullojnë mbrojtjen e pronësisë industriale dhe intelektuale, etj., është formuar formuar dhe është operacionale edhe Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës si një organi i pavarur rregullator, Zyra për prokurim publik, janë duke u realizuar aksione kundër piraterisë. Republika e Maqedonisë, ka miratuar ligje të shumta dhe akte nënligjore të cilat kanë të bëjnë rregullat teknike, ndërtimin e infrastrukturës adekuate të cilësisë që përfshin standardizimin, metrologjinë, akreditimin, vlerësimet e konformitetit dhe mbikëqyrjen e tregut.

kryesore 2013-2014, vendi ka arritur një nivel të lartë të përafrimit me *acquis* në relacion të asaj se ku gjindet në proces.¹²

Përveç kësaj, në bazë të detyrimit që rrjedh nga neni 68, Republika e Maqedonisë në baza të rregullta përgatitë një Program Kombëtar për miratimin e së drejtës të BE-së, me qëllim të sigurimit të nivelit shtetëror dhe mirë të organizuar, koordinuar dhe me qasje të qëndrueshme konzistente në përbushjen e plotë të kriterëve të Kopenhagës dhe Madridit për anëtarësim, si dhe krijimin e një mekanizmi për monitorimin e vazhdueshëm të progresit të bërë në përbushjen e angazhimeve të marra.

Për sa i përket **kapitullit VII i Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme**, Republika e Maqedonisë kreu një reformë tërësore të gjyqësorit brenda, në të cilit u përfshinë edhe ndryshime të rëndësishme të Kushtetutës, u themelua Akademia për Trajnim të Gjykatësve dhe Prokurorëve, duke futur kriterë të rrepta për kryerjen e funksioneve profesionale të gjykatësit dhe të prokurorisë. Janë formuar Gjykata Administrative dhe Gjykata e Lartë Administrative, zbatimi i vendimeve të gjykatave kaloi në përmbarues, u zvogëluua numri i lëndëve të mbetura, u vendos ndihma ligjore falas si dhe ndërmjetësimi, u vendos sistemi i automatizuar i menaxhimit të lëndëve gjyqësore dhe e-drejtësia, etj.

Për sa i përket bashkëpunimit në fushën e vizave, kontrollit të kufijve, azilit dhe migrimit funksionon Qendra e Vizave dhe Sistemi nacional i informimit për viza. Legjislacioni nacional është harmonizuar me fushën e kontrollit kufitar, është themeluar një njësi mobile për të luftuar migracionin e paligjshëm, është themeluar dhe vepron edhe një Qendër nacionale e koordinimit për menaxhimin e kufirit ndërsa është duke u ndjekur bashkëpunim edhe me FRONTEX. Ligji për azil dhe mbrojtje të përkohshme është e harmonizuar me legjislacionin Evropian¹³, ndërsa është krijuar edhe një Qendër e pritjes për azilkërkuesit. Marrëveshja e Ripranimit ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian është duke u zbatuar pa probleme. Është krijuar një kuadër ligjor për parandalimin e pastrimit të parave¹⁴, funksionon Zyra e inteligjencës financiare, ndërsa është formuar edhe Zyra qendrore për hetime në fushën e luftës kundër falsifikimit. Në përputhje me legjislacionin e BE-së janë miratuar ndryshimet në Kodin Penal për shtimin e dënimeve alternative, futjen e e përgjegjësisë penale për persona juridik, themelimin e krimeve të reja dhe për të forcuar dënimet në lidhje me pastrimin e parave, krimi kompjuterik, kontrabandimin e emigrantëve, trafikimin, terrorizmin dhe financimin e terrorizmit, pornografisë së fëmijëve, etj. Janë ratifikuar numri më i madh i instrumenteve ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me luftën kundër llojeve të ndryshme të krimeve të rënda dhe atë të organizuar.¹⁵ Është siguruar një rol më aktiv për prokurorët publikë, si dhe zbatimi i masave të posaçme hetimore, mbrojtja e dëshmitarëve, konfiskimi i pronës dhe pasurisë së fituar nga krimi, etj. Hyri në fuqi edhe marrëveshja për bashkëpunim operacional dhe strategjik me EUROPOL-in. Në luftën kundër terrorizmit është intensifikuar bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe është sjellë strategji kombëtare për luftimin e terrorizmit. Ligji për kontrollin e drogave narkotike dhe substancave psikotrope është plotësisht në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, dhe vendi arrin bashkëpunim të mirë me të Qendrën evropiane monitoruese për droga dhe varësi nga droga.

12 Shih COM (2013) 700 finale

13 Direktiva e Këshillit 9/2003/EC nga 27 janar që përcakton standardet minimale për pritjen e azilkërkuesve; Direktiva e Këshillit 2004/83/EC e 29.04.2004 për standardet minimale për kualifikimin dhe statusin e shtetasve të vendeve të treta apo të personave pa shtetësi, si refugjatë apo persona të cilëve për arsye të tjera u nevojitet mbrojtje ndërkombëtare si dhe për përmbajtjen e mbrojtjes së aprovuar; Direktiva e Këshillit 2005/85/ES për standardet minimale mbi procedurat në shtetet anëtare për dhënien dhe heqjen e statusit të refugjatit, e miratuar më 1 dhjetor 2005.

14 E pajtuar me Direktivën e tretë të BE-së për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (32005L0060), është i ndryshuar Konventa e Strasburgut për parandalimin e pastrimit të parave, hetimi, kapjen dhe konfiskimi i të ardhurave nga krimi nga viti 2005 si dhe 40 rekomandimet e rishikuara të FATF për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe 9 rekomandime të veçanta për parandalimin e financimit të terrorizmit.

15 Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar të vitit 2000 dhe protokollet e lidhura rreth trafikimit të personave dhe trafikimin e emigrantëve; Protokollin kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve dhe komponentëve dhe municioneve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara për të luftuar kundër krimit të organizuar, Konventës për krimin kompjuterik të Këshillit të Evropës që nga viti 2001; Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit; Protokollin shtesë i Konventës penale për Luftën kundër Korrupsionit të Këshillit të Evropës; Konventa e OKB-së për luftën kundër korrupsionit; Konventa Evropiane për parandalimin e terrorizmit, së bashku me protokollin; Konventa ndërkombëtare për ndalimin e financimit të terrorizmit; Konventa ndërkombëtare për ndalimin e sulmeve terroriste me mjete shpërthyes; Konventa për ndalimin e akteve të terrorizmit bërthamor dhe konventës për sigurinë bërthamore.

Republika e Maqedonisë në përgjithësi ushtron një shkallë të konsiderueshme të bashkëpunimit me Bashkimin Evropian në fusha të shumta të zonave ekonomike dhe sociale të cilat janë subjekt i **politikës së bashkëpunimit, Kapitulli VIII** MSA. Përafrimi i politikave dhe legjislacionit të gjerë në këto zona është e shoqëruar dhe e ndihmuar me bashkëpunimin institucional dhe financiar midis Maqedonisë dhe BE-së. Në periudhën e kaluar kërkohej që dokumentet strategjike të BE-së në lidhje me zhvillimin ekonomik, të reflektohen në mënyrë të mirëfilltë në strategjitë kombëtare të lidhura me politikën industriale, zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, krijimin e një klime të favorshme për biznesin dhe politikën e investimit për investimet e huaja, nxitjen e eksportit, inovacionet, strategji zhvillimi për turizmin dhe kështu me radhë.¹⁶ Është siguruar një forcim i mëtejshëm i rregullativës dhe mbikëqyrjes bankare. U deshën përpjekje të konsiderueshme për të krijuar një klimë të favorshme biznesi për investitorët privat vendas dhe të huaj duke përmirësuar kuadrin ligjor, përfundimin e marrëveshjeve dypalëshe për promovimin dhe mbrojtjen e investimeve, duke bërë dialog të rregullt proaktiv me komunitetin e biznesit, etj. Politika tregtare zbatohet në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të ndërmarrja që rrjedhin nga anëtarësimi në Organizatën botërore të tregtisë (OBT), Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, CEFTA dhe marrëveshjet e tjera të tregtisë së lirë.

Është arritur shkallë të lartë e pajtueshmërisë me **sistemin doganor** të Komunitetit, përmes përdorimit të Dokumentit të vetëm administrativ (DVA) harmonizimin e nomenklaturës doganore të Maqedonisë me nomenklaturën e kombinuar të BE-së, etj. Në bashkëpunim me administratat **tatimore** të shteteve anëtare të BE-së, ka pasur disa projekte për modernizimin e administratës tatimore, përmirësimin e shërbimeve të DAP ndaj taksapaguesve, mbështetje për inspektoratin tatimor për kontrollin forenzik të e-tregëtisë. Republika e Maqedonisë ndërmerr aktivitete për pjesëmarrje në programin e ri të BE-së - FISKALIS 2020. Bëhet shkëmbimi i informacionit në bazë të marrëveshjeve të lidhura për shmangien e tatimit të dyfishtë.

Për sa i përket bashkëpunimit në fushën e **politikës sociale**, është bërë progres i rëndësishëm në harmonizimin e legjislacionit kombëtar me Bashkimin Evropian, në drejtimin e standardeve për punësim, siguri sociale, kushteve të punës dhe mundësive të barabarta për burra dhe gra, kujdesi shëndetësor dhe siguria në punë. Republika e Maqedonisë ka bashkëpunuar me BE-në në fushën e **arsimit**, kryesisht përmes programit TEMPUS dhe Fondacionit Evropian për trajnim (ETF), dhe ka bashkëpunuar në drejtim të harmonizimit të politikave në pjesën e **politikës audio-vizuale**, sidomos në aspektin e pluralizimit të medias, përcaktimit të organit rregullator dhe kompetencat e tij, etj.

Si rezultat i bashkëpunimit në fushën e **komunikimeve elektronike**, Republika e Maqedonisë ka të zhvilluar një treg të liberalizuar të komunikimeve me më tepër operatorë. Për zhvillimin e **shoqërisë së informacionit**, në përputhje me standardet evropiane në të kaluarën është miratuar një numër i ligjeve dhe dokumenteve strategjike¹⁷, janë zbatuar aktivitete për arritjen e ndërveprimit, menaxhimin elektronik të dokumenteve në institucionet shtetërore, zhvillimin e një game të madhe të shërbimeve elektronike të ofruara nga institucionet shtetërore, etj.

Është arritur progres në fushën e **mbrojtjes së konsumatorit**, si në aspektin e pajtueshmërisë së legjislacionit, ashtu edhe në ndërtimin e kapaciteteve institucionale për mbrojtjen e konsumatorit

Politika për **transportin rrugor** të Republikës së Maqedonisë në 10 vitet e fundit nga zbatimi i MSA-së është drejtuar drejt liberalizimit të plotë të shërbimeve të transportit dhe qasje të papenguar të ndërsjellë në tregjet e palëve të Marrëveshjes, si dhe të lehtësohet lëvizja e udhëtarëve dhe mallrave.

¹⁶ Në bazë të rregullt përgatitet Programi ekonomik i para-anëtarësimi, funksionon Këshilli kombëtar për ndërmarrësi, është miratuar dhe është duke u zbatuar një plan veprimi me masa për përmirësimin e aftësisë konkurruese të ekonomisë së Maqedonisë, Strategjia dhe Plani i Veprimit për inovacione 2012-2020, Strategjia për Zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme me programet vjetore, Strategjia e zhvillimit të zejtarisë 2012-2020. Projektet dhe gjatitë rregullatore janë duke u zbatuar me sukses si dhe sistemi i një sportelit, dhe gjithashtu është duke u aplikuar Strategjia kombëtare për zhvillim të qëndrueshëm.

¹⁷ Ligji për e-tregti, Ligji për drejtim elektronik, Ligji për themelimin e Rrjetit të Shkencor-Kërkuar të Maqedonisë - MARnet, Strategjia nacionale për e-Qeveri e Strategjia kombëtare për zhvillimin e përmbytjes elektronike në arsim, Strategjia kombëtare për e-kyçje.

Bashkëpunimi në fushën e **energjisë** ka për qëllim liberalizimin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, rritjen e pjesës së energjisë së rinovueshme në konsumin total të energjisë, rritjen e efikasitetit të energjisë, forcimin e kapaciteteve të departamenteve administrative që janë përgjegjëse në këtë fushë dhe të tjera.

Bashkëpunimi në **zhvillimin rajonal dhe lokal** ka për qëllim sigurimin e zhvillimit të barabartë rajonal, zhvillimin në rritje të vendit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve, si dhe forcimin e kohezionit të brendshëm shoqëror dhe ekonomik të vendit.

Sa i përket bashkëpunimit në **kërkimin dhe zhvillimin teknologjik**, Republika e Maqedonisë ka shënuar përparim të madh në lidhje me pjesëmarrjen në programet kornizë të BE-së si dhe lëvizshmërinë dhe kërkuesve përmes programit EURAKSES, ndërsa është themeluar kornizë legjislative dhe strategjike për harmonizimin e politikës së kërkimit të BE-së dhe objektivat strategjike të Zonës evropiane të kërkimit.

Në të kaluarën në **sferën e mjedisit** është bërë progres i rëndësishëm në bartjen e legjislacionit të BE-së *acquis* legjislativën nacionale përmes miratimit të ligjeve dhe rregulloreve të shumta, si dhe miratimin e dokumenteve të planifikimit. Në të ardhmen është e nevojshme për të paguar vëmendje të veçantë për bartjen e legjislacionit mbi ndryshimin e klimës, dhe për të siguruar zbatimin e plotë të legjislacionit, forcimin e kapaciteteve administrative në nivel nacional dhe lokal, dhe të forcojë bashkëpunimin rajonal dhe ndërkuftar.

Bashkëpunimi Financiar (Kapitulli X) me Komunitetin në formën e garantëve dhe kredive është shumë i rëndësishëm për të mbështetur reformat në vijim. Kjo ndihmë financiare realizohet/ej nëpërmjet instrumenteve PHARE, CARDS dhe IPA që mbulojnë të gjitha fushat e legjislacionit të BE-së me të cilat ishte e nevojshme për të harmonizuar legjislacionin kombëtar. Në të kaluarën është punuar në ndërtimin e një sistemi kombëtar të decentralizuar për implementimin e ndihmës së BE-së. Ajo është ndërtuar duke përcaktuar katër strukturat operacionale dhe funksionet e emërimit të të gjithë oficerëve, me anë të punësimeve të reja, organeve të reja për zbatimin e IPA-s, rregullave dhe rregulloreve të reja që ishin çështje e akreditimit nga Komisioni Evropian. Ka nevojë për mbështetje të mëtejshme, si në aspektin e financimit të aktiviteteve dhe marrjes së vendimit për të transferuar përgjegjësinë e autoriteteve kombëtare dhe përgatitjen e dokumenteve dhe projekteve të rëndësishme. Në vitin 2013 përgatitet për futjen e IPA II për periudhën 2014-2020 e cila do të fokusohet në qasjen sektoriale me theks të veçantë në të drejtën për plotësimin e fondeve të BE në mjetet buxhetore kombëtare për sektorët. Kështu pritet dukshmëri më e madhe, efikasitet, efektivitet dhe ndikim të ndihmës së BE-së në Republikën e Maqedonisë. Shuma e fondeve të siguruara për Republikën e Maqedonisë janë diku në të njëjtën shkallë si IPA 2007-2013, rreth 600 milionë euro, dhe në vijim janë konsultimet në fundit në relacion të definimit të sektorëve të cilat do të mbështeten nga fondet e IPA-s.

Perspektivat dhe sfidat

Perspektivat dhe sfidat

Politika e **pacifizmit të kontinentit evropian**, përmes formimit të Bashkimit Evropian dhe zgjerimit të vazhdueshëm të tij, padyshim se është proces unik dhe mundësi historike për integrimin e mëtejme të kontinentit në mënyrë paqësor dhe zgjerim të zonës së stabilitetit dhe prosperitetit. **Sukseset e kësaj politike, të mbushur me kompromise janë evidente dhe globale.** Numri i vendeve anëtarëve të BE-së ka arrit në 28 shtete me mbi 500 milion banorë, me ekonomi më të madhe në botë dhe me hapësirë të rëndësishëm në botën globale të vendimmarrjes. Megjithatë para Bashkimit Evropian ka **shumë sfida.**

Në planin e **sigurisë**, ndodhitë në fqinjësinë e afërt të BE-së, në **Afrikën e Veriut dhe Lindjen e mesme**, si dhe ndodhitë në **Ukrainë**, të cilat gjatë këtyre ditëve kanë bërë jehonë të madhe anekënd botës, por edhe **çështja e hapur e SHBA-ve dhe BE-së me Federatën Ruse**, bëjnë me dije se **paqja nuk është konstante**, andaj për çdo ditë duhet të punohet me mundim me qëllim që ajo të ruhet. Thellimi i marrëdhënieve asociative të BE-së me Ukrainën, por edhe balancimi i marrëdhënieve me Federatën Ruse, përfshirë edhe furnizimin e BE-së me energji, është sfida më e madhe, me të cilën kohëve të fundit përballet politika e jashtme dhe siguria e BE-së dhe NATO-s. Eskalimi i situatës paraqet **goditje të drejtpërdrejtë ndaj ekonomisë dhe sigurisë së BE-së** dhe problem potencial afatgjatë me pasoja të paparashikueshme dhe vështirë të tejkalueshme.

Sidoqoftë gjatë disa viteve të fundit në **planin ekonomik** BE-ja ka funksionuar në gjendje të krizës akute dhe në momente të caktuara ka marrë përmasa dramatike. Megjithatë, **BE-ja ia ka dalë ta tejkalojë krizën** dhe të hap perspektivë të re për zhvillim, përmes rezolutave vendimmarrëse të cilat përfshijnë ndryshime **fundamentale për menaxhim dhe koordinim të ekonomive evropiane** si mekanizma për **kontroll të financave publike dhe huamarrjeve të tepërta.** Rezultati pozitiv i krizës qëndron në faktin se për realizimin e ndryshimeve në rrethana normale do të nevojiteshin vite të tëra, ndërsa në rrethana të krizës ndryshimet në fjalë janë bërë për kohë tepër të shkurtër.

Edhe pse zgjerimi është njëra ndër politikat më të suksesshme të BE-së, që ka kontribuar për fuqizim të paqes, demokracisë dhe stabilitetit të Evropës dhe ka qenë indikator që BE-ja ta fitojë të Çmimin Nobël të paqes, megjithatë në vitet e kaluara (në veçanti pas vitit 2004 dhe 2007) një gjë e tillë **nuk ishte në qendër të interesit të BE-së.** Sidoqoftë, përkundër rrethanave të pavolitshme në BE, procesi **arriti të shënojë avancime pozitive**, ashtu që në vitin 2013 **Kroacia** u bë anëtar i 28 i BE-së, në vitin 2009 **Maqedonia** i përmbushi kushtet për fillim të negociatave, në vitin 2012 **Mali i Zi** dhe **në vitin 2013 Serbia**, pas dialogut të suksesshëm me Kosovën, nga 2013 i filluan negociatat aderuese, **Shqipëria** është në proces të transformimit të statusit të kushtëzuar të kandidatit me mundësi për fillim të negociatave, **Turqia** avancoi me ritëm të ngadalësuar në negociatave, **Kosova** është në përmblyllje të negociatave për lidhje të MSA-së, ndërsa **Bosnja dhe Hercegovina** nuk po gjen zgjidhje për vazhdim të procesit. **Të gjitha shtetet e Ballkanit perëndimor**, qartë e theksuan **synimin e tyre strategjik** dhe padyshim e ndërlihdën interesin e tyre politik dhe ekonomik me anëtarësim në BE. Në periudhën në vijim, pritet që **BE-ja ta ngrit nivelin e prioritetit të procesit të zgjerimit** dhe të angazhohet dhe investohet në masë më të madhe në përmblyllje të procesit të filluar në Ballkanin perëndimor.

Të gjitha sfidat e theksuara të sigurisë dhe aspekteve politike ose ekonomike, kërkojnë **qasje dhe vendosmëri proaktive** dhe të njëjtat mund të shërbejnë edhe si **sinjale të nevojës për konsolidim të brendshëm të BE-së** përmes të gjitha linjave, si dhe bazë për ndërtim të marrëdhënieve koherente dhe konzistente në procesin e integritit të thelluar (politik, ekonomik dhe monetar) dhe **përsheptim të mëtejme drejt Evropës juglindore dhe Turqisë.** **Përbërja e re e Parlamentit Evropian dhe Komisionit Evropian**, të cilat priten të formohen pas zgjedhjeve evropiane, do të duhet të ballafaqohen menjëherë me të gjitha sfidat brenda dhe jashtë BE-së, por edhe do të kenë mundësi të projektojnë perspektiva dhe të punojnë në realizimin praktik të tyre në vitet e ardhshme.

Republika e Maqedonisë e ka ndërlidhur me BE-në **perspektivën e zhvillimit, sigurisë dhe prosperitetit**, ashtu që në mënyrë të vazhdueshme shfaq **aspiratë të qartë dhe të pakontestueshme** për integrim të plotë në Bashkimin Evropian. Cilado analizë e **shkaqeve të integrimit** të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian nga **aspekti historik, gjeografik, politik, ekonomik, kulturor**, në fund rezulton me konkluzionin se Republika e Maqedonisë është pjesë e Evropës dhe pa fare dyshimi duhet të bëhet edhe pjesë e Bashkimit Evropian.

Perspektiva dhe qëllimi i integrimit të Republikës së Maqedonisë do të mund të definohej në drejtim të sistemit politik dhe avancimit të ekonomisë së tregut, përsheptimit të zhvillimit social dhe ekonomik, fuqizimit dhe thellimit të bashkëpunimit me vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe vendet kandidatë, integrimit të sistemit evropian të politikës së përbashkët dhe të jashtme dhe të sigurisë me vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe vendet kandidatë për anëtarësim, integrimit në sistemin evropian të politikës së përbashkët të sigurisë, konsolidimit të pozitës së Maqedonisë në planin ndërkombëtar dhe promovimit të identitetit ndërkombëtar të Maqedonisë si vend paqësor, që plotësisht dhe pa kurrfarë rezervash është e orientuar drejt proceseve integruese. Nëse Republika e Maqedonisë në kohë të duhur **nuk bëhet anëtare e plotfuqishme** e Bashkimit Evropian, **pasojat themelore negative** do të mund të dallohen në faktin se Maqedonia do të ishte jashtë mekanizmave të mbrojtjes dhe solidaritetit të BE-së dhe në masë të madhe do të duhej vetë të përballet me pozitën ndërkombëtare dhe sigurinë e vetë. Po ashtu, derisa Republika e Maqedonisë të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian nuk do të ketë mundësi të merr pjesë, gjegjësisht është **e përjashtuar nga procesi i vendimmarrjes** për çështje, të cilat drejtpërsëdrejti ose tërthorazi kanë të bëjnë me të ardhmen tonë dhe zhvillimin ekonomik, gjegjësisht të ardhmen dhe zhvillimin e rajonit.

Republika e Maqedonisë e ka projektuar perspektivën e vetë qysh në vitin 2001, si vend i parë i rajonit, që e ka nënshkruar **Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit dhe Marrëveshjen e Përkohshme për Tregti**, në vitin 2004 ka dorëzuar **Aplikim për anëtarësim** në BE, ndërsa në vitin 2005 e ka fituar statusin e **vendit kandidat për anëtarësim**. Nga viti 2009 (si dhe vitet 2010, 2011, 2012, 2013) KE-ja rregullisht i propozon Këshillit të BE-së, që Maqedonia t'i fillojë **negociatat aderuese për anëtarësim të plotfuqishëm**. Për shkak të kontestit të njohur me Greqinë, negociatat ende nuk kanë filluar, edhe pse **ka vite që Maqedonia ka merituar t'i fillojë negociatat**, si vend i cili plotësisht i ka përmbushur detyrimet e marra nga MSA-ja. Pra në masë të duhur i përmbush **kriteret politike të Kopenhagës**, është avancuar në përmbushjen e **kritereve ekonomike**, po ndërton sistem funksional administrativ evropian dhe ka dëshmuar kapacitet për ushtrim të së drejtës evropiane dhe praktikës juridike.

Republika e Maqedonisë është vendi i vetëm i rajonit, i cili plotësisht ka arritur **pranim të ndërsjellë të kufijve më të gjithë fqinjët**, i respekton të drejtat e komuniteteve, si dhe barazinë e të gjitha konfesionëve, nuk i konteston emrat e tyre, nuk ka pretendime territoriale dhe zhvillon politikë aktive **të marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe të bashkëpunimit rajonal**. Po ashtu përkundër të gjitha vështirësive dhe **sfidave, Maqedonia ngel e përgatitur dhe proaktive në kërkim të bazës së përbashkët përmes mjeteve politike dhe diplomatike dhe përmes dialogut të hapur**, që të gjendet zgjidhje për **çështjen e hapur bilaterale me Greqinë në lidhje me emrin**, meqenëse kjo çështje dhjet vite me radhë është pengesë për integrimin tonë të plotë në Bashkimin Evropian. Njashtu kemi shfaqur gatishmëri të plotë për zhvillim të mëtejshëm të marrëdhënieve bilaterale me **Bullgarinë**, si vend anëtar i BE-së dhe me të gjitha vendet tjera fqinje.

Perspektiva e Republikës së Maqedonisë është në qëndrueshmërinë dhe këmbëngulësinë për të gjetur zgjidhje të përbashkët kompromisi për kontestin me Greqinë dhe paralelisht fillimin e negociatave aderuese për anëtarësim në BE, duke insistuar në respektimin e së drejtës ndërkombëtare dhe detyrimeve të ndërsjella për ndërtim të marrëdhënieve ndërfqinjësore. **Sfidë kyçe në këtë kontekst** është që para së gjithash të sigurohet **vazhdimësi, konsistencë dhe koordinim të politikave tona**, duke siguruar **mbështetje të gjerë publike** dhe duke depërtuar me argumentet tona të arsyeshme juridike dhe morale te **fqinjët tanë dhe të gjitha vendet anëtare të BE-së dhe institucionet e saj**, përmes

zhvillimit të **dialogut të ndërsjellë dhe ndërtimit të mirëbesimit**. **Reformat ekonomike** vendore duhet të ndërlihen dhe sinkronizohen me reformat e sistemit ekonomik të BE-së, paralelisht me të duhet të thellohet **harmonizimi i legjislacionit tonë me atë të BE-së**, të thellohen **reformat në legjislacion dhe strukturat e sigurisë**, të vazhdohet me **reformat në administratën shtetërore, lokale dhe publike** dhe të ndërtohen kapacitetet për **planifikim strategjik** dhe përdorim të potencialit të buxhetit të vendit, si dhe kapacitetet për planifikim, programim dhe **absorbim të fondeve të disponueshme të BE-së**.

Përballimi me të gjitha **sfidat** është **detyrë e të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë**, por para së gjithash është detyrë dhe imperativ i të gjithë **protagonistëve politikë** në vend, gjegjësisht **Qeverisë dhe Kuvendit**. Të gjithë së bashku e bartim përgjegjësinë, e dirigjojmë ritmin, i përcaktojmë kornizat dhe kanalet e komunikimit dhe jemi përgjegjës për krijimin e kushteve të volitshme për realizim të detyrimeve gjegjësisht **klimës së përgjithshme dhe motivit** për avancim në procesin e integritimit.

Gjatë ciklit dhjetëvjeçar të implementimit të **Marrëveshjes së Përkohshme Tregtare (2001-2011)** dhe ciklit dhjetëvjeçar të implementimit të **Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (2004-2014)** i është dhënë impuls i fuqishëm perspektivës sonë për anëtarësim në BE dhe është trasuar rruga e reformave politike dhe ekonomike, janë orientuar relacionet tona tregtare dhe është kontribuar në përsheptimi e zhvillimit të Republikës së Maqedonisë. Në të njëjtën kohë përkundër rekomandimeve të KE-së, si sfidë e fuqishme për zhvillimin tonë të mëtejme, ishte përballja me obstrukcionet rreth vendimit marrjen e datës së fillimit të negociatave aderuese dhe për **kalim në fazën e dytë të implementimit të MSA-së**. Zhvillimi i këtyllë i ndodhive pamundësoi, që tërësisht të lirohet energjia e procesit integruar pjesërisht e **demotivoi administratën e Maqedonisë** dhe e vuri në pikëpyetje **kredibilitetin e institucioneve evropiane**.

Në kushte të këtylla të bllokimit, **sfidë e madhe** është bërë **procesi i mëtejme i harmonizimit të legjislacionit tonë** me atë të BE-së, para së gjithash për shkak të **mungesës së bashkëveprimit të thelluar** ndërmjet ekspertëve të BE-së dhe ekspertëve tonë nacional, në rrethana, kur nuk janë filluar negociatat aderuese, gjegjësisht në mungesë të procesit të skringut. Republika e Maqedonisë është ende lider në rajon për sa i përket procesit të transpozicionit të së drejtës evropiane në sistemin juridik të shtetit tonë, por meqenëse ende nuk i ka filluar negociatat dhe skringun dhe nuk e ka në dispozicion kapacitetin e plotë dhe potencialin e institucioneve të BE-së, **padëshim se procesi do të stagnojë, ekspertiza do të vjetërsohet, ndërsa shpenzimet për transpozicion do të shumëfishohen** dhe do të bëhen pjesërisht joproductive. Logjikën e njëjtë do ta ndjek edhe procesi i **themelimit dhe aftësisimit të institucioneve të reja** si mbështetje të implementimit të legjislacionit të ri evropian, të cilat nuk kanë partner real në palën e institucioneve të BE-së derisa t'i fillojmë negociatat aderuese.

Po ashtu **sfidë e vërtetë do të jetë edhe sigurimi i mbështetjes nacionale buxhetore dhe mbulimi i shpenzimeve** për sigurim të vazhdimësisë së procesit të harmonizimit të legjislacionit si dhe të krijimit dhe mirëmbajtjes së institucioneve për implementim të tyre në kushte të pasigurisë së dinamikës së procesit dhe **konkurrencës së fuqishme nga prioritete tjera aktuale**. Ndonëse janë shumë të mëdha shpenzimet për harmonizim të legjislacionit, për krijim të strukturave të nevojshme institucionale për implementim të tyre, për trajnim dhe aftësim të personave profesionistë si dhe **shpenzimet për përshtatje të operatorëve tanë ekonomik** me standardet evropiane të cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve, **megjithatë vetë shteti i përmbush ato dhe do t'ia del t'i përmbush në masë më të madhe**, ndonëse vetëm një pjesë e vogël do të kompensohet përmes projekteve të financuara përmes **fondeve të BE-së (IPA dhe IPA2)**. Fryma dhe **logjika e MSA-së** në periudhën dhjetëvjeçare përmes negociatave aderuese synonte që në procesin e integritimit të jemi më afër **fondit strukturor dhe koheziv**, prej ku pjesërisht do të **kompensohen shpenzimet** e procesit të harmonizimit të legjislacionit dhe reformave institucionale, mirëpo ngadalësimi i integritimit tonë në BE ndikon në **zvogëlim të konsiderueshëm të pakos potenciale** për mbështetje të fondeve të BE-së. Sa për ilustrim llogaritë e

përafërta tregojnë se në rast se procesi i integritimit do të vijonte pa obstrukcione, Republika e Maqedonisë do të **fitonte 5-6 herë më shumë mjete**, sesa këta që i fiton përmes IPA dhe IPA2.

Marrëveshja e Përkohshme për Marrëdhënie Tregtare dhe MSA-ja, si marrëveshje asimetrike preferuese në favorin tonë, menjëherë siguruan **hapje të plotë** të tregut të Evropës për produktet tona (nga viti 2001), gjegjësisht mundësuan **hapja graduale** të tregut tonë në periudhë dhjetëvjeçare. Periudha e asimetrisë ka përfunduar (viti 2011) dhe është krijuar **zona e tregtisë së lirë ndërmjet Maqedonisë dhe BE-së** (me kufizime të caktuara vetëm për disa produkte). Struktura e këtillë kishte për qëllim që në periudhë më të favorshme t'iu mundësonte **operatorëve tonë ekonomike të investojnë** në kapacitetet e tyre, pajisjet dhe teknologjinë, në mënyrë që **gradualisht të përgatiten për goditjen konkurrenente** të produkteve të cilësisë së lartë nga BE-ja. Edhe pse kishte investime të tilla dhe kompanitë më ambicioze arritën të përgatiten, prapëseprapë meqenëse nuk i filluam negociatat aderuese, **kapaciteti i kompensimit dhe ndihmës që operatorët tanë ekonomik** do ta merrnin nga shteti dhe përmes fondeve të BE-së ka qenë më i vogël nga ajo që është projektuar.

Po ashtu Marrëveshja e përkohshme dhe MSA-ja, përmes **liberalizimit gradual të tregut tonë**, detyrimisht shkaktoi **zvogëlim të të ardhurave tona buxhetore** për shkak të zvogëlimit të të hyrave të doganës dhe pjesërisht të tatimeve dhe akcizave, si rezultat i harmonizimit të dispozitave tona me ato të BE-së. Përmes negociatave aderuese dhe hyrjes në BE, logjika dhe fryma e MSA-së synonte ta kompensojë humbjen e të ardhurave buxhetore përmes qasjes në strukturat më të larta dhe fondin koheziv. Për ne **ngel sfida përmes përsheptimit të procesit të integritimit në BE** të kemi qasje në fondet, të cilat mund të na sigurojnë platformë për kompensim të të hyrave të humbura në buxhetin nacional.

Republika e Maqedonisë për momentin ka nivel të **BPV-së prej rreth 33-34% të mesatares së BE-së** dhe ka nevojë për **përsheptim të konsiderueshëm të zhvillimit** dhe rritjes së prodhimit shoqëror, me qëllim që të zvogëlohet dallimi me nivelin e BE-së. Perspektiva për zhvillim të përsheptuar dhe hapje të vendeve të reja të punës në Republikën e Maqedonisë mund ta arrihet vetëm nëse arrijmë siguri politike, reforma të shëndosha ekonomike, sistem funksional social, administratë efikase dhe profesionale, intensitet të rritur të investimeve të drejtpërdrejta të huaja, investime vendore dhe **përdorim të plotë, efikas dhe produktiv të fondeve të disponueshme të BE-së (IPA dhe IPA2)**. Republika e Maqedonisë e para në rajon ka arritur të krijojë sistem të **Implementimit të decentralizuar të fondeve të BE-së**, me çka ka dëshmuar pjekuri institucionale dhe gatishmëri për marrje të përgjegjësisë, por si **sfidë e madhe** del në pah ndërtimi i **kapaciteteve për absorbim maksimal të fondeve të disponueshme të IPA-s**.

Një dekadë e gjysmë pas nënshkrimit dhe fillimit të implementimit të MSA-së është e qartë se **suksesi i plotë i procesit nuk varet dhe nuk mund të varet vetëm nga njëra palë**. Dinamika e mëtejme, definimi i kornizës së re funksionale, fillimi i negociatave aderuese dhe përfundimi i suksesshëm i tyre paraqesin perspektivë me një sërë sfidash, për kalimin e të cilave nevojitet sinergji dhe angazhim maksimal, vullnet të mirë dhe shumë vendime dhe punë të mundimshme për implementim të tyre nga të gjitha palët e përfshira.

Refleksione përmbyllëse dhe rekomandime

Refleksione përmbyllëse dhe rekomandime

Në bazë të rezultateve të arritura, mund të konkludohet se **procesi i zgjerimit të BE-së parqet një ndër politikat më të suksesshme në planin global gjeopolitik**, dhe si i tillë është hapi kryesor në formimin e ekonomisë më të madhe të botës, me mbi 500 milion banorë, me parime të themeluara të sundimit të ligjit, lëvizjes së lirë dhe sigurisë së gjithë qytetarëve. Procesi ka qenë dhe ende u ekspozohet një **sërë sfidave**, të brendshme dhe të jashtme, të cilat përcaktojnë zhvillimin e politikave proaktive, reagimeve ditore dhe marrjen e vendimeve të shpjeta. Me çdo sfidë të re, Bashkimi Evropian gjithnjë ndryshohet në rrafshin politik, ekonomik dhe atë institucional, bëhet më efikas dhe u përshtatet situatave të reja, duke i orientuar shtetet **fuqishëm drejt aderimit**, bazuar në kriteret e përcaktuara, për të gjitha vendet që gravitojnë në orbitën e vetë gjeografike, gjegjësisht në interesin dhe ndikimin politik të BE-së.

Procesi i **zgjerimit të Evropës Juglindore** zhvillohet në periudhë më të gjatë kohore dhe mund të vlerësohet si **proces i suksesshëm në progres**. Sllovenia (2004) dhe Kroacia (2013) që tashmë janë anëtare të BE-së, paraqesin shembuj të mirë se integrimi është realitet edhe për shtetet e rajonit tonë. Mirëpo derisa **të gjitha vendet** e rajonit, duke përfshirë edhe **Republikën e Maqedonisë** të bëhen anëtarë të plotfuqishme, **procesi ende nuk është përfunduar dhe nuk mund të konsiderohet plotësisht i suksesshëm**. Sfida me të cilën përballohet BE-ja është gjetja e shtigjeve dhe mënyrave për **tejkalim të çështjeve të hapura bilaterale** ndërmjet disa vendeve të Ballkanit Perëndimor (si pozitiv konsiderohet shembulli i Serbisë me Kosovën), gjegjësisht çështjet e hapura bilaterale ndërmjet vendit anëtar të BE-së dhe vendit kandidat, për çka **mekanizmat e politikës së jashtme të BE-së janë ende të pafuqishme** (shembulli i Maqedonisë dhe Greqisë). Aftësia për zgjidhje të çështjeve të këtilla të hapura, do ta mbronte **kredibilitetin e BE-së** dhe do të siguronte **sukses të procesit të filluar të zgjerimit**.

Sipas konstatimeve të Komisionit Evropian, Republika e Maqedonisë **i përmbush kriteret për fillimin e negociatave aderuese nga viti 2009** e këndej dhe është plotësisht e përgatitur për fillim të negociatave. Fakti që **Këshilli i BE-së për 5 vjet me radhë nuk e verifikon rekomandimin e Komisionit Evropian**, mund të ketë efekt frustrues dhe demotivues për institucionet tona, për administratën dhe qytetarët, por megjithatë **përcaktimi ynë i fortë strategjik nuk është vënë në dyshim dhe mbështetja e publikut nuk ka shënuar rënie të konsiderueshme**.

Në kushte të këtilla të ndërlikuara **me qëllim që të ruhet procesi i dinamikës së integrit, nevojitet të bëhen përpjekje të tjera të vazhdueshme**. Në kontekst të këtij procesi **duhet të shqyrtohen këta hapa**:

- Të sigurohet **konsensus i gjerë** përmes një **dialogu inkluziv politik** dhe përmes të gjitha mekanizmave të shtetit, për mbështetje të qartë politike për **vazhdim të procesit si prioritet shtetëror**.
- Përmes **politikës proaktive** të shfrytëzohen të gjitha kanalet dhe mjetet diplomatike, të sigurohet një **dialog më i gjerë me të gjithë fqinjët tanë**, madje të përfshihen një sërë mekanizmesh të shumtë për **bashkëpunim rajonal dhe nëpërmjet Procesit të stabilizim asociimit**, në funksion të përmirësimit të mëtejme të marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe **ndërtimit të mirëbesimit në të gjitha nivelet**, para së gjithash me fqinjët anëtar të BE-së (**Greqia dhe Bullgaria**), me të cilat i kemi disa **çështje të hapura bilaterale**.
- Krijimi i **bazës për intensifikim të dialogut me të gjitha vendet anëtare të BE-së**, si dhe protagonistëve përkatës në procesin e vendimmarrjes në institucione dhe krijuesit e politikave të BE-së, si dhe hapja e **kanaleve të reja për dialog me SHBA-në**, me qëllim të përmirësimit dhe afirmimit rapid të imazhit dhe perceptimit pozitiv për Republikën e Maqedonisë në planin ndërkombëtar.

- Realizimi i plotë dhe sistematik në të gjitha **konstatimet dhe rekomandimet e Raporteve të KE-së**, si dhe raporteve të faktorëve të tjerë ndërkombëtarë relevantë, që kanë të bëjnë me **kriteret politike dhe ekonomike**, për anëtarësim në BE, duke përfshirë edhe **reformat në sistemin gjyqësor, administratën lokale dhe publike**, si dhe realizimin e mëtejme të **Marrëveshjes Kornizë të Ohrit**.
- **Vazhdimi i reformave të suksesshme në ekonomi** dhe themelimi i ekonomisë funksionale të tregut, me makroekonomi stabile, politikë efikase fiskale, financa publike dhe politikë të shëndoshë monetare, si bazë për **rritje dhe zhvillim të përshpejtuar**, hapje të vendeve të reja të punës dhe kthim i të rinjve dhe kuadrove të arsimuara në vend.
- **Nevojitet të fuqizohet kapaciteti për planifikim strategjik shumëvjeçar** dhe orientim të mjeteve të buxhetit nacional dhe potencialit kreditor, komplementar me zhvillimin e mëtejme të kapaciteteve për **planifikim dhe programim të fondeve të BE-së në dispozicion** (IPA1 dhe IPA2) dhe nëpërmjet **përgatitjes së projekteve të justifikueshme**, rritjes dhe përshpejtimit të absorbimit të tyre në **sistemin nacional për implementim të decentralizuar**.
- **Vazhdimi i implementimit dhe respekti i plotë** i dispozitave të **Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit**, si dhe të gjitha anekseve dhe Protokolleve të saj, përfshirë edhe **Protokollin e MSA-së për shkak të hyrjes së Kroacisë** në BE dhe ndryshimet e Protokollit për Prejardhjen e Mallrave dhe përshtatjen e rregullave të **Konventës Pan-Euro-Mediterrane**. Ndonëse kanë kaluar dhjetë vite të plota nga implementimi i MSA-së, **vlefshmëria juridike e dokumentit vazhdon** pa kufizim kohor, ndërsa **dokumenti vazhdon të shërbejë edhe si kornizë juridike** për rregullim të ndërsjellë të **marrëdhënieve edhe në shumë sfera** (liberalizimi i vizave, riatdhesimi, klasifikimi i informacioneve, menaxhimi i krizave, energjetika, transporti ajror dhe rrugor, çeliku, tekstili, sheqeri, pjesëmarrja në programet dhe agjencitë e Unionit, protokollin financiar për përdorim të fondeve të BE-së etj.).
- **Nevojitet të përgatitet një Analizë e gjithanshme nga zbatimi i deritanishëm i MSA-së**, përfshirë edhe zbatimin e Vendimit për **Masa të jashtëzakonshme tregtare** për rajonin tonë, me **vlerësim të neto-efekteve** si bazë për dialog me Komisionin Evropian për perspektivat e mëtejme të MSA-së. Në fakt janë përbushur **qëllimet e parashtruara në MSA-në për stabilizim**, asociim dhe krijim të zonës për tregti të lirë, mirëpo **nuk është arritur qëllimi parësor** për hapjen e **negociatave aderuese**, afrimin drejt fondeve strukturore dhe kohezive.
- **Vazhdimi i presionit ndaj Këshillit të BE-së**, gjegjësisht ndaj vendeve anëtare, për **respektim të plotë të MSA-së** dhe miratimi i **vendimit adekuat formal për kalim në fazën e dytë të MSA-së**, bazuar në Analizën e zbatimit të deritanishëm të MSA-së dhe vlerësimit, do të shqyrtohej edhe **mundësia për zbatim të njëanshëm të një pjese të dispozitave të MSA-së**, të cilat janë të kushtëzuara me vendimin për kalim në fazën e dytë (formimi i kompanive, posedimi i pronës, ofrimi i shërbimeve, transaksionet financiare etj.).
- Në bazë të kornizës së Analizës, do të duhej të bëhet vlerësim i hapësirës për **koncesione të mëtejme eventuale në pjesën tregtare të MSA-së**, duke përfshirë edhe efektet e vazhdimit eventual të negociatave për **Protokoll të ri për Verë, gjegjësisht koncesione reciproke** dhe mbrojtje të verës dhe pijeve alkoolike.
- Në kontekst të Analizës së zbatimit të deritanishëm të MSA-së, gjithashtu **nevojitet të bëhet vlerësimi i angazhimeve tona në kuadër të CEFTA-s (dhe EFTA-s)**, duke marrë parasysh negociatat aderuese të **Malit të Zi dhe Serbisë** me BE-së dhe në veçanti Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit të BE-së me **Kosovën**, si partner i ynë i drejtpërdrejtë tregtar, si dhe duke marrë parasysh rezultatet e negociatave të BE-së për marrëveshje për asociim me **Ukrainën dhe Moldavinë si dhe me Gruzinë**. Lëvizja në segmentin e marrëdhënieve tregtare dhe lidhjet e

koncesioneve të BE-së me të gjitha shtetet, të cilat janë partnerë tanë tregtarë, medoemos do të shkaktojë avancim të marrëdhënieve tona tregtare me BE-së dhe me shtetet përkatëse.

- **Nevojitet të thellohet fushëveprimi i Programit Nacional për Harmonizim të së Drejtës Nacionale me atë të BE-së (NPAA)**, si kornizë strategjike, por edhe si mekanizëm operativ (planifikim, përgatitje, financim, koordinim, monitorim) për drejtim të procesit të harmonizimit të legjislacionit dhe ndërtim të kapaciteteve institucionale për implementim. Në fakt, në bazë të përvojave të drejtpërdrejta të **Kroacisë, Malit të Zi dhe Serbisë** nga proceset e tyre të negociatave aderuese (procedurat e skriningut dhe raportet sektoriale) në rrethana, kur ne ende nuk kemi filluar me negociata aderuese me BE-në, **mund të ruhet deri në një nivel të caktuar dinamika e procesit të harmonizimit të legjislacionit dhe transpozicionit të EU acquis aktual.**
- Nevojitet të sigurohen mjete financiare edhe për vazhdim të procesit të përkthimit të EU acquis (legjislacionit të BE-së), për shkak se dinamika e harmonizimit të legjislacionit varet drejtpërsëdrejti nga dinamika e përkthimit të tij në gjuhën maqedonase.
- Duke pasur parasysh faktin se **organet e përbashkëta për implementim të MSA-së** (Këshilli, Komiteti, shtatë nënkomitetet, Grupi i Specializuar për Reformë në Administratën Publike, Komiteti i Përbashkët Parlamentar) në mënyrë rutinore kaluan dhjetë cikle të takimeve dhe në pjesë të madhe i shqyrtuan temat të cilat burojnë nga MSA-ja, **nevojitet ndryshim qenësor i përmbajtjes së takimeve** dhe thellim i tyre në drejtim të politikave sektoriale të BE-së, në kontekst të negociatave aderuese.
- Edhe Republika e Maqedonisë ende pret vendimin e fillimit të negociatave aderuese, **do të ishte shumë më e dobishme të merren vendimet e nevojshme për formim të organeve për koordinim dhe menaxhim të negociatave aderuese**, me qëllim të shfrytëzohen përvojat e Kroacisë, Malit të Zi dhe Serbisë, si dhe të simulohen procedurat e negociatave. Këta organe dhe procedura janë plotësisht **komplementare me strukturat e përhershme për koordinim të procesit të integritimit dhe implementimit të MSA-së**, prandaj do të mund të shfrytëzohen në mënyrë produktive edhe pa datë për fillim të negociatave.

